

HEJZA

Luljeta LLESHANAKU

***ARTI NUK SHKRUHET ME EMOCION,
POR PRODHON EMOCION***

PËR KË SHKRUAJMË!

Koha ka treguar se letërsia si art nuk bëhet për gjithë masat. Të shkruash, do të thotë të njohësh më mirë vetveten, të komunikosh, të reflektosh apo pozicionohesh, të lidhesh me njerëzit e mbi të gjitha të shërosh shpirtin tënd...

Irena Kuka DRAGOTI

Për kë shkruajmë? Një pyetje e vjetër sa vet bota. Ndoshka këtë retorikë e patën dhe ata që gdhendën ideogramat e para në muret e shpellave mijëra vite më parë apo nga sumerët e lashtë që kishin letërsinë e tyre, prej të cilëve ka mbërritur si tekst i plotë deri në ditët tona "Epi i Gilgameshit".

Për kë shkruajmë? Kjo retorikë na ndjek dhe sot në botën digjitale. Shkruajmë për të shkruar vetes apo për të shkruar te lexuesi? Për kë shkruajmë, kur paragjykojmë e fajësojmë lexuesin si një masë që nuk kupton. Vallë, a duhet të na kuptojnë njëjtë të gjithë? Faustini nuk e kuptoi, e pranoi kush në kohën e vet, por as në 100 vitet më pas nuk arritën ta zbërthejnë dhe kjo nuk e zhbëri Atë. Pse pretendojmë të lexohemi, kur nuk lexojmë të tjerë, nga mungesa e modestisë a lideri i madhësisë. Pse imponojmë krijimet tona deri në narcizëm si fitimtarë të një beteje... Nëse shkruajmë për të shëruar shpirtin, pse duhet të shqetësohemi për vlerësimin jashtë tij. Për kë shkruajmë, kur më shumë kujdesemi për lavdinë sesa për përmbajtjen e asaj që shkruajmë, kur më shumë kujdesemi për publicitetin sesa për shpirtin tonë. Për kë shkruajmë, kur prej narcizmi nuk e njohim fjalën reflektim. Këto retorika i kemi në nënvetëdijen tonë krijuese të papërgjigje për sa kohë sundon anarkia në sjelljet e veprimet tona, e cila ecën njëjtë me egoizmin tonë. Në çastin që shkruajmë, asgjë nuk është më jona. Ajo është pronë e të gjithëve, po aq sa e askujt e që të jemi koherentë, kjo është një nga dëshirat tona të brendshme, komunikimi me lexuesin, por pa pretenduar gjithë-pranimin. Ankohe mi për lexuesin, dmth masën që nuk na vlerëson krijimtarinë, po aq sa ankohe mi për moskuptimin e artit tonë nga ai. Këtu biem në kontradiktë me veten, sepse nuk kemi një sitë përzgjedhëse lexuesi në rrjetet sociale prej dëshirës për vëmendje po aq sa shpërdorojmë letërsinë, duke e kthyer në mision borxh-shlyerje pa u nisur nga vlerat e saj reale. Në këtë rrumpallë krijuese ku gjithkush e quan veten më të lavdishëm se tjetri, mungon vëmendja nga njohësi i vërtetë i letërsisë që ndoshka e ka kohën më të vlerë për të krijuar se për të lexuar, po aq sa nga i



thjeshti që nuk ka pasionin, mundësinë apo njohuri për letërsinë të lexojë si duam. Por, etja për lavdi na shtyn të gjejmë rrugët për t'i ç'bërë këto. E ato mund të jenë me çfarëdolloj kostoje... Harrojmë se lavdia vjen në çastin që i kthehemi vetes, duke iu përgjigjur dhe retorikave tona. A jemi realist në çdo vlerësim që ne i japim autorëve të ndryshëm vetëm se prej tij kemi marrë të njëjtën gjë, por vepra e tij realist nuk vlen. A do dilnim ne mbi paragjykimet, kritikën, vlerësimet, mbi egon? A do ta sugjeronim një shkrimtar tjetër mes miqsh për nga vlera pa prituri shpërblim prej tij? Apo duhet prituri sa të vdes shkrimtari e ti japim respektin e duhur, kjo sepse pas vdekjes nuk i ndejmë konkurrent e rrezik për lavdinë personale. Bëjmë mijëra përpjekje, mbështetur nga media apo inteligjenca artificiale, për publicitetin e masës e lexuesve, por vlerësimin e duam nga elita e letërsisë. A do të mjaftonte për egon tonë që arti ynë të pëlqej nga masa pa kurrfarë ndasie intelektuale? A do mjaftonte për egon tonë që arti ynë të kanalizohet veç te letërsi-njohësit? Shumë prej autorëve shkruajnë për të shkruar brenda vetes. Disa shqyejnë dyert e revistave veç për t'u përmendur, jo për t'u lexuar nga kush. Pse në shek 21 letërsinë ua imponojmë

lexuesve? Migjeni e të tjerë para tij e pas tij krijuan e u përcollën si vlerë në një kohë kur ende nuk ekzistonte digjitalizimi. Lasgushi jetoi jashtë egos për të bërë emër, e sot krenohemi me të. A e kemi menduar ndonjëherë se pas vdekjes nuk do të kemi në dorë kontrollin mbi lexuesit e pikërisht atëherë do kuptojmë sa vlerë ka ajo që kemi shkruar apo sa vlerë kemi ne? Çdo lexues kur lexon një vepër, më shumë se vepra, lexon vetveten. Një vepër letrare është një lloj mjete optik që i ofrohet lexuesit, duke i lejuar të shohë atë që pa librin nuk do ta shihte kurrë - thotë Marcel Proust. Jo rrallëherë ka aq shume poetë, tregimtarë e romancierë poshtë nivelit të lexuesit më të thjeshtë që ai vet paragjykon. Letërsia mbetet një prej garancive më të mira për progres të shoqërisë së sotme teknologjike: - thotë Mario Vargas Llosa. Letërsia është si dashuria, justifikon zgjedhjet e gabuara. Pra, nëse të lexon lexuesi i gabuar apo një lexues lexon veprën e gabuar, nuk është fundi i botës, është veç një rrugë drejt së vërtetës. Shumë prej nesh nguten te lavdia e vazhdueshme të trembur nga harresa, emri i pompuar artificialisht e disa i mundon inferioriteti. Shumë prej nesh shkruajnë se e dashurojnë të shkruarën pa mbajtur me tjeçulla të nxehta askënd. Nuk

zgjohen në mëngjes për t'i bërë "qokat" gazetave, revistave, botuesve të mëdhenj, kritikëve, shkrimtarëve e filozofëve, duke harruar pse shkruajmë. Në sjelljet e shumë autorëve shpesh shoh të ndodhë një eklips i tmerrshëm nga të bërit art për të dhënë veten, në të bërit art për të krijuar një vete iluzioniste. Shpesh, shumë autorë nuk ngopen me aq sa kanë marrë mbrapsht nga letërsia e tyre e po aq mendojnë se letërsia e lexuesi janë pafundësisht në borxh me ta. Mos vallë shkruhet për t'u shpërblyer? Po sikur të shkruajmë për vetë poezinë, romanin tregimin, novelën?! Po sikur të shkruajmë pa pararenduar për lavdinë a vdekjen? Ajo që vërej dhe e quaj pozitive vitet e fundit në letërsinë shqipe, është që shumë prej autorëve nuk shkruajnë për shpërblim monetar, duke ditur sesa pak lexohet dhe sesa të fryra e pa kontroll janë botimet në Shqipëri. Kjo ka sjellë një lloj vetëdije që letërsia nuk sjell para. Atëherë mbeten dy opsione pse shkruajmë: -shkruhet për te vetja, për letërsinë - shkruhet për lavdi, për ego Lavdia? "Është përshëndetja e një mase njerëzish që ju s'i njihni" - ka thënë Skrbabin.

Lavdia te shumë prej nesh nga një pasojë është kthyer në një qëllim, e shpesh si një shkallë hierarkie. Te shkrimtari duhet pranuar lavdia deri diku si formë publiciteti, duhen duartrokatur përmasat, por jo kur pas saj synohet qëllimi i përfitimit. Çdo poet duhet të jetë si një oqean i paqetë që nuk duhet të lejojë (lavdinë) si grëmi t'i marrë frymën hardhisë. Dy shembuj dashurie të lavdisë: Neroni dhe Erostrati nuk e lanë anonim eposin e lavdisë. Erostrati për të glorifikuar emrin e vet, dogji një tempull. Neroni, për të glorifikuar tempullin, dogji vetveten. Një maksimum e Gëtes thotë: "Nuk duhet shkruar asnjë rresht pa pasur parasysh një milion lexues", por nuk duhen ngutur këta miliona njerëz të na pëlqejnë... Në përditshmërinë krijuese, shpesh e kapim veten duke u grindur me egon, me kolegë, me median ose duke fajësuar digjitalizimin për të shkruarën dhe ankthet e letërsisë. Koha ka treguar se letërsia si art nuk bëhet për gjithë masat. Të shkruash, do të thotë të njohësh më mirë vetveten, të komunikosh, të reflektosh apo pozicionohesh, të lidhesh me njerëzit e mbi të gjitha të shërosh shpirtin tënd...

Nën thjerrë

ME ÇKA DËSHMOHET LASHTËSIA?

Shqiptarët, sidomos ata të Maqedonisë së Veriut janë të lumtur (!) që e kanë flakur "të vjetrën", atë strehë të varfërisë, trishtimit, mjerimi... Një angazhim etnik që asocion në realizim të planeve, projekteve, politikave antikombëtare! Pa gjurmë të "së vjetrës", si të dëshmohet lashtësia!

Nga Avni HALIMI

Kulturologia Barbara Kirshenblatt-Gimblett, në veprën e vet "Teorizim për trashëgiminë", thekson se, trashëgimia kulturore përfaqëson një burim nga e kaluara, (që është i vjetër), por që merr një jetë të dytë; (që do të thotë se do të ketë funksion të ri si trashëgimi) dhe i atribuohet vlerë e posaçme nga shoqëria ("e çmuar", "e rrallë", "në zhdukje"). Le të supo-

zojmë se, autorja, me këtë definicion ka parasysh kullën shqiptare, e cila dikur ka pasur funksion banimi, ndërsa sot, si e vjetër dhe "e pabanueshme" merr funksionin e një eksponati kulturor që duhet të jetë e qasshme për vizitorë e turistë anekënd botës! Shqiptarët, gjithandej viseve etnike, deri para tri dekadave, kryesisht kanë jetuar në zonat rurale, pra, në qendrat urbane ka jetuar një përqindje relativisht e vogël.

Madje, për shkak të politikave diskriminuese, edhe ato vise të qendrave urbane të banuara me shqiptarë kanë qenë forma të getove. Si në zonat rurale, ashtu edhe në ato "geto shqiptare" nëpër qendra urbane, shqiptarët kanë çuar një jetë përplot mjerim, trishtim, varfëri. Gjatë viteve tetëdhjeta e, kryesisht pas viteve nëntëdhjeta, shqiptarët jashtë kufijve të shtetit armë, krijuan mundësinë e ndryshimit të mënyrës së të jetuarit. Këtu diku mund të

kërkohet ai moment i prishjes së raporteve të shqiptarëve ndaj "të vjetrës"! Meqë "e vjetra" u asocion në mjerim, varfëri e trishtim, çdo kasolle të vjetër, çdo shtëpi të baballarëve, gjyshërve e stërgjyshërve, çdo kullë, çdo gardh, e prishën duke ndërtuar objekte, godina, shtëpi të reja. Nuk restauruan asgjë nga "e vjetra", nuk konservuan, gjithçka "e vjetër", me të gjitha kujtimet e trishita brenda saj, duhet të shkatërronhet e të ndërtohet nga e para!



Sot, vendbanimet shqiptare mund të jenë të vjetra me shekuj, por me pamje nga më modernet. Edhe pse me infrastrukturë, vende - vende edhe primitive, vendbanimet shqiptare, fshatrat, mëhallët -fiset, katundet, lagjet janë krejtësisht të reja: me shtëpi e oborre luksoze, me avlli e rrethoja me kangjella, me drita neoni e me llamba led, me panela e ngrohje solare. Thjesht, katundet shqiptare (sidomos ato në viset shqiptare të Maqedonisë së Veriut) sot duken "Amerikë"! Asnjë vendbanim i ri nuk u ngrit pranë "vend-banimeve të lashta", të meremetuara e të konservuara që të ngeleshin si kujtim, si ponë, si pasuri nga të parët, të cilat sot do të quheshin si "fshatra etno-turistik", që do të vizitoheshin e do të mrekulloheshin me tërë atë trashëgimi kulturore shqiptare.

Pas luftërave të mëparshme e deri te kjo e fundit në Kosovë, vazhdimisht shqiptarët janë përpjekur që t'i ngrisin shtëpitë-kulla, të cilat, gjithnjë të parat kanë qenë objekt djegie e shkatërrimi nga okupatori serb. Sepse, kullat kanë pasur edhe hijen dhe peshën e institucioneve kulturore nacionale, përveç që kanë pasur domethënien e "shtëpisë së madhe" të fisit të fortë, trim e të pathyeshëm. Fatkeqësisht, sot kullat e reja, po e humbin atë peshën kulturore, sepse më tepër po ngritën si objekte-përmendore të pamposhtshmërisë duke marrë kuptimin e "mini- garnizoneve ushtarake"!

Zona e Malësisë, sidomos Thethi, është shndërruar në simbol që shpjegon peshën dhe rëndësinë e "të vjetrës", e trashëgimisë natyrore por edhe kulturo-etnike në funksion të "turizmit malor". Sistemin mbrojtës të trashëgimisë në Kosovë e garanton "Ligji për zona të veçanta të mbrojtura", i cili siguron mbrojtjen e manastireve ortodokse serbe, kishave, objekteve të tjera fetare, si dhe objekteve historike dhe kulturore me rëndësi të veçantë për komunitetin serb të Kosovës, si dhe komunitetet tjera në Kosovë! Në Maqedoni, në vendbanimet shqiptare nuk kemi asgjë (përveç trashëgimisë etnologjike, fetare e natyrore) për t'u përfshirë në sistemin mbrojtës të trashëgimisë, siç nuk kemi as në viset e tjera etnike, përtej kufirit të shtetit amë, me përjashtim të Ulqinit, ku kemi "Kalanë e Ulqinit"! Kurse Shqipërinë (por edhe disa zona të Kosovës) në çdo pëllëmbë e kemi me relike e objekte të trashëgimisë kulturore, nën dhe e mbi dhe, madje edhe nën mbrojtjen e UNESCO-s! Shqiptarët, sidomos ata të Maqedonisë së Veriut janë të lumtur (!) që e kanë flakur "të vjetrën", atë strehë të varfërisë, trishtimit,

mjerimi... Një angazhim etnik që asocion në realizim të planeve, projekteve, politikave antikombëtare! Pa gjurmë të "së vjetrës", si të dëshmohej lashtësia!

Kujtesa kombëtare

Në çka bazohet kujtesa kombëtare? Natyrisht, mbi të gjitha, në bibliotekat nacionale! Derisa nëpër bibliotekat kombëtare në Shqipëri ekziston një fond i pasur i dorëshkrimeve, materialeve antikuare, librave, periodikut të rrallë e të vjetër, hartave, foto-dokumenteve, mikrofilmave, i punimeve nga magjistratura, doktoratura, materialit muzeal etj., bibliotekat e Kosovës së pasluftës dolën me një mungesë të madhe të këtyre materialeve. Okupatori serb shkatërroi e dogji sa mundi! Flitet se okupatori zhduk mbi 100 mijë tituj e qindra mijëra dokumente të tjera nga fondi i "kujtesës së kombit"! Nëse nuk është spekulim, nëse nuk është ves kombëtar që pas tragjedisë të merremi me vajtime e përçyrje, deri më sot është dashur që institucionet kompetente kombëtare të dilnin me ndonjë BIBLIOGRAFI të librave dhe materialeve të zhdukur nga okupatori serb! Sa kanë të drejtë shqiptarët që të vajtojnë për këtë gjest të pamohueshëm barbar të serbëve, po aq "kanë të drejtë" serbët ta mohojnë këtë duke e cilësuar shqetësimin tonë kombëtar si "aktirim shqiptar"! Në Kosovë edhe më tej mungon një "inventarizim" komplet i materialit të djegur e të zhdukur nga okupatori serb para dhe gjatë tërheqjes nga Kosova. Shteti amë, por edhe Kosova, duhet ta ndiejnë momentin aktual si emergjencë kombëtare që, sa më parë të nisim me themelimin e Institutit Kombëtar "Muzeu i trashëgimisë së shkruar shqiptare", ku do të "magazinohehin" nga një ekzemplar fizik apo elektronik i çdo letre, i çdo dokumenti, i çdo libri të botuar nga shqiptarët dhe për shqiptarët!

Po kaq emergjente është edhe ndërëgjësimi i shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, i intelektualëve, i profesorëve, i katedrave dhe fakulteteve gjegjëse, i studiuesve të rinj që, sa më parë, të nisim me hulumtimin e fondit të librit dhe të çdo gjëje të shkruar në gjuhën shqipe (apo edhe osmane) që gjendet nëpër bibliotekat që funksionojnë në këtë shtet! Akoma nuk dihet se cili është ky fond në Bibliotekën Nacionale dhe Universitare në Shkup, as në Tetovë, as në bibliotekat e fakulteteve e as në ato lokale e private! Nuk kemi asnjë botim të tipit Bibliografia e librit shqip në Bibliotekën "Shën Klimenti i Ohrit", siç nuk kemi as

bibliografi të librit në Bibliotekën e Tetovës. Nuk ekziston asnjë publikim që flet mbi periodizimin e librit, të periodikut e as të foto-dokumenteve të tjera në gjuhën shqipe. Partitë shqiptare në Maqedoni mburren me emërtimet e "funksionarëve" shqiptarë nëpër dikastere e institucione kulturore, ndërkohë që nuk kanë idenë dhe rolin kombëtar për të iniciuar dhe kryer projekte kaq jetike për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut.

Në Maqedoninë e Veriut librat, si ekzemplarë të detyrueshëm, "magazinohen" në Bibliotekën amë "Shën Klimenti i Ohrit" në Shkup si dhe në atë të Manastirit dhe Shtipit! Le të iniciohet një "inspektim studiuës", intelektual e shkencor dhe le të shihet se cili është pozita dhe interesimi shtetëror ndaj letrave shqipe! Është punë studiuese, pra e magjistraturave dhe doktoraturave! Një kontribut i tillë shkencor, do ta ndihmonte tej mase edhe themelimin eventual të Muzeut të trashëgimisë së shkruar shqip! Në ndërkohë, nga pasuria e shkrimit shqip do të eliminohehin të gjitha pseudoshkrimet, pseudoveprat, plagjiaturat dhe kompilimet.

Bibliotekat, muzetë e trashëgimisë bibliotekare dhe arkivat kombëtare duhet të jenë në bashkëpunim të ngushtë, të domosdoshëm dhe të sanksionueshëm me ligj! Sikur Kosova të shfrytëzonte periudhën e demokratizimit të Shqipërisë dhe të niste nga një ekzemplar qoftë fizik apo digjital të tërë pasurisë së vet të shkruar, sot vetëm do të raportonte për aktet barbare serbe kundër fjalës së shkruar në gjuhën shqipe dhe nuk do të vajtonte për materialin që mungon si pasojë e djegies dhe shkatërrimit të okupatorit serb. Pas ndërtimit të Bibliotekës kombëtare në Tetovë, do të ishte mirë të mendohet që botimet shqip të ishin të detyrueshme të bëhen pjesë e fondeve të të tri bibliotekave kombëtare, të Tiranës, Prishtinës, Tetovës! Një "bibliotekë kombëtare" paskësh filluar të funksionojë edhe në Komunën e Çairit! Pse jo, të përfshihet edhe kjo Bibliotekë nacionale e shqiptarëve të Shkupit, si "magazë" e vlerave të mirëfillta të letrave shqipe!

Veshje tradicionale nga rrobaqepësia diletante

Në viset etnike shqiptare funksionojnë me dhjetëra ansamble profesionale të këngëve dhe valleve popullore si dhe me qindra e qindra shoqata kulturo-artistike që merren me lëvizimin dhe kultivimin e vlerave tradicionale kombëtare! Jo vetëm kaq,

mision i këtyre ansambleve është edhe prezantimi i këtyre vlerave në skenat ndërkombëtare, përmes koncerteve dhe pjesëmarrjeve nëpër festivale të ndryshme. Ajo që spikat në plan të parë në koncerte apo festivale, nuk është vallja apo këndimi, nuk është loja apo ritmi, nuk është zëri apo tingulli, por, mbi të gjitha, është larushia e kostumeve, e të gjitha elementeve që përbëjnë veshjen tradicionale etnike. Shqiptarët janë ndër të paktët popuj në botë që, në një hapësirë relativisht të vogël, kanë rreth 40 - 50 lloj veshjes tradicionale. Natyrisht, janë edhe me dhjetëra të tjera që nuk njihen, që nuk janë prezantuar deri më sot!


Çdo lojë, çdo valle, çdo zonë urbane dhe rurale, çdo rrethinë malësish, i ka veshjet e veta! Po kush është furnizues i këtyre ansambleve dhe shoqatave kulturo-artistike me veshje tradicionale? Fatkeqësisht, në "ofensivë" janë rrobaqepës diletantë, të cilët madje drejtojnë edhe "ansamble", madje që drejtojnë edhe "shkolla valltarësh fëmijë", madje që përkujdesen edhe për furnizimin e diasporës, të cilët, me një kujdes dhe pedantëri të paparë i ruajnë veshjet popullore (!) të blera! Për t'u marrë me veshje tradicionale nuk duhet të jesh vetëm rrobaqepës, por mbi të gjitha, njohës i mirëfilltë i etnografisë kombëtare, të dihet prejardhjen dhe karakteristikat e hollësishme të veshjes, të dihet se cilës zonë i përket, në çfarë rastesh janë mbajtur! Gjithsesi, duhet të dihen tiparet kryesore të veshjeve për burra dhe për gra! Të dihen se cilës moshë i përket pjesët e veçanta përbërëse të veshjeve tradicionale. Për t'i ruajtur karakteristikat e veshjeve tradicionale etnike, duhet pasur kujdes të madh në raport me elementet simbolik, të cilat mund të përzihen me elementet nga ndikimi i kulturave turko-arab! Jo rrallë nëpër ekranet televizive shohim se si vallet shqiptare kërcen nga femrat që mbajnë veshje boshnjake-turke-arabe e që na shiten si "veshje kombëtare"! Veshje të tilla kemi plotë edhe nëpër "dyqane me veshje tradicionale"! Ndërkohë që, sidomos veshjet e femrave, në gardërobën tradicionale etnike kanë pamjen monumentale, ndërtimi i tyre flet për një përkushtim artistik të pasqor, teknika e endjes apo e qepjes është unike, ornamentet e përdorura në qëndisje flasin për një shije të stërholluar estetike, derdhja mbi to e stolive metalike flet për një simbolikë mitologjike, për yshtjen dhe dëbimin e syrit të keq nga e bukura e dheut! Qoftë edhe vetëm një fustan - nga ajo pasqyrohet tërë përkujdesi estetik, edukativ, por dhe fanatizmi për të qenë brenda autoktonisë!

Kemi plotë muze etnologjikë, kemi etnologë të padiskutueshëm, njohës akademikë të kësaj fushe, por, fatkeqësisht, nuk kemi një institucion etnik që do të merrej me kultivimin, ndërtimin, endjen, qepjen, bërjen e këtyre veshjeve tradicionale, natyrisht, e gjithë kjo nën vëzhgimin e rreptë të njohësve të stërhollë të të gjitha karakteristikave të veshjes sonë tradicionale. Do të ishte kuq një industri e leverdishme që do ta mbulonte tërë "tregun" e ansambleve tona, por edhe të diasporës. Nuk guxojmë që "Vallen e Rugovës" ta luajmë me fustane të kuq, apo me shallvare boshnjake! Nuk guxojmë që veshjet tradicionale t'ia japim makinave prodhuese serike! Dihet se veshja tradicionale është kryesisht punë dore, punë që për një ekzemplar të harxhon kohë me muaj! Një institucion i tillë do të duhej të shoqërohej me një ambient përcjellës, ku do të ruheshin eksponate nga të gjitha veshjet tradicionale që ekzistojnë e që do të zbuloheshin. Një punëtori që do t'i prodhonte në mënyrë origjinale të gjitha llojet e plisit! Natyrisht, edhe një segment botimi që do të merrej me përgatitjen e katalogëve profesionale mbi çdo lloj veshje dhe mbi të gjitha "ornamentet", si pjesë përbërëse të veshjes tradicionale! Pa një "industri" të këtillë, do t'u lihet hapësirë të gëlojnë rrobaqepësit diletante, ndërsa ansamblet tona të na prezantohen si shtëpi e palaçove folklorikë!

Intervistë: Luljeta Lleshanaku, poete

ARTI NUK SHKRUHET ME EMOCION, POR PRODHON EMOCION

Nuk ka sinjeritet në art, ka veç mjeshtëri. Nëse lexuesit i krijohet ideja se po përjeton ndjenjat dhe mendimet e autorit, kjo ka të bëjë vetëm me aftësinë bindëse të autorit



Shkëlzen HALIMI

Luljeta Lleshanaku, është një nga emrat më të shquara të letërsisë bashkëkohore shqipe. Ajo u lind në Elbasan (1968). Pati një jetë të vështirë, për shkak se familja e saj, si edhe mijëra familje tjera, e ndjeu deri në palcë persekutimin komunist-diktatorial. U diplomua për Gjuhë dhe Letërsi në Universitetin e Tiranës. Në vitin 2012, ajo u diplomua Master në Artet e Bukura në Warren Wilson College (SHBA). Ka ndjekur edhe "Programin Ndërkombëtar të Shkrimtarëve" në Universitetin e Iowa-s. Është nderuar me një bursë një-vjeçare si shkrimtare nga Black Mountain Institute në Universitetin e Nevadës, Las Vegas në vitin akademik 2008-2009.

Luljeta është autore e përmbledhjeve me poezi: "Sytë e somnambulës" (Artemida, 1994), "Këmbanat e së djelës" (L-SHA, Shqipëri 1995), "Gjysëm-kubizëm" (Eurorilindja, 1997), "Antipastorale" (Eurorilindja, 1999), "Palca e verdhë" (Buzuku, Kosovë 2000), "Fëmijët e natyrës" (Ombra, 2006), "Pothuajse dje" (Ombra, 2012), "Homo Antarticus" (Ombra, 2015), "Poezi të zgjedhura" (Onufri, 2020).

Është vlerësuar me shumë çmime: "Penda e argjendit 2000"; "Autor i Vitit 2013" nga Panairi i Librit në Tiranë, "KULT 2013", "Autor i Vitit 2013 në poezi" nga Panairi i Librit të Prishtinës dhe "PEN Albania 2016", etj.

Poezitë e saj janë përkthyer dhe botuar në pesëmbëdhjetë libra në gjuhë të tjera. Libri i saj i fundit në anglisht "Negative Space" (2018) u shpall fitues i çmimit "English PEN", finalist për "Çmimin Ndërkombëtar të Poezisë GRIFFIN 2019" në Kanada dhe finalist për "PEN America 2019". Libri i fundit në gjermanisht, "Die Stadt der Äpfel" (2021) ishte një nga librat e rekomanduar nga Deutsche Akademie für Sprache und Dichtung, në vitin 2022. Kurse me botimin e fundit në polonisht, "Woda i węgiel", ajo u shpall laureate e çmimit "Poeti Evropian i Lirisë 2022" në Gdansk, Poloni.

HEJZA: "Ndoqa atë rrugë që m'u tha"! E ty t'u tha që të jesh e padukshme, e pazhurmshme, të gjesh gjuhën adekuate kur terri të bie përtej dritareve, të mos ëndërrosh me zë, thjesht, vetëm të shkruash! Ti ndoqe këtë rrugë që të shpiu (siç vlerësojnë kritikët botëror) te klasikët bashkëkohor të letërsisë botërore! Ç'rrugëtim ishte ky?

L. LLESHANAKU: Poezia që e vetmi opsion që më mbeti. Të tjerët kishin shpresë dhe mundësi për të ndjekur karrierë të tjera, ose së paku për të ëndërruar. Unë, ne, familja jonë, ishim të privuar nga e drejta e studimit, pra nga e drejta për të ndjekur një profesion. Po ta kisha këtë të drejtë, mund të kisha zgjedhur diçka krejt tjetër, si p.sh. mjekësi ose drejtësi, ose mjekësinë ligjore ku bashkohen të dyja. Dhe po të më jepej mundësia të prekja një vegël muzikore, mbase do të zgjidhja muzikën, sepse e kam fort për zemër. Kështu që fillova të shkruaj, për të cilën më nevojitej vetëm një laps dhe një copë letër, dhe aprovimi i askujt. Fillova të shkruaj njëlloj si qeni apo macja, që fillojnë e notojnë sapa bien në ujë, krejt instinktivisht pa e ditur se ç'është noti. Ndoshta kështu ndodh edhe me prirje të tjera, të cilat nuk mund të zbulohen për sa kohë nuk ndodhesh nën presionin e mospasjes së një zgjedhjeje tjetër. Pra, duket se çdo gjë ndodh për një arsye.

Pjesa tjetër, është ashtu siç e cilësoni ju: një rrugëtim. Padyshim poezia ka qenë dhe është një pjesë shumë e rëndësishme e imja, por kurrë qëllim në vetvete. Dhe duke qenë e tillë, pa ndërë presion, më ka lënë njaftueshëm hapësirë dhe frymëmarrje, mundësi për të njohur dhe provuar jetën. Ndad edhe kthimet e herëpashërshme te poezia kanë ardhur natyrisht, si bletët që kthehen në mbrëmje në zgjoin e vet. Mendoj se kam mësuar shumë nga leximet, arti i të tjerëve, shkenca, historia, por në fund të fundit, poezia buron nga përvoja

individuale, një nga elementët kryesorë që i jep autenticitetin një poezie. Prej nevoje, jam marrë me njëqind punë të ndryshme. E kam filluar jetën si punëtorë në një fabrikë konservash, në fermë dhe ndërtim disa muaj, dhe pastaj në një ndërmarrje qilimash. Pas rënies së sistemit punova disa vite në gazetarinë e shkruar, por kurrë nuk u bëra gazetarë e mirë. Megjithatë, prej saj përfitova shumë në lidhje me ndërtimin e narrativës dhe sekretin e komunikimit me audiencat e gjëra. Gazetaria është e drejtpërdrejtë, e paanshme, objektive, ndryshe nga imagjinata, gjuha e nënkuptuar dhe personalizimi që janë karakteristike për letërsinë. Ajo të mëson se si të operosh me të dukshmen, të prekshmen, faktin ("Misteri qëndron në gjërat e dukshme, dhe jo në të padukshmet", është një varg i Oscar Wild, të cilin unë e kam si moto estetike). Puna si autore programi televiziv më vonë, vetëm sa e përforcoi këtë sens. Por, asgjë më shumë se skenari filmik nuk e zhvillon aftësinë abstraguese, pasi brenda një dimensionit të vetëm, imazhit, duhet të shkrih gjithë background-in e ngjarjes, historinë dhe gjendjen psikologjike të karaktereve, të djeshmen, të sotmen dhe ngjarjet në vijim, dhe ky ka qenë besoj përfitimi që kam pasur si pedagogje e skenarit të filmit në Akademinë Marubi në Tiranë gjatë 11 viteve të fundit.

HEJZA: Poezia është plagë që dhemb bukur. Ju pse e shkruani poezinë?

L. LLESHANAKU: Të shkruarit ta bën më të lehtë ekzistencën, një lloj si të dëgjosh muzikë. Pra, ai thjesht e zbut dhe e mistifikon realitetin. Madje, edhe tani që po shkruaj këtë intervistë po dëgjoj muzikë, dhe jam më e butë, sepse të them të drejtën, një pjesë e gjërave për të cilat mendoj, ngacmojnë pakënaqësi të mëdha brenda meje. Nga ana tjetër, shkrimi më ka bërë një njeri relativisht më të lirë. Më kujtohet që kur drejtoja një punëtori mbi shkrimin krijues, kuptova se pjesa më

e vështirë e punës për krijuesit e rinj është beteja e tyre me ndrojtjen, me frikën e ekspozimit "lakuriq" para të tjerëve, lexuesit, me frikën për t'u shprehur dhe për t'i besuar zërit të tyre. Kështu që vetë akti i të shkruarit kërkon kurajo, dhe si i tillë të bën më të lirë. Dhe pastaj, kur fiton statusin e një vepre arti, autori dhe ngjarjet bëhen te pagjyqeshëm. Kjo është edhe ideja e njërës nga poezitë e mia më të dashura, "Lajmet e vonuara", ku një karakter si Ana Karenina, nuk gjykohet moralisht, ndërkohë që në jetën e përditshme, një grua me një marrëdhënie jashtëmartesore gjykohet dhe përbuzet. Ka të bëjë me fuqinë konservuese dhe purifikuese të artit.

Por, lirinë maksimale ta jep të shkruarit pa menduar botimin, ose botimi me pseudonim. Rasti i Elena Ferrante-s, pseudonimit të personit që shkroi ato romane aq të famshëm, por pa e zbuluar kurrë identitetin, më duket më intrigues dhe i respektueshëm edhe se vetë romanet.

HEJZA: Regjimet diktatoriale, pushtetet mizore shpesh kanë ndikuar që krijuesit e këtyre periudhave të jenë "poliglotë estetikë": të njohin gjuhën e nënshtrimit, gjuhën e simboleve, gjuhën metaforike, gjuhën e urrejtjes... Ndërkaq në të gjitha krijimet e juaja vërehet veçse gjuha e së bukurës, qëndresa profetike përmes së cilës Ju triumfalisht ngadhënjyjet mbi totalitarizmin e së kaluarës dhe mbi frikën e së ardhmes.

L. LLESHANAKU: Ndoshta se isha më me fat pasi linda më vonë. Po kështu, nuk e di se çfarë do të kishte ndodhur po të isha rritur në kushte të tjera, apo të kisha qenë e favorizuar. Pra, nuk kam qenë në pozitë për të bërë kompromise: luftonim vetëm për të të mbetur gjallë. Dhe, nëse poezitë e mia janë paqësore, të zhveshura nga gjuha e urrejtjes, kjo nuk ka të bëjë me mënyrën se si unë ndjehem: unë kurrë, asnjë moment nuk kam bërë paqe me të shkruarën, dhe nuk besoj se do ta bëj

për sa kohë të kem frymë. Nëse e bëj, do të thotë se pajtohem me të keqen, dhe nuk e di se kush jam më pastaj. Dhe tridhjetë e ca vite post-komunizëm, jo vetëm që e preservuan të keqen duke mos e dënuar, por i mbivendosën edhe padrejtësi të tjera.

Por, arsyeja e "higjienës" sime në poezi, qëndron diku tjetër mendoj: në ndarjen e roleve. Të shkruash, nuk do të thotë të shkarkosh gjithë ngarkesën tënde psikologjike tek të tjerët. Arti nuk shkruhet me emocion, por prodhon emocion. Nga përvoja ime kam kuptuar që ky dallim është esencial. Është një lloj si në teatër: ti mund të kesh pasur një ditë shumë të keqe, por kur del në skenë në mbrëmje të luash Ofelinë, do të krijosh botën e saj, dramën e saj. Ndaj më është dukur gjithmonë pa vend shprehja "art i singertë". Nuk ka singertet në art, ka veç mjeshhtëri. Nëse lexuesit i krijohet ideja se po përjeton ndjenjat dhe mendimet e autorit, kjo ka të bëjë vetëm me aftësinë bindëse të autorit. Plus ka edhe shumë sekrete të tjera, që nuk t'i mëson askush, madje që as nuk mund të artikulojnë, të cilat duhet t'i zbulosh vetë pak e nga pak.

Mua më tërheqin shumë rrëfimet e zakonshme; poezia qëndron brenda tyre. Më pëlqen të ulem e të bisedoj me njerëzit, sidomos me njerëz të rastësishëm, si Evangjelia p.sh., fqinja ime aktuale, një emigrante e ardhur në Amerikë 20 vjeçe, kur tregon për fëmijërinë e saj në një nga fshatrat greke, ku e gjithë familja punonte për 1 dollar në ditë, duke mbjellë panxharë, misër dhe lin, dhe sot pensioniste shkon në kishë çdo dy të diela me një ëmbëlsirë me kryq në dorë, dhe lutet për të vëllain me alzajmer që nuk mban mend as PIN-in e kartës së bankës, për të motrën pa burrë e fëmijë, për të afërmit në fshatin e saj në Greqi...Në fund të fundit, secili ka një histori për të treguar, unike, të pariprodhueshme as nga imagjinata më e fortë. Të gjitha temat, filozofitë, gjenden brenda kësaj jete të vetme, të cilën ajo di ta tregojë aq bukur me detaje.

Natyrishit edhe unë kam disa modele letrare që kanë ndikuar jo pak tek unë, por që mendoj se i kam braktisur në momentin e duhur, duke lënë më tepër hapësirë për përvojat reale.

HEJZA: Një spektër i gjerë i temave të trajtuara në poezinë tuaj! Madje, edhe internimin politik e trajtoni si mundësi për ta hulumtuar dhe gjetur estetikën te e shëmtuara! Ngjashëm si motivet biblike, si ajo lutja e përshpirtshme: "Zot, fali, sepse ata nuk dinë se ç'bëjnë!"

L. LLESHANAKU: Në këto kohë, p.sh., më ndodh shpesh të dëgjoj copëza bisedash të kalimtarëve në celular, për gjëra që mund të thuhesh me pesë fjalë, por që zgjaten e ekzagjerohen pafundësisht në mënyrë artificiale nga nevoja për ta kthyer të zakonshme në dramë, sepse e mirë apo e keqe, secili duhet të ketë një histori të veten për të treguar, që i jep atij një lloj peshe në këtë botë. Pra, ka të bëjë me natyrën njerëzore, që kërkon kuptim edhe atje ku realisht nuk ka.

Por, komunizmi është një dramë e gatshme ku secili ka pjesën e vet. Ajo ç'ka e bën të veçantë si objekt letrar këtë periudhë është vuajtja çnjerëzore, që natyrishit ngacmon emocione dhe një pathos shumë të fuqishëm tek audiencat. Në poemën "Ujë dhe karbon" ka detaje të marra nga rrëfimet e ish të burgosurve në kampet e punës dhe në burgje, dhe nga jeta në kampet e internimit të cilën e njoh edhe vetë nga afër, kur vizitoja kushërinjtë e mi. Nuk më shqiten nga



mendja ato barrakat prej qerpiçi të mbuluara me katrama që përdorshin si kuzhinë, dhomë ngrënjeje dhe për të bërë banjo. 200 metra larg, ndodhej një WC e përbashkët, të cilën duhej ta pastrojnë me radhë me ujën që e mbushnin 500 metra larg, pas punës 12 orësh në fushë. Dhe, secila prej familjeve kishte të paktën një burrë në burg, dhe që përveç të tjerash, duhej të përballonin edhe me etiketimin, fyerje, "demaskime" dhe forma të tjera çnjerëzore të luftës së klasave. Ata nuk gëzonin asnjë të drejtë, dhe disa prej tyre nuk e kaluan kurrë fshatin e internimit. Dhe atje ku ka vuajtje të tilla ekstreme, ka edhe heroizëm. Çfarëdo të kenë bërë pas internimit këta njerëz, është e papërfillshme dhe e pakrahueshme me përvojën e tyre të internimit, me të cilën, për arsyt që përmenda më sipër, edhe identifikohen.

Por, megjithatë, siç e perceptoni edhe ju, poezia ime nuk akuzon. Ky konkluzion ishte edhe në argumentin e jurisë në Poloni. Duket sikur "Ujë dhe karbon" nuk merret me shkakun, por me pasojën, sikur shkakun të jetë i parëndësishëm. Kjo vjen se qëllimi kryesor i kësaj poeme apo poezitë të tjera mbi këtë periudhë nuk ka qenë të tregojë se ç'ka qenë komunizmi, gjë që mund ta bëjnë shumë herë më mirë tekstet e historisë, apo qoftë edhe dëshmitë e të mbijetuarve nga ky regjim; qëllimi kryesor ka qenë të promovohet vitaliteti njerëzor, aftësia për të dominuar mbi rrethanat pa u tjetërsuar. Dhe në përgjithësi mendoj që poezia nuk "ka kohë" të merret me ngjarjet konkrete, e aq më pak politike, në përjashtim të rasteve kur ajo shërben si

formë imediate proteste. Asgjë në poezi nuk ndodh tashti dhe këtu, ose atëherë dhe atje. Poezinë unë e shoh si një mbivendosje kohësh, përvojash, emocioneve dhe karakteresh. Poezia është si një radiografi, që shpalos vetëm esencën universale të gjërave.

HEJZA: Nga poetet shqiptarë jeni më e përkthyer dhe më e botuar në gjuhë të ndryshme të botës! Lexuesi, i cilido popull qoftë, kur i lexon poezitë tuaja krijon përshtypjen se Ju keni pasur nevojë të flisni intimisht me atë lexues, të futur në një botë jo më të madhe se një pikë e zezë. Hapësira zero e poezisë, ku strehohet gjithë shqetësimi i një kombi, hap shtigje për të depërtuar në hapësira të paskajshme! Në të tilla rrethana dhe përpjekje estetike, a rrezikon të humbasë poezia origjinale identitetin e vet. Sot, a e ka identitetin e vet poezia shqipe?


L. LLESHANAKU: Me globalizmin, shumë gjëra rrezikohen. Politika globale, lëvizja e lirë, tregu, teknologjia e informimit, po imponojnë gjithnjë e më shumë një stil unik jetese për gjithë botën, duke sheshuar barrierat dhe duke ezauruar çdo lloj kureshtje kulturore midis vendeve. Sot është shumë e vështirë të dallosh një poet irlandez nga një poet egjiptian, apo argjentinas, p.sh. Ndaj historia mbetet ndoshta i vetmi element që e bën sot të dallueshme një lloj letërsie nga një tjetër nëse flasim për identitet kombëtar. Dhe poezia, për vetë natyrën abstraguese që ka të cilën e shpjegova edhe më sipër, është ndoshta edhe më e rrezikuara si zhanër në këtë aspekt. Por, mbetet gjithmonë mundësia e

krijimit të një individualiteti letrar, që në thelb është botëkuptim dhe sistem komunikimi, që krijohet në varësi të rrethanave. Unë p.sh. mendoj se këtë lloj personaliteti e kam të imponuar, jo të fituar: nëse e përjashton dikë me forcë nga grupi, ai do të krijojë identitetin e vet si formë të rezistencës, do të gjejë mjetet e veta të bëhet i dukshëm. Dhe, sigurisht krijon një ndjeshmëri shumë më të madhe ndaj botës.

Tani që po flas, p.sh. më kujtohet një nga episodet e fëmijërisë: pranimi në organizatën e pionierit. Sa herë bëheshin këto ceremoni, ku pranoheshin grupe të rinj fëmijësh, unë shkoja me shallin e kuq të pionierit të hekurosur në çantë, me shpresë, ose ashtu siç më ishte premtuar, do të thirrej më në fund edhe emri im. Dhe kurrë nuk u thirr! Është budallallëk edhe ta kujtosh, sepse me ato ç'ka shihja e dëgjoja në familje, për mua duhej të ishte fyerje e madhe të bëja pjesë në këto organizata, por fëmija është fëmijë...Dhe pafundësisht histori të ngjashme dhe shumë më të rënda, deri tek ajo që më tregoi së fundmi im atë, që kur isha dy-tre vjeçe, kryetarja e Organizatës së Gruas, një komuniste famëkeqe atëkohë në Elbasan, i bën namin prindit të një djali të vogël, i cili ishte kapur për dore me mua, sepse medemek unë isha "fëmijë armiku" dhe e shkëput me forcë prej meje. Çfarë njerëzish mban kjo tokë! Edhe tashti pas kaq vitesh, u preka shumë kur e dëgjova këtë histori, por më shumë se vetja m'u dhimbën prindërit e mi: sa të fortë duhej të kishin qenë që ta përmbanin veten, sepse te fëmija nuk durohet asgjë!

HEJZA: Sot, si kurrë më parë, shkruhet poezia shqipe, ndërsa shumë pak flitet për poezinë shqipe. Edhe ata që marrin mundin të flasin për poezinë, më tepër i përkasin kategorisë së "kritikëve letrar" që ose kurrë nuk e kanë shkruar poezinë ose kurrë nuk janë përpjekur të mësojnë si shkruhet poezia. Në ç'situata të sikletshme e në ç'nivele të delirit kalon shpirti kur krijuesi e nis dhe e përfundon një poezi. Apo poezia vjen vetvetiu, ngjarje pas ngjarje, pas dashurisë, tradhtisë, vdekjes...

L. LLESHANAKU: Kritika letrare është proces, i cili fillon me përzgjedhjen e botuesit për librat që boton, redaktimin, dhe pastaj promovimin. Hallka e parë është vendimtare, ndaj edhe botuesit duhet të jenë të mirëinformuar, me shije dhe intuitë, dhe me kurajo për të marrë rrisqe dhe për të thënë jo atje ku duhet. Recensionet ose kritika letrare janë hallka e fundit, dhe jo shumë e nevojshme në një gjuhë të vogël, dhe me audiencë të kufizuar si e jona. Kur del një libër i mirë, lajmi shpërndahet vetvetiu, sidomos sot në epokën e medias sociale. Kritikë dhe autorët, mendoj se duhet të mbajnë një lloj distance etike mes njëri-tjetrit, por duke qenë një komunitet i vogël, ne e gjejmë veten padashur duke shkruar për njëri-tjetrin, që tingëllon si të bësh elozhe, edhe kur me të vërtetë libri i meriton fjalët e mira. Por, unë e marr disa me rezerva kritikën letrare në përgjithësi. Madje, më kujtohet një rast për një kritik tonin që ishte goxha në modë në atë periudhë, i cili më pas filloi të botonte edhe poezi të vetat, që m'u dukën shumë të dobëta. Qe një zhgënjim i madh, jo mungesa e talentit, por fakti që ky person që merrte përsipër të bënte rolin e kritikut, nuk ishte në gjendje të kuptonte as nivelin e poezive të veta, duke dalë publikisht me to. Por, mendoj se po të dish t'i lexosh, në çdo lloj koment, që nga ato



të lexuesve të thjeshtë e deri të shkrimtarëve të sprovuar, mund të kuptosh diçka.

Ju më pyesni si vjen poezia tek unë. Si ide vjen vetvetiu, edhe pse mund të marrë shumë kohë për t'u shkruar. Ama janë ato ngjarje të rëndësishme që përmendët ju, ato kthesa të cilat jo vetëm më skicojnë mua si person duke diktuar sjelljen, gjendjen, transformimin tim, por edhe pyetjet e mëdha të cilat gjejnë artikulumin e tyre në atë që di të bëj më mirë: poezi. Dy vitet e fundit. P.sh, kanë qenë një përmbysje e madhe, pasi e kam gjetur veten para përvojave të cilat kanë qenë të panjohura më parë, së paku jo në këto përmasa kaq reale: plakja dhe vdekja! E para ka të bëjë me prindërit e mi të moshuar dhe të sëmurë, kurse e dyta, me humbjen e tre nga njerëzit e mi më të më dashur, sidomos kushëririt tim 51 vjeçar. Thjesht tani përsiatjet e mia i përkasin një botë krejt metafizike, që e bëjnë të parëndësishme dhe banale gjithë pjesën tjetër të gjërave që më kanë preokupuar deri tani. Është një gjendje krejt tjetër, sa përndritëse aq edhe paralizuese, që uroj mos të zgjasë shumë...

HEJZA: Fituese e çmimit "English Pen", pastaj finaliste për çmimin "GRIFFIN International Poetry Prize 2019" në Kanada dhe finalist për "PEN America 2019", laureate e "European Poet of Freedom 2022" në Gdansk, Poloni. Çmimet e festivaleve ndërkombëtare jepen pas vlerësimeve të komisioneve të përbërë prej kritikëve letrarë me renome botërore. Nga "burgu shtëpiak", nga jeta e izoluar në internim të egër, sot poete me famë ndërkombëtare. Është ky fat apo mëshirë e mirësi nga Perëndia e Poezisë! Kujt i falet Luljeta Lleshanaku?

L. LLESHANAKU: Talenti është dhunti, nuk mësohet. Shkolla të mëson teknikën, mënyrën se si ta përdorësh me efikasitet këtë talent, por nëse nuk e ke, nuk të vlen. Ajo që ne e quajmë frymëzim, idetë, figurat letrare që nuk kanë asnjë formulë logjike në thelb, vijnë vetvetiu, mendoj. Kam njohur njerëz mendjendritur dhe shumë të artikuluar, por krijues të dobët. Pra, inteligjenca, aftësia për të kuptuar dhe komunikuar nuk mjafton. Talenti është një lloj tjetër mekanizmi me të cilin lindim, që unë e quaj dhuratë nga Zoti. Është një lloj bekimi, si bekimi që i ishte dhënë Jozefit, të birrit të Jakobit (në Bibël, Testamenti i Vjetër) për të interpretuar simbolikën e ëndrrave, gjë që i shpëtoi jetën atij dhe popullit të vet. Në një farë mënyre e tillë është edhe poezia, që më shumë se krijim është interpretim analogjik i asaj që ndodh jashtë dhe brenda nesh, një mënyrë kodifikimi.

HEJZA: Duke lexuar poezinë tuaj, seç krijohet përshtypja se Ju, pothuajse në çdo varg, në çdo poezi tuajën fshihni nga një ngjarje!

L. LLESHANAKU: Për të përfituar bursa, grante apo rezidenca letrare (ka plotë të tilla jashtë Shqipërisë), duhet të aplikosh, dhe pjesë e aplikimit është përshkrimi i projektit letrar, që do të thotë cila është përmbajtja dhe ideja e këtij projekti poetik. Për prozën, romanin, kjo nuk është e vështirë, sepse romani natyrisht ka një subjekt dhe një temë dhe ide qendrore. Por, çfarë mund të thuash për një vëllim poetik, ku çdo poezi sugjeron një ide më vete, tema dhe ngjarje më vete? Prandaj, jo rrallëherë më ka ndodhur të lexoj projekt-ide të kësaj natyre: "Do të punoj në një projekt poetik të frymëzuar nga poezia e X autori dhe marrëdhënia e tij me natyrën...". Se si

mund të shkruhet një libër mbi një libër tjetër këtë nuk e kuptoj, por kjo vjen si sforcim i detyruar pasi është e pamundur të japësh një ide të vetme përgjithëse mbi një përmbledhje poetike, ku çdo poezi funksionon si entitet më vete. Ndryshim bën vetëm libri-poemë, i cili, po, padyshim funksionon si një i tërë, mbi një ide të vetme bazë.

Uroj të jetë ashti siç thoni ju, që në çdo varg duket sikur fshihet një ngjarje. Kjo mendoj se vjen ngaqë poezia ime është konkrete, madje narrative kohët e fundit, më shumë se sa cerebrale. Skenat, imazhi, e sidomos detajet, i japin vitalitet poezisë duke krijuar hapësirë përfytyrimi dhe përfshirje të lexuesit si në një ngjarje në prozë.

HEJZA: Ju thoni se poezia ndodh! Nuk ka një kohë ekskluzive për ta shkruar poezinë! Ajo ndodhë dhe "ndodhia" hidhet në letër për disa minuta!

L. LLESHANAKU: Tamam! Por më shumë se një mbyllje brenda në dhomë para një makine shkrimi a një kompjuteri në pritje të ideve, mendoj se poezia është mënyrë të jetuari. Për mua poezia është gjithë ai proces përsiatjeje, reflektimi, analizimi, i cili shoqëron ngjarjet dhe veprimet tona sado të zakonshme qofshin, në përpjekje për të kuptuar logjikën e gjërave dhe botën që na rrethon. E thënë më fjalë të tjera, tendenca e poezisë është të zbulojë rregullat, ligjet e funksionimit të botës, të kodifikojë, pra është një mënyrë për të dalë nga kaosi. Kështu që unë rrallëherë, pothuajse kurë nuk shkruaj poezi atypëraty.

HEJZA: Si ta zgjerojmë tregun e leximit të shkrimtarëve shqiptarë! A mund t'i qasemi këtij tregu me tema tashmë të ezauruara nga shkrimtarët që qindra vite para shqiptarëve e kanë

shijuar lirinë dhe çlirim nga ngërçet fatale politike, ekonomike, sociale, kulturore etj. Sa kanë debatuar dhe sa kanë kuptuar shkrimtarët shqiptarë mbi atë se çfarë kërkojnë të lexojnë lexuesit e Perëndimit. Sa bëjnë institucionet tona shtetërore për ta bërë të njohur në tregun botëror krijimtarinë shqiptare, siç bëjnë për pataten e Kukësit, shalqirin e Shkodrës, rrushin e Rahovecit, specat e Ferizajt etj.

L. LLESHANAKU: Për koincencë, ju Shkëlzen, jeni nga shqiptarët e parë të përtej kufirit që kam takuar fill pas rënies së regjimit. Madje, ju kemi pasur edhe mysafir edhe në familje, dhe pastaj ne qemë mysafirët tuaj në Maqedoni, në vitin 1993, me sa mbaj mend... Ajo që më bërë përshtypje nga kjo përballje ishte se pavarësisht izolimit të gjatë, ne ishim shumë të ngjashëm, saqë dukej sikur nuk kishte rrjedhur gjithë ajo kohë të izoluar nga njëri tjetri. I njëjti konstrukt shpirtëror, temperament, botëkuptim, që i ka shpëtuar mrekullisht asimilimit. Prandaj më duket e drejtë kur dëgjoj të flisni për letërsi shqipe si një e vetme, pa dallim nëse është e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, apo Malit të Zi. Dhe kjo mund të thuhet jo vetëm për letërsinë që është e lidhur me gjuhën, por edhe për muzikën, stilin e jetesës, si format më rezistente të një kulture të përbashkët.

Unë nuk jam në gjendje të gjykoj letërsinë shqipe dhe sa ajo arrin të jetë e "eksportueshme", sepse, për shkak të gjuhës, shumëçka është në dorë të fatit. Por, mendoj se natyra sensacionale e tregut, ushtron një presion të madh mbi krijuesit, sidomos ata të gjuhëve të vogla që është edhe gjuha shqipe. Në kërkim të temave të mëdha, të të jashtëzakonshme, ekzotikes, si një mënyrë për të tërhequr vëmendje me forcë, autorët dalin jashtë natyrës

së tyre, shkojnë kundër impulsit të tyre të brendshëm. Dhe ka një ngut të rrezikshëm në këtë pjesë, që mund krijohet edhe një efekt të kundërt.

Mesa kam kuptuar unë, nuk është tematika thembra e Akilit; temat janë po ato, dhe pse të mbikonsumuara qëkur ka filluar të shkruhet letërsia. Sekretet e suksesit nuk qëndron në "çfarë", por në "si". Si do ta shkruash një histori, si do ta përcjellësh një ide, pasi shkrimtari nuk mund të dalë shumë përtej asaj përvoja që njih. Imagjinata luan rolin e mobiljeve, që mund t'i ndërrosh ngjyrën, stilin, mund t'i rinovosh, t'u ndërrosh vendin... por godina mbetet e njëjta, që është ajo përvojë që të është dhënë, ajo jetë që njih. Dhe nëse je mjeshër, edhe gjënë më të zakonshme, e shndërron në ar. Po marr një shembull ekstrem nga kinemaja: filmin "Kali i Torinos" të regjisorëve hungarezë Béla Tarr dhe Ágnes Hranitzky. I gjithë filmi prej 156 minutash duket sikur bazohet në dy-tre skena të vetme, që përsëriten sistematikisht dhe pa zë: mbijetesat e një kultivuesi patatesh me të bijën dhe kalin rrangallë, në një fshat të varfër hungarez në shekullin e XIX. Sido që ta marrësh, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo metaforike, filmi është një perlë. Pra, një histori e thënë me dy fjalë, ose aspak histori, por që krijon një interakcion të jashtëzakonshëm nga mënyra se si është konceptuar artistikisht, përmes një rituali të trishtuar, në sfond të erës së fortë që fryn jashtë.

HEJZA: Krijuesit kanë nevojë për ndihmën e pushtetit, pushteti i ik kësaj duke thënë se nuk ka nevojë që krijuesit "të politizohen". Kultura institucionale është jetike për çdo shtet e për çdo popull. Për Luljeta Lleshanakun më tepër ka bërë Amerika se sa Shqipëria. A guxojmë të lejojmë dhe të presin që identiteti ynë kulturor të varet nga ndihmat e huaja!

L. LLESHANAKU: Mendoj se edhe pushteti ka nevojë për krijuesit, dhe i ka përdorur jo pak deri tani, si në atë regjim, ashtu edhe në ditët tona. Rasti i godinës së Teatrit Kombëtar në Tiranë që një përvojë shumë e hidhur e ndërhyrjes flagrante të pushtetit në përçarjen dhe manipulimin e artistëve. Por, pushtetit i duhesh vetëm një herë, sepse po e shite njëherë lëkurën, ke humbur kredibilitetin, dhe as pushtetit nuk i duhesh më. Dhe njerëzit, çuditërisht mund t'ia tolerojnë një politikani zullumet, por nuk mund t'ia falin aktorit të tyre të adhuruar, këngëtarit, apo shkrimtarit me shkrimet e të cilit është rritur. Me njerëzit e artit, mendoj se krijohet një raport mjaft delikat.

Kultura institucionale dhe institucionet kulturore janë dy gjëra të ndryshme. Ne nuk kemi qenë në gjendje të ndërtojmë institucione, e aq në pak institucione kulturore, gjë që në një farë mënyre shpjegon edhe depressionin kulturor të dekadave të fundit. Institucionet veprojnë mbi bazë të rregullave, drejtohen nga programe dhe individë të aftë, me vizion dhe të përgjegjshëm (flas për Shqipërinë, që njoh). Dhe kjo paaftësi për të ndërtuar institucione nuk mund t'i vishet vetëm politikës por gjithsecilit prej nesh, një paaftësi që ka të bëjë me qytetarinë, etikën e administrimit, emancipimin social, dhe përgjegjësinë morale. Institucioni fillon nga individi. Por, një shoqëri që e ka kthyer në moto të veten "KÇK" ("kap çfarë të kapësh"), sikur nuk ka se çfarë të humbë më, të kujton një lloj babëzie dhe paniku në prag katastrofe, sikur e nesërmja të ishte dita e fundit e jetës. Pra, veprojmë si një shoqëri pa të ardhme. Ndaj edhe



kush mundet po ia mbath, ashtu me shpirtin nëpër dhembë, duke marrë rrugët e botës. Është ky korruptim shpirtëror që sinjerisht më ka brengosur shumë. Kuptohet që në rrethana të tilla është luks i madh të diskutosh për kulturë... Dhe ndodh pastaj që marrim hua arbitër të huaj, siç ishte rasti i prokurorit belg në komisionin e Vettingut, apo kineastët e huaj në komisionet e vlerësimit të projekteve filmike... Besojmë më tepër tek të huajt, se tek njëri-tjetri, dhe këtu nuk ka vend për vetë-respekt.

HEJZA: Jemi ngritur peshë si popull e si shtete si t'ia bëjmë që t'i rehatojmë politikisht serbët në një "zajednicë", ndërsa deri më sot, as një për qind të kësaj brengje nuk e kemi shprehur se si t'ia bëjmë që ne, si shqiptarë, të paktën ta realizojmë bashkimin kombëtar në aspekt kulturor! Institucionet shtetërore ne edhe sot i quajmë si "institucione nacionale", apo "kombëtare"! Në fakt, këto institucione na mungojnë për shkak të politikave tona të ngurta që bazohen te bajraktarizmi ynë autokton! A mendoni se ka ardhur koha të kemi një tetarë kombëtar, një filarmoni kombëtare, një operë dhe balet kombëtar, një union kombëtar të shkrimtarëve shqiptar dhe, këto aktualitet që i quajmë "institucione nacionale", të decentralizohen dhe të ngelin institucione nacionale të qyteteve dhe komunave tona?

L. LLESHANAKU: Mendoj që nëse ka ndodhur deri tani ndonjë lloj bashkimi midis trojeve shqiptare, ai është bashkimi kulturor, ngaqë një lloj bashkimi të tillë nuk mund ta bllokojnë kufijtë

dhe politikat e vendeve përkatëse. Ky lloj bashkimi ka ndodhur më shumë me Kosovën që natyrisht është më homogjene, se sa me Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi. Unë vetë kam një libër të botuar në Kosovë; gjysma e studentëve të mi në Akademinë MARUBI ishin nga Kosova dhe Maqedonia, dhe kam dhënë më shumë prezantime në Kosovë gjatë dhjetë viteve të fundit se ç'kam dhënë në Shqipëri. Madje, po ta vësh re, dialekti shqip i Kosovës dhe Maqedonisë, po kthehen në një trendi në muzikë dhe në televizion në Shqipëri vitet e fundit. Pra, megjithëse ngadalë, dhe pavarësisht politikave zyrtare, unifikimi po ndodh. Por, nuk jam e sigurt që centralizimi institucional do të sillte diçka të mirë; mendoj se ne nuk jemi gati për një hap të tillë, pasi akoma nuk jemi shkëputur nga mendësia e imponuar e shtetit totalitar, logjika centralizuese, ku çdo gjë përfundon në dorë të një grupi njerëzish. Mendoj se ajo për të cilën kemi nevojë ne tashti janë iniciativat e pavarura, sa më shumë më mirë, pasi nxisin lirinë e mendimit dhe reflektimin individual, për të pretenduar pastaj në një nivel vetëdije tjetër si shoqëri.

HEJZA: Në ndërkohë, a kanë ndodhur mjaftë ngjarje interesante që do t'i gjejmë te poezia më e re e Luljeta Lleshanakut që po e shkruan sot. Kur pritet të dalë vëllimi më i ri i Luljetës dhe ç'libër do të jetë ai. Apo, krijuesi deri në frymën e vet të fundit e shkruan një dhe po të njëjtin libër!

L. LLESHANAKU: Unë kam mjaft poezi të reja, por kjo nuk do të thotë doemos

që kam një libër të ri. Një libër i ri, është një kapitull i ri, një fazë, një perspektivë, dhe si i tillë duhet të sjellë patjetër një lloj risie, jo për botën natyrisht, por së paku për veten autorin. Unë kam një zakon shumë të keq, që pothuajse kurrë nuk e quaj të përfunduar një poezi; sa herë që i kthehem, ndjej se diçka i mungon, dhe ka nevojë ose të rishkruhet ose të hidhet. Ndërkohë, kur rrinë gjatë, ato "vjetrohën" në sirtar, në kuptimin që humbin freskinë, aktualitetin, sepse ngjarjet dhe idetë që burojnë prej tyre, lëvizin me një dinamikë tjetër. P.sh, sado e goditur të jetë poema që kam shkruar gjatë kulmit të pandemisë, nuk mund të përcillet më me të njëjtin intensitet dramatik tre apo katër vjet më pas. Plus që çdo libër të ri me poezi, unë e konceptoj si një trup njerëzor, i cili pavarësisht tematikave të ndryshme, ka një zemër që i jep jetë, ka një bosht, ka një fytyrë. Dhe kjo përmbledhje që unë kam në dorë, nuk e ka akoma atë bosht. Kështu që nuk e di akoma se si dhe se kur do të jem gati për ta botuar...

Ndërsa proza teorikisht më duket shumë më argëtuese, edhe pse vitet e fundit, në situatën që ndodhëm, mezi gjej kohë të shkruaj ndonjë email, e jo më prozë. Them "argëtuese", sepse është si një udhëtim me tren, krahasuar me poezinë që është si një fluturim me avion, bota e parë nga sipër. Proza është më afër tokës, më intime, dhe duket sikur do të më japë mundësinë t'i rikthehem me një lloj prekjeje tjetër lëndës, duke zbuluar nuancat, tablonë e vogël të gjërave, gjë që poezia nuk ta lejon. Por, hëpërhë, mbetet thjesht një dëshirë e imja!

LOJA E GJUETARËVE TË POETËVE FILLESTARË

Letërsia e shkruar dhe kritika duhet të ecin paralel njëra me tjetrën, pa pritur të bien mrekullitë nga qielli. Shkrimtari dhe poeti shkruan, ndërsa kritiku i vërtetë evidenton dhe orienton

Agim BAJRAMI

Zhbërja e institucioneve të kulturës dhe librit tek ne, fatkeqësisht u pasua edhe me zhbërjen edhe të institucionit të rëndësishëm të kritikës letrare. Në fakt, jo se edhe më parë e kemi pasur një institucion të specializuar në këtë fushë, por është fakt që nga shteti i atëhershëm, kishte një lloj interesimi sado të pakët edhe për këtë fushë. Me sa di unë atë kohë në intervale të caktuara ekzistonte një kurs i kritikëve letrarë, pa harruar këtu praninë e emrave të tillë, si Dalan Shaplo, Adriatik Kallulli, Shaban Sinani, Bashkim Kuçuku, Jorgo Bullo, Aurel Plasari (pjesa më e madhe e tyre përgatitur në perëndim dhe lindje etj.), të cilët pak a shumë kanë dhënë kontributet dhe përvojat tyre të vyera në këtë fushë. Ikja ose largimi i tyre e ka bërë të padukshme dhe pothuajse inegzistente praninë dhe rolin e saj në letërsinë që shkruhet sot. Për fat të keq, kritika që pretendohet se bëhet sot, e ka humbur prej vitesh karakterin e saj gnosisologjik (nëse nisemi nga një përcaktim i thelluar i prof. M. Krajës në një studim për kritikën dhe gjendjen e saj në Shqipëri dhe Kosovë). Duke ju shmangur analizës së thellë dhe karakterit shkencor, ajo vijon të vegjetojë në hullitë e saj formaliste dhe të cekëta, pa arritur të depërtojë në brendinë e tekstit dhe pa arritur të analizojë gjakun dhe adrenalinën e letërsisë sonë kontempore. Shumica e autorëve të sotëm, nuk mund ta vënë veten mes veprës dhe autorit, të shpjegojnë marrëdhëniet mes personazhit dhe kohës së tij, raportet mes



reales dhe ireales, ideve që gjeneron një vepër etj. Shumica harrojnë se kritik nuk të bëjnë vetëm shkolla dhe studimet (universitare apo pasuniversitare), nëse nuk ke nuhatje të mprehtë dhe aftësi vizionare. Në këtë kontekst janë të rralla në shtyp kritika dhe vështrime të thelluara profesionale, për vepra të veçanta dhe autorë që premtojnë. Edhe këto duket se shkruhen me porosi nga autorë lobimesh letrarë, e për më tepër nga pedagogë të Fakultetit të Gjuhë Letërsisë Shqipe të Universitetit të Tiranës, që nuk e kanë stofin e veçantë të kritikut.

Një rol negativ këtu ka indiferenca e institucioneve përkatëse, që janë pajtuar në heshtje me këtë ngërç dhe këtë situatë paradoksale. Kam lexuar diku, se janë prurjet e pasura letrare ato që nxisin zhvillimin e këtij zhanri, risitë dhe arritjet. Në fakt, unë do të thoja të kundërtën e kësaj. Letërsia e shkruar dhe kritika duhet të ecin paralel njëra me tjetrën, pa pritur të bien mrekullitë nga qielli. Shkrimtari dhe poeti shkruan, ndërsa kritiku i vërtetë evidenton dhe orienton. Dihet që në kohëra vakumi dhe krizash të tilla, ngrenë kokat dhe bëhen aktivë të ashtuquajturit kritikë

kafenes, ose gjuetarët e poetëve fillestarë. Dhe pse pa lidhje të sinqerta me kritikën, ata janë të aftë të luajnë me naivitetin e tyre, duke ditur të fshehin me kujdes profaninë e tyre letrare, duke marrë shpesh herë të drejtën e fjalës hapëse dhe mbyllëse në shtyp, në ekrane dhe tryeza promovimesh hipokrite, me një gotë verë dhe patatina, janë gjithlogë që për 100 euro, janë gati të ngrenë në pedestal lloj-lloj grafomani që e konsideron veten shkrimtar, por që shkruajnë nga gjashtë libra në vit me bejte dhe histori pa vlerë, injorantëve të gjuhës shqipe, që fjalën dhallë e shkruajnë llallë dhe pyetjen ç'kemi e shkruajnë q'kemi. Para ca ditësh njërin prej tyre e ndoqa duke folur në një ekran televiziv për librin e katërt të një fëmije, që s'i kishte kaluar akoma dhjetë vjet. Por që, sipas tij, po sillte një frymë të re në poezinë tonë. Lind pyetja: si mund të shkruajë katër libra një dhjetëvjeçarë në një periudhë kaq të shkurtër kohore dhe ç'risi mund të sjellë në poezinë tonë një fëmijë pa kulturë letrare dhe përvojë. Natyrisht unë nuk i vë faj fëmijës, por pseudokritikut dhe redaktorit, që ia ka mbushur mendjen vogëlushes, për talentin e saj të jashtëzakonshëm. Sigurisht që të tillë mashtroesve panegjrikë dhe zëdhënës të pështirë të korit të gjinkallave dhe buburrecëve letrarë i duhet mbyllur goja. Por si? Unë mendoj se ka ardhur koha që të kemi më në fund një ekip të zgjedhur kritikësh të zotë, egzigjentë dhe gjakftohtë në punën e tyre studimore, pasi prania e një kritike të shëndetshme letrare është si oksigjeni për gjakun.

Pikëpamje

NJË HISTORI TË RE PËR LETËRSINË SHQIPE

Popujt me kulturë kanë vazhduar të shkruajnë histori të letërsisë së tyre, kriteret për përpilimin e të cilave kanë pësuar ndryshime nga një periudhë në tjetrën...

Zyrafete SHALA

Studiues dhe teoricienë të letërsisë të njohur ndërkombëtarisht, kanë vënë në dilemë shkrimin e historisë së letërsisë, duke u mbështetur në faktin se historia dhe letërsia janë dy fusha të ndryshme dhe është vështirë të shkruhet diçka që mund t'i bëjë bashkë të dyja këto. Mirëpo, pavarësisht nga kjo, popujt me kulturë kanë vazhduar të shkruajnë histori të letërsisë së tyre, kriteret për përpilimin e të cilave kanë pësuar

ndryshime nga një periudhë në tjetrën... Hartimi i një historie të re të letërsisë shqipe është i domosdoshëm dhe stërzgjatja e diskutimeve rreth kësaj çështjeje vetëm se janë duke e dëmtuar kulturën tonë. Që nga hartimi i historisë së letërsisë, që ende është në shfrytëzim, në botën shqiptare ka ndërruar shumëçka, prandaj edhe ky tekst është i jashtëkohshëm dhe i mangët në informacione. Dihet se jo vetëm shkrimtarë, por breza të tërë shkrimtarësh, periudha të tëra kanë mbetur jashtë faqeve

të kësaj historie. Krahas vullnetit dhe punës titanike të studiuesve të letërsisë, duhen edhe kriteret të qarta mbi të cilat duhet mbështetur përzgjedhja dhe klasifikimi i shkrimtarëve. Kam vërejtur se vitet e fundit, në mesin e kritikëve dhe studiuesve të rinj të letërsisë, sikur është krijuar një aversion ndaj shkrimtarëve që ishin të suksesshëm në periudhën e realizmit socialist. Edhe në mesin e shkrimtarëve të kësaj periudhe ka mjaft të tillë, veprat e të cilëve mbeten monumente të letërsisë sonë. Është e

natyrshme që studimet më tepër të orientohet nga shkrimtarët që ishin të anatemuar dhe si të tillë veprat e tyre nuk arritën në komunikojnë me lexuesin shqiptar për një kohë të gjatë, por në asnjë mënyrë nuk pajtohëm se vlerësimi i tyre duhet të bëhet duke i mohuar disa të tjerë. Ne, si popull me një letërsi të re dhe shumë të brishtë, krahasuar me letërsinë e popujve të tjerë, duhet të jemi këmbëngulës dhe shumë të kujdesshëm në ruajtjen e vlerave letrare e kulturore.

Në peshojë

A KA NEVOJË E BUKURA PËR SHPIRT!

E dimë shumë mirë se shpikjet shkencore shpesh përdoren për qëllime joetike - mendoni për armët bërthamore, biologjike ose kimike. I ngjashëm dhe akoma më i vështirë është fenomeni i ndërgjegjes dhe njohjes. Shkencëtarët studiojnë trurin, psikologët punojnë në kërkime të shumta mbi natyrën e vetëdijes, por vështirë se mund ta shpjegojnë plotësisht thelbin e saj

Nga Metin IZETI

Besimi (religio) dhe mosbesimi (areligio) janë dy dukuri të kundërta në të cilat njeriu është vendosur që nga agimi i qytetërimit njerëzor, deri në fundin e tij të mundshëm në kohën kozmike. Atë boshllëk në të cilin gjendemi, atë pjesë kohe dhe hapësirë që na është dhënë si dhuratë dhe në të cilën, jo me vullnetin tonë, jemi ngecur, duhet ta kuptojmë dhe ta përcaktojmë në mënyrën e duhur ose do të jemi të shtrydhur si fluturat në një herbarium, apo fosilet mes depozi-tave të gurëve, dhe duke mos ditur se çfarë na ka goditur. Në një kuadër të tillë, a e kryen njeriu misionin që i është besuar si përfaqësues i Zotit në Tokë, apo speciet njerëzore përfaqësojnë rezultatin e vallëzimit kozmik të materies, antimateries dhe energjisë, apo lojës evolucionare të sprovës dhe gabimit, apo ne thjesht është produkt i një rregullimi të rastësishëm të atomeve...

Besimi zakonisht përkufizohet si besimi në të vërtetën e një pretendimi pa verifikim ose provë. Në një kontekst më të gjerë, besimi është një aspekt i themelit shpirtëror dhe moral të shoqërisë njerëzore që ne përgjithësisht e quajmë fe. Në një kontekst më të ngushtë, besimi është qëndrimi ynë personal ndaj vetes dhe botës në të cilën jetojmë, i gjithë këndvështrimi ynë dhe më pas mënyra e jetesës që rrjedh nga ky besim. Fetë monoteiste mbrojnë Zotin si Krijuesin e botës, të cilin Ai e drejton si të tillë sipas parimit të rendit hyjnor, universal. Feja është "në thelb, rilidhja (ribashkimi) e njeriut me të Vërtetën që e kapërcen atë dhe që në të njëjtën kohë qëndron në qenien e tij më të brendshme". Sipas Kuranit Zoti manifestohet dhe konfirmohet dhe prania e Tij ndihet në botën reale. Në relacion me mosbesimin shpeshherë mënyra më e mirë për të ndërjerë praninë e Zotit në natyrë thuhet që është shkenca dhe studimi, sepse, veçanërisht në teorinë islame të shekullit njëzet dija për fenë, pra "teologjia islame, është sqaruar si shkencë natyrore që na e zbulojnë ligjshmërinë dhe bukurinë e përsosur të proceseve dhe rrjedhave në natyrë. Por besimi në Zot ka një kuptim shumë më të thellë sesa njohja shkencore dhe njohja e ekzistencës së Tij. Ajo duhet të sjellë harmoni dhe bukurie në jetën e natyrës, në jetën e njeriut. Sepse, përveç njeriut, çdo gjë në të gjithë natyrën ndodh në mënyrë të pandërprerë në harmoni të plotë me natyrën dhe vullnetin e Zotit, sipas ligjeve dhe formulave të Zotit, sepse natyra i është nënshtruar Krijuesit të saj.

Ata që nuk kanë bindje teiste, ateistët (greqisht: Atheos - pa Zot), botëkuptimin e tyre e bazojnë në materializmin, duke marrë materien si parim parësor të botës. Ata i atribuojnë kësaj materie një lloj inteligjence, vetëlëvizje me fuqinë e energjisë së vet si një atribut bashkë-jetues, duke i dhënë asaj aftësinë dialektike për të formësuar dhe transformuar sipas parimit të evolucionit, i cili nuk ka nevojë as për Zotin, as për shpirtin, nuk ka lidhshmëri me origjinën, zhvillimin dhe zhdukjen e tij. Sipas këtij parimi, produkt i materies "inteligjente" është vetë njeriu, i cili njihet se ka dimension shpirtëror, por në thelb konsiderohet material. Në Dialektikën e Natyrës, Engelsi pohon se "ndërgjegjja dhe mendimi përfaqësojnë vetëm një gjendje të caktuar të materies shumë të organizuar të trurit njerëzor". Nga ana tjetër, biologu molekular Hubert Jockey pyet



veten: "Nëse jeta është vetëm materiale, atëherë krimet e Hitlerit, Stalinit dhe Mao Ce Tung nuk kanë pasojë". Nëse njerëzit janë thjesht materie, nuk duhet të jetë më keq të djegësh një ton njerëz sesa të djegësh një ton qymyr?"

Kur marrim parasysh fenë dhe shkencëtarët e famshëm, thënia e Albert Ajnshtajnit citohet shpesh: "Shkenca pa fe nuk është përfundimtare, dhe feja pa shkencë është e verbër." Raymond Ruyer në librin The Gnosis of Princeton citon Ajnshtajnin të ketë thënë për materien se "nuk mundet më të shpjegohet pa adresuar hipotezën e Shpirtit. E gjithë lëvizja e jetës në Tokë zhvillohet sipas ligjeve dhe mekanizmave të një sofistikimi dhe një inteligjence të tillë të jashtëzakonshme, sa që ato nuk mund të jenë rezultat i rastësisë." Në mënyrë që shkenca të shpjegojë të gjitha këto mekanizma, është e nevojshme të përdoret ndërmjetësimi i një inteligjencë më e lartë dhe organizative, Zoti apo "I Vjetri", siç i pëlqente të thoshte Ajnshtajni. Galileo Galilei deklaroi se ai "nuk ndihet i detyruar të besojë se i njëjti Zot që na pajisi me vetëdije, arsye dhe intelekt donte të predikonte Vetën në përdorimin e njerëzve". Është e njohur edhe thënia e Francis Bacon, e cila thotë se "një njohje sipërfaqësore e shkencës, e vetëkënaqur, do të na bëjë ateistë, por një njohuri e thellë e shkencës me siguri do të na bëjë besimtarë", gjë që konfirmohet nga ndjekësit e Princeton Gnosis-it. Edhe pse edhe sot, në shekullin e 21-të, nuk është shumë komode të jesh një besimtar eksplicit dhe në të njëjtën kohë një shkencëtar i famshëm, Francis S. Collins (Drejtor i "Genome Research Institute" i cili publikoi një hartë të gjenomit njerëzor në 2000) përpigjet t'i bashkojë të dyja. Në librin Gjuha e Zotit (siç e quajti ai strukturën e ADN-së së gjeneve njerëzore), ai thotë se dyshimet për mundësinë e harmonisë midis besimit dhe shkencës duhet të hiqen. Sepse, "nëse Zoti është krijuesi i gjithë universit, nëse Zoti do të kishte një plan të veçantë për ardhjen e njerëzimit në skenë dhe nëse do të kishte dëshirë për një marrëdhënie personale me njerëzit në të cilët ai futi ligjin moral si udhërrëfyes për veten e tij, atëherë unë nuk mund ta kërcënoj atë me përpjekjet e mendjeve tona të mjerë për të kuptuar madhësinë e krijimit të tij. Në këtë kontekst, shkenca mund të jetë një formë adhurimi". Ariel Roth në librin Shkenca zbulon Zotin pyet: "A ka nevojë njeriu për fe, pra, për të besuar në Zot? Po. Por në dritën e të gjitha fakteve që tregojnë për një Projektues të krijimit, duhet shumë më pak besim për të besuar në Zot sesa për të besuar se e gjithë saktësia, kompleksiteti dhe kuptimi që gjejmë në natyrë ka ardhur thjesht rastësisht." Rasti u refuzua gjithashtu si opsion nga Ruder Bošković, i cili ishte kryesisht

fizikan dhe nuk shkroi për filozofinë e fesë, por megjithatë në veprën e tij kryesore Teoria e Filozofisë Natyrore ai shkroi një Shtojcë që i referohet reflektimeve të tij mbi shpirtin dhe Zotin, ku thotë: "Sa për Krijuesin Hyjnor të natyrës, teoria ime e ndriçimit mrekullisht dhe prej saj lind nevoja për ta njohur atë dhe fuqinë e tij më të madhe e të pafundme, urtësinë, providencën, gjithçka që ngjall tek ne respekt të thellë, dhe në të njëjtën kohë mirënjohjen dhe dashurinë, dhe për këtë arsye anulohen ëndrrat e syve të atyre që besojnë se bota u krijua rastësisht ose se mund të ishte krijuar rastësisht nga ndonjë domosdoshmëri fatale".

Filozofi britanik Julian Baggini pa dashje pranor se ateizmi, në masën më të madhe, ka të bëjë me besimin, se vetëm racionalizmi dhe materializmi, pa besim, nuk mjaftojnë: "Shumica e ateistëve besojnë se ekziston vetëm një lloj i materies në univers, dhe ai është i një natyre materiale, por që prej saj lindin mendjet, bukuria, ndjenjat, vlerat morale - me pak fjalë, e gjithë gama e fenomeneve që i japin pasuri jetës njerëzore. Mendimet dhe ndjenjat njerëzore lindin nga ndërlikimet jashtëzakonisht komplekse të entiteteve materiale në tru. Një ateist në këtë kuptim të një natyralisti filozofik beson se nuk ka asgjë përtej botës natyrore, fizike..." Thirrja ekskluzive e ateistit ndaj shkencës gjithashtu nuk mund të përjashtojë një lloj besimi, siç vërehet nga Terry Eagleton, duke komentuar iluzionin e Zotit të Dawkins, në librin Arsyeja, besimi dhe revolucioni ku thotë se "shkenca, ashtu si feja, ka kryepërftëritë e saj, lopët e shenja, shkrimet e shenja, përjashtimet ideologjike dhe ritualet për të shtypur apostazinë. Është kaq qesharake të shohësh tek ajo të kundërtën polare të fesë. Megjithëse libri i Dawkins "Iluzioni i Zotit" është çuditërisht i rrallë në lidhje me katastrofat dhe fatkeqësitë e shkencës (ai kritikon Inkuizicionin, për shembull, por jo Hiroshimën), shumica prej nesh janë të vetëdijshëm se, si shumë kërkime të tjera njerëzore, edhe shkenca është shumë më e rrezikshme, më e pasigurt, më e çrregullt dhe e përcaktuar nga fati dhe rastësia, dhe se shumë që merren me të nuk do të ndalen para asgjëje vetëm për të ruajtur disa hipoteza të provuara dhe të vërtetuara relativisht. Prandaj, shkenca ka të bëjë gjithashtu me besimin - dhe kjo nuk është e vetmja gjë që e ndan me fenë." Është e qartë se shkenca nuk mund të jetë neutrale vlerësuese dhe ideologjike, sepse ajo është vazhdimisht e ekspozuar ndaj ndikimeve politike dhe financiare. Hulumtimi paguhet nga kompani private ose qeveritare dhe kushdo që ju paguan ju duhet t'i bindeni! Ne gjithashtu e dimë shumë mirë se shpikjet shkencore shpesh përdoren për qëllime joetike

- mendoni për armët bërthamore, biologjike ose kimike. I ngjashëm dhe akoma më i vështirë është fenomeni i ndërgjegjes dhe njohjes. Shkencëtarët studiojnë trurin, psikologët punojnë në kërkime të shumta mbi natyrën e vetëdijes, por vështirë se mund ta shpjegojnë plotësisht thelbin e saj. Dhe pikërisht, me ndihmën e kësaj ndërgjegjeje, trurit, arsyes dhe shqisave tona, shkencëtarët perceptojnë edhe botën përreth tyre, si dhe rezultatet e tyre shkencore.

Sigurisht që na duhet arsye për të kuptuar, të paktën në parim, fizikën e sotme, e cila studion entitete si atomet, elektronet, kuarkët, leptonet, bozonet dhe grimcat e tjera të çuditshme, asnjë prej të cilave nuk mund ta shohim në kuptimin klasik të fjalës. Ato janë përtej aftësisë sonë për të perceptuar, por ekzistojnë në teoritë fizike dhe ne marrim konfirmimin e ekzistencës së tyre në eksperimente shkencore. Kështu, sipas kromodinamikës kuantike, protoni, neutroni dhe shumë grimca të tjera elementare të materies përbëhen nga kuarkë, të cilët fizikanët i quajten në mënyrë argëtuese - të kuqe, jeshile dhe blu. Për më tepër, çdo kuark ka antigrimcën e tij partnere - antikuqe, antijeshile dhe antiblu. Prandaj, themeli i fizikës kuantike të sotme janë grimcat e padukshme, imagjinare. Vetëm mbani mend, ju lutem, sa shumë ateistët dhe materialistët talleshin me parimin islam të besimit në gajb - botën e padukshme. Kur një kuark (materie) dhe një antikuark (antimaterie) takohen, ato anulohen dhe prodhohet vetëm rrezatim. Është magjepsëse të dihet se në fazën e hershme të Big Bengut, kur u shfaqën kuarkët, për çdo miliard çifte kuark/antikuark, kishte një kuark shtesë - nga kjo asimetri, lindi universi aktual. Një kuark imagjinar i kuq, jeshil dhe blu, është një vorbull energjie brenda bërthamës së një atomi

Në laboratorin e CERN-it, pohojnë se në vitin 2012 gjetën grimcën e Zotit ose bozonin Higgs (ai shpjegon ekzistencën e masës). Imazhet e publikuara vijnë nga mikroskopit elektronik më i madh në botë i quajtur ATLAS. Është një cilindër 25 metra i gjerë, 45 metra i gjatë dhe peshon 7 mijë tonë. Ai kap gjurmët e përplasjeve të grimcave dhe i transmeton ato në një rrjet prej 5000 kompjuterësh që përpunojnë të dhënat dhe përpigjen të rindërtojnë një pamje të protoneve që përplasen me njëri-tjetrin me pothuajse shpejtësinë e dritës. Saktësia e njohurive shkencore dhe asaj që ato na paraqesin varet nga besueshmëria dhe saktësia e ATLAS-it. Një problem i veçantë lind nëse duam të shohim një grimcë të vogël, siç është një elektron, sepse përpjekja jonë për ta vëzhguar atë mund të ndryshojë rrjedhën e procesit që po vëzhgojmë! Domethënë, kur një foton i dritës godet një elektron, ai mund ta hedhë atë nga rruga e tij me kuantumin e tij të energjisë, që do të thotë se, nëse kjo ndodh, imazhi që na sjell fotoni i reflektuar nuk është ai që supozohej të shihnim, por një tjetër.

Si duket ateizmi, në trajtë imagjinative i bazuar në shkencën, është më dogmatik se sa feja e bazuar në traditën e zbulësës hyjnore. Fetari është shumë më i sigurt dhe i bindur në faktet e zbulësës se sa shkencëtari në faktet e zbulimit të tij. Kjo kështu edhe për përmasat e materies dhe natyrës, siç u tha më lartë, e mos të diskutojmë, për shpirtin, vetëdijen, mendjen, imagjinatën....

ATDHEU SI OBJEKT DHE SI SUBJEKT NË LETËRSINË SHQIPE

Vështrimi i atdheut si objekt sikur e zbeh marrëdhënien individ- atdhe. Tradicionalisht atdheu është parë si objekt dhe jo si subjekt

Yzedin HIMA

Shpesh fjalën atdhe e përdorim me lehtësinë e një nxënësi fillorist, që lakon një emër çfarëdo në të gjitha rasat. Në tekste atdheu shihet si objekt: "Duaje atdhenë si shqiponja folenë" ose "Atdhetar është ai, që e do atdheun edhe kur atdheu i bën padrejtësi." Tek këto dy thënie, atdheu shihet si i ndarë nga njeriu, diçka si unë (subjekti) dhe atdheu (objekti). Në fakt, për mendimin tim, ky është kënd i gabuar i vështrimit të atdheut. Nëse atdheun do ta shohim si subjekt dhe jo si objekt, atëherë e kemi më të lehtë edhe për të kuptuar se ç'është atdheu. Nëse themi se atdheu fillon tek unë, tek ti, tek ai, tek ajo, atëherë dukuria, nocioni merr substancë, bëhet më konkret (ti, unë, ajo, ai,) si fillesa të atdheut fizik dhe moral njëherësh: ti dhe gjuha shqipe, përrallat e gjyshe, ninullat e kënduara dhe "të mbjel-la" tek ti nga nëna dhe mund të vijmë në një përfundim që mbetet gjithë jetën në mendjen e secilit: kur ti shkon në një vend të huaj, e merr atdheun me vete në të dy format, edhe atdheun fizik (ti), edhe atdheun moral (gjuhën, mentalitetin, zakonet, këngët, historinë, kulturën etj.) Nëse do ta shohim atdheun si të tillë, atëherë thënie apo këshillat: "Ta duam atdheun", "Duaje atdheun" e kanë të zbehur kuptimin. Vështrimi i atdheut si objekt sikur e zbeh marrëdhënien individ- atdhe. Tradicionalisht atdheu është parë si objekt dhe jo si subjekt. Naim Frashëri e shikon atdheun pranë, rreth e rrotull tij, por jo tek vetja:

*O Atdhe! Më je i dashur sa më s'ka
Më je nënë, më je motër, më je vlla.*

Edhe Asdreni e shikon atdheun si objekt:

*Të fala të dërgoj,
këndej ku jam Atdhe,
gjithnjë po të kujtoj,
se birin tënd më ke.*

I njejtë këndvështrim ndeshet edhe te Gjergj Fishta:

*Por një fushe ma e bleret nuk shtrohet,
Por një mal ma bukur s'rri,
Ma i kulluet një lum s'dikohet,
Moj Shqypni, pors i ke ti.*

Në tekstet poetikë të Arshi Pipës dhuna e diktaturës mbi të burgosurit politikë shihet si dhunë mbi atdheun. Në planin semantik kjo justifikohet në radhë të parë me faktin se, duke ushtruar terror mbi qytetarin shqiptar, ky terror është ushtruar mbi atdheun, sepse çdo qytetar i këtij vendi është pjesëz e atdheut:

*Qysh pra vëllezni tanë punuen mbi ne
t'atillë një dhunë qi s'banë as Turq as Shqë?
Nga trolli i vendit duel e rrit kjo farë?
Nji djall e mbollti te një vend i verbën.*

Në një tekst poetik Trifon Xhagjika, poet i pushkatuar nga diktatura, sheh atë që të tjerët ose nuk e shihnin, ose bënin sikur nuk e shihnin, ose e mbulonin dhe e zbukuronin. Portreti i atdheut në këtë tekst është realist, madje i vizatuar fatalisht si i tillë dhe në perspektivë:

*Një vend i ëndërrave pa fat
një vend latydësh të tërbuar,
një vend i mendjeve sakate,
me turp kusari mbuluar,
Një vend me fjalë kotësie,
ku vdekja e fshehtë është modë,
ku drita e Diellit u bë hije,
Atdhe i dashur je ti sot.*



Bilal Xhaferrri në një tekst të tij poetik e sheh atdheun subjektivisht:

Vend i vogël
Kohë e vogël
Rracion i vogël.
Errësirë e madhe
Frikë e madhe
Mjerim i madh.

Po ashtu edhe Fatos Arapi e sheh atdheun brenda vetes:

atdheu është buka e uritur,
të ikën nga duart e dot nuk e ngop;
endërr dhe ankth dhe shpresë e sflitur;
me sytë n'errësirë vetveten kërkon.

Edhe Ali Podrimja e shikon atdheun te vetja:

Toka ime digjet në çdo pëllëmbë të trupit
tim - toka e mallkuar.

Ndërsa Mihal Hanxhari ka një vështrim tejet modern të atdheut:

Shpëto o Zot vetëm sytë e fëmijve të Kosovës
O Zot shpëto ata sy të kaltërt të peshqëve blu
Që flenë në shi dhe ëndërojnë engjëjt e tu.

Poeti Martin Camaj e shikon atdheun tek vetja. Atdheu rritet, merr përmasat morale dhe fizike me rritjen e unit poetik dhe shndërron në këngë (poezi):

Verat e lugjeve i ruej në parzëm

Tingujt e currilave në lagsina
e zani monoton i pipzës fëminore
me mote n'mue janë rritë,
lule gjaku në shullaje
për të dalun kangë një ditë.

Më kanë mbetur në mendje dy vargje origjinalë të poetit Ilirian Zhupa, i cili e koncepton pak a shumë kështu atdheun:

Atdheu im në grykë komp
as të gëlltis, as të vjell dot

Dikush me guxim thotë se atdheu është zhgualli i breshkës, që nuk na lë të largohemi larg lëndinës (atdheut) dhe na mbron sa herë rrezikohemi të na godasin (shpesh nacionalizmi, korraca e breshkës, është strehë e sigurt.) Po pyetjeve se nëse atdheun fizik (malet, fushat, kodrat, bregdetin, fabrikat, shitoret i privatizuan (ose i grabitën me ligj), atëherë ku është atdheu im? Mos mbeta pa atdhe?! Mos duhet të iki nga sytë këmbët në kërkim të një atdheu tjetër?! Me një gjysëm zëri mund të përgjigjemi se nëse u grabit atdheu fizik, atdheun moral nuk na e grabisin dot: gjuhën, ninullat, përrallat, këngët, historinë, zakonet, traditat mund t'i deformojnë, por nuk mund t'i privatizojnë. Për atdheun gjatë viteve kemi lexuar tekste që përcillnin dy lloje dashurish: dashuri romantike dhe dashuri intelektuale. Dashurinë romantike e takojmë te poetët tanë të Rilindjes dhe tek poetët e socrealizmit. Aty atdheu vizatohet siç duhet të jetë, jo siç është. Tek të parët për

arsye patriotike, ndërsa tek të dytët nga frika ose për arsye ideologjike.

Një ndër atdhetarët që e ka dashur atdheun me një dashuri intelektuale të pashtershme është Faik Konica. Ai e shihte Shqipërinë siç ishte, por falë kulturës së thellë dhe shpirtit të tij kritik kërkonte dhe e gjente Shqipërinë e vërtetë në thellësi të shekujve dhe tek vetja, atë të paplhurosorën nga shekujt, të padefor-muar nga pushtimet dhe qytetërimi i huaj. Si njohës i thellë i identitetit shqiptar të kahershëm, si një njeri me identitet të spikatur atdhetar, ishte buzëplasar nga identiteti i cenuar i shqiptarit dhe i identiteti i deformuar i atdheut. E vetmja "e metë" e Faik Konicës ishte se ai shihte atë që të tjerët nuk ishin të aftë ta shihnin: shqiptarin e dikurshëm europian pa shtresimit e pluhurave të huaj mbi kryet e tij dhe shqiptarin e fillimshkullit XX, i mbështjellë me lëvozhgat e kulturave apo qytetërimi të huaja. Ndërsa poeti Lasgush Poradeci e zbulon atdheun tek gjuha dhe e rikrijon atë mrekullisht prej gjuhe. Vësh-trimi kritik i vetes (atdheut) sot nuk është mungesë atdhedashurie apo nihilizëm, por dashuri e vërtetë për këtë vend dhe këta njerëz që duhet të bëhen çdo ditë më të mirë. Dallimi i mangësive, dobësive të atdheut te vetja është hap i madh qytet-ërues për të ndryshuar këtë vend. Dashuria për atdheun nuk vjetërohet, nuk ndrysh-ket kurrë, nuk del kurrë nga moda. Dashu-ria për atdheun është respekt për veten dhe ruajtje identiteti. Kurrsesi nuk mund të jesh qytetar i Botës, qytetar i Europës pa patur një identitet kombëtar.

"BARDHA E TEMALIT", DRAMA E GRUAS SI DRAMË E SHOQËRISË

Një vepër që ka krijuar gjithmonë grishje të reja interpretuese brenda korpusit të saj, mbetet padyshim "Bardha e Temalit", ku autori Pashko Vasa vë përballë dy figura femrash, Bardhën dhe vjehrrën e saj, të cilat predominohen nga parime tërësisht të ndryshme


Majlinda Nana RAMA

Letërsia shqipe, që në fillimet e hershme të saj, ka sjellë dinamizëm trajtesash, tematikash e motiveve, të cilat kanë qenë të lidhura domosdoshmërisht me ambientin shoqëror. Dy romanet e para, "Dashuria e Talatit me Fitneten" e Sami Frashërit dhe "Bardha e Temalit" e Pashko Vasës, edhe pse jo në gjuhën shqipe, kanë ofruar një pasqyrim të mentalitetit të kohës, ndonëse në kontekste të ndryshme hapësinore. Ndërsa Samiu ka pasqyruar gjendjen dhe fatin e gruas në shoqërinë osmane të kohës, Pashko Vasa ka sjellë një "rravim" të detajuar të një mjedisi thellësisht patriarkal shqiptar. Dhe është veçanti, po të kemi parasysh se kur janë shkruar dy veprat (përkatësisht 1872 dhe 1890), fakti që ato dëshmojnë për një frymë të emancipuar dhe revolucionare të dy autorëve të sipërpërmendur, duke synuar që këtë frymë të tyre ta injektjnë te shoqëria e kohës, për të ndryshuar qëndrimin dhe diskriminimin e saj ndaj gruas.

Në të vërtetë, nuk është se personazhi femëror ka krijuar një galeri të pasur në letërsinë tonë, por, gjithsesi, ka disa figura që janë skalitur gjatë periudhave të ndryshme, duke filluar që nga poema tregimtare "Revza" e Muhamet Çamit, që Hajdar Gjirokastriti dhe Jani Vreto do ta titullonin "Erveheja", "Emira" e Santorit, Rina dhe Serafina Topia të De Radës, "Andra e jetës" e Mjedës, Tringa e Fishtës, malësorja te Migjeni e duke mbërritur te Mariana dhe Erna të Kadarese.

Por, një vepër që ka krijuar gjithmonë grishje të reja interpretuese brenda korpusit të saj, mbetet padyshim "Bardha e Temalit", ku autori vë përballë dy figura femrash, Bardhën dhe vjehrrën e saj, të cilat predominohen nga parime tërësisht të ndryshme. Të proklamuar si dy specifika të veçanta, ato krijojnë diskurse shumëplanëshe, njëra më tragjike se tjetra. Ky roman është një pasqyrë kompletare e jetës shqiptare në messhekullin XIX në Shqipërinë e Veriut, me doket, zakonet, traditat, por, mbi të gjitha, me dominancë nga ana mentale dhe psikologjia gjykoese e vepruese e shoqërisë. Vetë titulli-temë "Bardha e Temalit", të nget drejt mendimit analitik: "Pse 'Bardha e Temalit?', duke të diktuar një lloj etiketimi pronësor të saj brenda linearitetit të atij mjedisi mbytyës e uzurpues.

Personazhi femëror i servitur në këtë roman, paradigme të saj ka fatqesinë e gjinisë, e cila orvatet si një epitaf ndëshkues në shoqërinë e atyre viteve, por jo vetëm. Ajo shpërfaqje si një maskaradë sociale, është vikamë e një ndërgjegjeje të munguar të botës së pushtuar nga konservatorizmi i mykur dhe injorimi i ligjit. Në të vërtetë, Bardha nuk mund të bëhet kurrsesi heroinë, sepse të gjitha rrethanat rrahin kundër saj. Së pari dhe mbi të gjitha, është ngrehina e rrënjësor e një mentaliteti që dikton fuqishëm jo vetëm në mjedisin malësor, jo vetëm në Shkodër, por pothuaj në gjithë Shqipërinë e Veriut të messhekullit XIX. Dhe, kjo anë mentale, me ligjin që shtrihen në thellësitë e shekujve të mëparshëm, është e përbërë nga individë të brumosur deri në deje me nomet e shkruara dhe të pashkruara kanunore, me ligjin e maleve, që dominon në jetën dhe çdo nivel të raporteve njerëzore, mbi çdo grimcë të ndjesisë njerëzore. Bardha ishte e rrethuar nga të gjitha anët me individë të tillë: rrethi i gjerë i një shoqërie asillogjive e ngushtohet, duke iu bërë lak jetës, dëshirave dhe ndjenjave të Bardhës për të dalë përtej, ngushtohet mbytyshëm me njerëzit më të afërt të saj. Ja: nëna dhe vëllai nga njëra anë dhe vjehrra e Luli nga ana tjetër. Por autori, për ta shpëtuar nga monotonia trishtuese dhe hermetike Bardhën, e intrigon subjektin, duke shfaqur Aradin e Vlashajve, personazhin që shndër-



rohet në shpëtimtarin dhe "vrasësin" e Bardhës. Dramaciteti rritet, ngjarjet marrin përmasa të tjera. Njohja me Aradin do t'i japë tjetër rrjedhë jetës së Bardhës. Ajo tashmë nis ta shohë botën ndryshe, e ndien aromën e luleve dhe kap nuancat dhe ngjyrat më të holla të stinës, të cilat prej kohës mendonte se i kishte humbur. Brenda saj nisin të zgjohen ndjesi të panjohura, regëtimat që e gufmojnë, ka një dhimbje të ëmbël shpirtërore, por edhe forca dhe dëshirë për të jetuar. Bardha, kjo fatzeze e kohëve të trishta, që duket se është pjellë e tragjikes së jetës katrahurë, terrenit të vrazhdë e tejet mashkullor, ka krijuar brenda vetes shtëpizën e ëndrrave, e ëndrrave të paprekshme, që s'do të mund të realizoheshin kurrë.

Dashuria e Bardhës me Aradin e Vlashajve është vetëm një shkrepizë e destinuar të shuhet humbëtitërisë së gjithë atij mjedisi zakonor. Bardha dhe zezona ku merr frymë përditë, janë antipod i plotë dhe, detyrimisht, në një luftë të papajteshme e të vazhdueshme mes njëra-tjetrës, doemos do të ketë një fitues dhe një humbës. Bardha është ndryshe, ajo është njolla e masës, një njollë me të njëjtin ngjyrë si emri i saj, në të cilën pulsohet çdo ditë ëndrra, lëshohen vrunduj dëshirash, e pikëza lumturie gëlthasin brenda saj, sikur duan t'i kundërvihen botës. Ishte pikërisht ajo botë në të cilën Bardha ishte ndier vetëm, deri në momentin kur shfaqet ajo dritëz (Aradi), një dritëz që tejshtyhet e ajo kaplohet duke rëndur pas saj si në ëndërr.

Vëmë re: "Ajo e dinte se i kishte armiqtë e

gjithë ata që e rrethonin; burrat e përbuznin si qenie të dobët, të paafët për veprim; gratë i kishin zili pozitën, bukurinë dhe veshjen elegante. Sa më shumë që ngrihej mbi të tjerët me hirin, mirësjelljen, fisnikërinë e ndjenjave, aq më shumë rritej urrejtja e këtyre qenieve, që varfëria dhe skamja ua kishin ashpërsuar shpirtin e ua kishin bërë zemrën gur. Prandaj Bardha nuk haste në Temal asnjë fytyrë mike, asnjë zemër të mëshirshme e të dhembshur; burrat nuk kishin buzëqeshje për të, gratë i hidhnin vetëm vështrime të këqija e plot smirë. E vjehrra sillej me të vrazhdë e egër, gratë e saj s'e shihnin dot me sy. Pra, ajo nuk mund të mbështetej në dashurinë e në besnikërinë e asnjëri. Fill e vetme, e veçuar, pa asnjë nga të sajët, ajo e shihte veten në gjendjen e një të burgosure, jeta e së cilës varej nga trillet e një njeriu të egër që, kur e mori për grua, i kishte dhënë vetes të drejtën dhe pushtetin ta hidhte në një skllavëri të neveritshme e ta mundonte pa mëshirë e pa dhimbshuri".

E, pra, Bardha është ndryshe. Ajo nuk është si të tjerat. Së këndejmi, figura e saj lartohet si gruaja që metaforën e dhimbjes e shkrin si gjendje emocionale, duke e përkthyer atë në lëndore. Sepse kështu duhej, autori e paraqet dhimbshëm fatin e saj, duke paralajmëruar kobin, nëpërmjet përshkrimeve vibruese e tablove rrëqethëse. Tematika e romanit "Bardha e Temalit", por edhe e disa prurjeve të mëvonshme, që, megjithëse u shkruan shumë më vonë se ky roman, sollën sërish një jetë të subjektivizuar dhe të rëndë që, përveçse varfërore, mbarthe me vete një realitet të dhimbshëm për trajtimin e

femrës, e cila shihej si objekt më shumë konvencional. Një botë pa krye, e "ndershme" sipas stilit paradoksal shoqëror, që përditë ngjiz individë e personazhe me lumturi iluzive, të shtiruara, me dashuri të fjetura, me makthe të trishtueshme, me energji negative. Por autori, për ta përmbushuar e plotësuar tablonë drithëruese, sjell një tjetër dëshmi të kohës, përkundër duellit burrëror, të hershëm, ballas, pa besëprerje dhe në mejdan. Përmasat e epizmit homerik të gostive, kthehen në antipod me vrasjet dhe pabesitë që derivonin sipas ndasive kryesisht fetare. Në këtë roman, Bardha dhe e vjehrra e saj qëndrojnë si dy viktima sublime në anët e urës së një bote të transfiguruar me ambivalenca klithjesh pa zgjidhje.

Pashko Vasa e inkuadron qartë këtë figurë, e cila nuk përmbush thjesht qëllimet e artit; ajo godet mbi atë vargan shkeljesh të të drejtave të njeriut që kondeson tragjikën. Ai u jep të dyja grave forma dominante, jo si raste të fragmentarizuara, por si një e keqe e përgjithshme që po mbyste përditë këtë qenie, vetëm e vetëm për faktin se kishte lindur grua. Njëra grua ekzekuton tjetrën...

Vjehrra (Djemnusha) bën kryqin përpara vrasjes së Bardhës, a thua po kryen ritualin e zakonshëm, duke iu lutur Shën Mërisë! Aq e varfër në mendime e shkreta grua, sa beson se Zoti ia miratonte këtë vendim të çmendur! Dhe gjithçka shuhet pas kësaj lutjeje... Kapaxha bëhet honi ku duhet të tejhumbë gjithë konservatorizmi i mjedisit, dhe është, në fund të fundit, simbol i asaj shoqërie vorbulluese dhe zbjerëse e të gjitha vlerave pozitive. Ndryshimi i diskursit është gati i paimagjinueshëm, pasi nuk kemi asnjë detaj kompozicional që të na ngasë drejt dyshimit se do të ndodhë një kthesë e tillë, përkundrazi... Sa vlen pendesa e vëllait të saj, sa vlen dhembja dhe pendesa e nënës, kur e rikthen sërish në Malësinë e largët, duke mos pasur mundësi për të korrigjuar gabimin e dikurshëm të saj e duke i dhënë goditjen fatale dhe përfundimtare jetës së bijës së vet. Sepse, nëna e kthen atje, ku Bardha kishte "nderin", pranë burrit të saj, Lulit të Temalit, çka do t'ia kufizonte pak nga pak orët e jetës.

Ç'bën të tjerët, njerëzit e afërt dhe që e deshën Bardhën? Anuli ondulon mes ndjenjës së fajësisë dhe presimit të fortë të "ligjeve" frenuese, deri në ndëshkim. Pavarësisht dhimbjes që ndien si për Bardhën, ashtu dhe Aradin, ai, Anuli, vuan mungesën e forcës vepruese (është rasti të kujtojmë që Aradi dhe Anuli vranë pinjollin e Topiajve, sepse ai pati puthur në faqe motrën e Aradit). Vëllai i Bardhës, nëna e Bardhës, Anuli, Aradi, nuk bënë dot asgjë për t'i dhënë tjetër drejtim jetës së Bardhës. Janë njerëzit që e deshën Bardhën, por që nuk mundën ta shpëtonin dot nga një fund i paralajmëruar, nga thonjtë e lerneritshëm të patriarkalizmit ekstrem, të ngulitur thellë në mendësinë dhe në çdo frymëmarrje të botës së malësisë ku jetonte Bardha, në Temal, te vjehrra dhe bajraktari i saj, Lul. Gjithë ata njerëz që e deshën, aq të pafuqishëm dhe të zhvleftësuar përballë pushtetit që ka Luli dhe nëna e tij, sepse Bardha, që në momentin kur ka hyrë në atë shtëpi, ishte e Zotit dhe e tyre (Lulit dhe nënës së tij), dhe ata kishin të gjitha të drejtat mbi të. Kjo ishte forca e ligjit! I vetmi që ngrihet mbi këtë qerthull të kalbur dhe që i del në mbrojtje Bardhës është vetë autori, Pashko Vasa. Ai i jep tjetër kuptim vdekjes së saj, duke u ngritur mbi të gjitha kodet false të nderit e të moralit. Romantizmi i theksuar i P. Vasës e shton edhe më tepër tragjicitetin e vdekjes së Bardhës. Ndërhyrjet që ai bën në çaste të caktuara në roman, përbëjnë një manifest të moderuar për kohën të një kodi moral real, duke hedhur themele të forta të qëndrimit që shoqëria duhet të mbante ndaj gruas...


Të huajt për ne

GJURMËVE TË LIBRIT TË PARË NË GJUHËN SHQIPE

Për gjuhën shqipe linguisti Matzinger thotë se deri më vitin 1555, brenda një hapësire shumë të gjatë kohore, ishte vetëm një gjuhë e bartur gojore

Enver VISOKA*

Këto ditë linguisti Joachim Matzinger publikoi shkrimin "Gjurmëve të librit të parë në gjuhën shqipe", gjurmë këto që ishin shumë të rëndësishme, siç do të thotë ai, për kujtesën shqiptare. Linguisti Joachim Matzinger shkruan në vazhdim se në arkivin e Bibliotekës së Vatikanit gjendet një libër i shtypur i shekullin 16 me një alfabet të përzier latino-cirilik. Duke folur për librin shqip, historiani i lingvistikës në hollësi përshkruan rrethanat dhe zinxhirët e shtypjes së librit dhe kristalizimit të shtypshkronjave në qendrat europiane me alfabet latin, si dhe për zinxhirët e shtypjes së librit me alfabetet tjera jo-europiane në këto qendra. Në qendër të kësaj arritjeje, ai e sheh zbulimin teknik të kohës së hershme të re të shtypjes së librit dhe mundësitë po ashtu të reja të shtypjes, rishtypjes dhe të zgjerimit të librit. Në këtë kontekst Venediku zë një vend qendror të shtypit të librit, dhe madje në këtë pikë të nxehtë të qendrës së kohës, ai njofton lexuesin gjermanë për eksodin shqiptarë pas pushtimit të plotë osman më 1500, prezencën dhe zgjerimin e tyre në Itali, duke banuar qytetin dhe tokën e ngjeshur të Venedikut, pra terra ferma (Terra ferma, i-tal.-tokë e ngjeshur) e arritur deri në Firual. Me një fjalë, ai thotë se Serenissima (lat. titulli i qytetit për Venedikun) ka qenë në shek. 15 dhe 16 një qendër për hapësirën shqiptare. Për gjuhën shqipe linguisti Matzinger thotë se deri më vitin 1555, brenda një hapësire shumë të gjatë kohore, ishte vetëm një gjuhë e bartur gojore. Nga ky vit me sukses fillon viti i shkrimit shqip, dhe po kështu nga ky vit fillon historia e bartjes monumentale e shkrimeve në gjuhën shqipe. Ndërkaq për autorin e librit të parë në gjuhën shqipe, ai thotë se është shumë pak i njohur përveç që asaj të paktës që ai shkruan në kolofonin e bartur në fund të librit për të dhënat e



autorit të shkruar nga vetë autori. "Nga këtu ne e mësojmë", vazhdon Matzinger, "emrin e tij, Gjon Buzuku, emrin e të atit, Bdek dhe që ai do ta ketë udhëhequr një kishë si klerik që ishte. Ka të dhëna që për hartimin e tekstit autorit do t'iu kenë dashur tre të tretat e vitit, dhe këtë që nga 20 marsi 1554 deri më 5 janar 1555 dhe të gjitha këto deri tash janë të pahlumtuara, si printi dhe fjalë që aq shumë mund dhe kohë do t'ketë kushtuar. Mirëpo çfarë është ky libër, i cili në mes të shekullit 16 qendërzohet në fillim të shkrimeve shqip? Origjinalin e librit nuk e njohim. Këtyri libri pjesërisht si dhe 16 faqet e fillimit të tij i shungojnë. Pjesën më të madhe të librit e zë përkthimi i meshës së kishës katoliko-romanike, kështu që ky libër që nga zbulimi i tij, mbi të gjitha do të njihet si meshar. Por, kjo nuk do ta prekë gjithë pikën. Edhe pse ky libër në pjesën kryesore paraqet një përkthim, megjithëkëtë

Buzuku në veprën e vet do të bartë edhe tekste tjera të shenjta katekistike-biblike" Në vazhdim linguisti Matzinger thotë se vepra e Buzukut është një libër praktik i liturgjisë kishtare të udhëhequr nga kleri. Ndërkaq në kapitullin "Alfabeti i përzier latino- ciril" përmend se në fillim të librit nuk është vetëm e panjohur se si autori e ka quajtur veprën e vet, por është e panjohur po ashtu edhe e dhëna e vendit të shtypjes së librit. "Që nga zbulimi i kësaj vepre, për këtë çështje do të ketë supozime të ndryshme nga e gjithë Adria, duke i përjashtuar ato pjesë që ishin nën sundimin osman, në të cilat vetëm në shek. 18 libri i shtypur u lejua. Në bazë të indiceve të caktuara komulative të përdorimit të detajeve të llojit të shkronjave të shtypura, iniciave dhe elementeve dekorative na lë ta kuptojmë se Venediku duhet të jetë vendi i mundshëm i shtypjes së këtij libri. Një indicie me peshë të veçantë

gjendet në fund të kolofonit për meshë të patriarkëve që gjendet në kishën venedikase, Cannaregio, të vendit kryesor të ekzilantëve shqiptarë, e cila në veçanti në Venedik ka qenë e nderuar. Në bazë të asaj që ai shkruan në fund të kolofonit, kjo do duhej të jetë aty në fund, aty afër, ku Buzuku dikur do të ketë hyrë. Njëra nga të veçantat e librit të Buzukut është alfabeti i përdorur, pra tipi i shkronjave latin, i përdorur atëherë në Italinë e Veriut, i quajtur rotunda gotike si dhe pesë shkronjat cirilike, të cilat kanë qenë specifike në alfabetin e përdorur në atë kohë në veprat me prejardhje boshnjake". Matzinger duke përdorur metodën komparative e le mundësinë e hapur që vetë Buzuku të ketë qenë krijuesi i këtij alfabeti të përzier latino- ciril, i cili, sipas tij, nuk do të ketë qenë i njohur para shekullit të 14 apo ndoshta e terë kjo do të ketë qenë edhe më e vjetër, që më vonë nuk do të ketë pasur mundësi të preket me dorë. Ndër të tjera Matzinger në hollësi vë në fokus shtrirjen e literaturës teologjike në hapësirën veriore deri në shekullin 19. Dialektin gegë e paraqet të atdhesuar në shkallë të gegnishtes së vjetër, e cila po ashtu gjendet e reflektuar në veprën e Buzukut. Ai thotë se karakteristikat gjuhësore të veprës së Buzukut përcaktojnë Shkodrën si vend të idiomës. "Gjuha e veprës është mjeshtërore dhe ka përmbajtje besimore", shton ai, "dhe para se gjithash kjo të lë të kuptosh se Buzuku ishte gjithçka më shumë se sa një klerik reformator"! Shkencëtari i historisë së lingvistikës ballkanike, Joachim Matzinger, në qasjen e tij i kushton po kështu rëndësi të veçantë rrënjëve të trashëgimisë kulturore të arbëreshëve deri në ditët e sotme.

Foto: Joachim Matzinger

*/Autori bëri interpretimin, përkthim dhe përshtatjen nga gjuha gjermane /

Të huajt për ne

DROMCA KUJTIMESH PËR MARTIN CAMAJN

Martin Camaj ishte bashkëbisedues për mrekulli. Në radhë të parë, ai dinte ende artin pothuej të shuem me ia vù veshin tjetrit

Hans-Joachim LANKSCH

Çdokush që merret me figurën e shkrimtarit Martin Camaj has në surpriza të cilat janë, në të shumtën e herave, e kundërta e asaj që pritej dhe »dihej« për të. Personi i Martin Camajt ishte i qetë, paksa timid, i padukë e modest, me plot dinjitet dhe krenari të natyrshme, shpesh ishte ndërduzash, e kërkonte vetminë. Nga ana tjetër, i njëjti Martin Camaj, djalë bariu nga katundi mbishkodran Temal, e çau rrugën e vet me energji dhe vullnet të rrallë. I ndiqte dhe i diplomonte studimet universitare dy herë, luftonte me kambëngulje derisa ia arriti qëllimit me themelue dhe instalue në Munih profesurën e albanologjisë në kohë kur studime albanologjike universitare përveç në Shqipëri moniste kishte vetëm në Itali, Leningrad dhe SHBA, në kohë kur në Gjermani nuk kishte interesim për kopshtin shkambor të Europës, të panjohun e të bllokuem në aventura

ekzotiko-groteske të një diktature të luejtun mendsh. Me gjithë dëshirën e tij për qetësi, Martin Camaj nuk mund të rrinte i ngujuem në izolim, i nevojiteshin kontakte të shumta me njerëz – me shokë, kolegë, bashkatdhetarë. Nji pjesë të mirë të kohës së tij i kushtonte letërshtëmbimit të gjanë dhe kohës së telefonave. Ai ishte, në të vërtetë, Njeriu më vete dhe me tjerë siç e thotë titulli i përmbledhjes së tij qendrore poetike. Dihet se në Shqipëri e pjesës së dytë të shekullit XX kishte njerëz që hidhnin poshtë çdo mendim kritik për veprën e vet tue potencue se kënan autorë »me famë botërore«. Ja, cili ishte qëndrimi i Martin Camajt. Autori i këtyne rreshtave, si student, kishte fatin e bardhë me mësues shqipen nga Martin Camaj. Nji ditë prej ditësh, gjatë pushimit dhetë minutash mes dy kursesh, tue u shëtitë në korridor para auditorit dhe tue bisedue për çkamos, profesori e pyeti studentin – me çka merreni në kohën e

ngesë? Kur ky tha se me përkthimin e poezisë, Martin Camaj tha – punë interesante. Mbas nji pauze shtoi, me zà të ulët – unë shkruaj. Mbas nji pauze tjetër, studentit të shastisun i tha – jam shkrimtar shqiptar. Martin Camaj ishte bashkëbisedues për mrekulli. Në radhë të parë, ai dinte ende artin pothuej të shuem me ia vù veshin tjetrit. Nuk mbahej si profesor, por si mik. Për hallet personale të studentëve e bashkëpunëtorëve shpesh kërkohet këshilla e tij. Në çdo situatë ai e gjente fjalën e qëllueme ngushëlluese, inkurajuese e paralajmëruese. Si në poezi – ku në fazën e pjekunisë së tij krijuese e peshonte çdo fjalë e çdo rrokje – ashtu dhe në bisedë a diskutim Martin Camaj ishte fjalëmatun. Para se me u përgjigjë, shpesh binte në heshtje, mendohej për nji copë të mirë here, pleqnohej me vete dhe, mán në fund, jepte përgjigje kryekëput të papritun, jokonvencionale, origjinale. Ashtu si poeti Martin Camaj nuk merrej

me të shkruemit të cekët, në bisedë personale kurrë nuk mori ndonji qëndrim të pamedituëm, të pamenduëm a të përciptë. Ai ishte nji genie rebeluese që i çmonte traditat, vërtet, dhe nuk i duronte konvencionet. Në poezi, mbas librit të parë bukoliko-konvencional, "Nji fyell ndër male", Camaj filloi me u çue në kambë kundër kallëpit të poezisë së traditave të vyshkuna dhe arriti shpejt të vargu i lirë të cilin e përpunonte, zhvillonte, kultivonte, lëmonte deri në shkallën e përsosmënisë. Në jetë private, thoshte shpesh se i urrente thellësisht konvencionet dhe mendjengushtësinë e »filistinjeve«. Ai vuentë nga horizonti mendjendryshkun i njerëzve mikroborgjezë. I përshtatej mjedisit tek gjindja llafoseshin me orë të tana për gjana, të cilat ai i sqaronte me nji fjalë të vetme; i përshtatej asi mjedisi, por me zor dhe me mall për gjanësinë madhështore nën kupën e qiellit së pafund mbi bjeshkët mbishkodrane.

ROMANTIZMI NË KUFIJTË E TË PËRLIGJSHMES

Mënyra e rrëfimit lirik të përrallës, poetika e saj, i dhanë shkas autorit të dallohej në këtë plejadë shkrimtarësh, në të cilën hyri dhe u radhit. Gjyli krijoi pa vonesë individualitetin e tij krijues, që do ta thellonte nga njëri vëllim me përralla në tjetrin


Khahid BUSHATI

Krijimtaria për fëmijë e shkrimtarit Teufik Gjyli ka si zanafillë dhe shtysë të mëtejshme që nuk iu shkëput, realitetin e të parëve të tij, që lindën në Ulqin. Ai zë i hershëm, i përhershëm dhe i paplakur, thirrës brenda vetes dhe gjallërues në vetëdijen e tij, është pjesë e biografisë jetësore dhe artistike të shkrimtarit, ku "... menjëherë emri lidhet me vepra letrare, madje me forma të veçanta, duke pretenduar një njësimit të autorit me veprën." Është kjo arsyeja, që në kujtimet e tij të çmueshme dhe të patjetërsueshme që lidhen me rrënjët prindërore, në mes të tjerave thotë: "... unë provova për të shkruar bukuritë e një qyteti të vogël bregdetar të Kolkasve të vjetër, meqë nga ai qytet ishin prindërit e mi, edhe nëna, edhe baba. Edhe unë vetë, vegjëlinë për disa vite, e kisha kaluar në kalanë e atij qyteti e, gjithkund, bregut që prej gjeranave e deri në Lima. Kuptohet se ky qytet është Ulqini".

Kjo bukuri mahnitëse bregdetare me hiret e misteret e saj, të cilat fshehën së thelli në kohë edhe elementë mitologjikë, gojëdhënarë, fantastikë, legjendarë, mrekuilltarë, etj., elemente që në procesin krijues të shkrimtarit Teufik Gjylit gjetën pasqyrim më të gjerë e të dukshëm në gjininë e përrallës. E lëvroi me sukses, i dha asaj tipare të mëvetësishtme, veçanti e origjinalitetit. I përfaqësuar kryesisht me këtë gjini, ku dhe ka arritjet më të mira, (më vonë dhe me tregimin) dha një kontribut të rëndësishëm në krijimin, formimin dhe pasurimin e mozaikut të traditës së re të letërsisë për fëmijë e të rinj, traditë që "... u krijua... me përpjekjet dhe pasionin e nisatorëve të parë të kësaj krijimtari, ... Q. Guranjakut, Z. Sakos, H. Stërmillit, T. Gjyli, S. Çomorës, D. Siliqit e të tjerëve."

Mënyra e rrëfimit lirik të përrallës, poetika e saj, i dhanë shkas autorit të dallohej në këtë plejadë shkrimtarësh, në të cilën hyri dhe u radhit. Krijoi pa vonesë individualitetin e tij krijues, që do ta thellonte nga njëri vëllim me përralla në tjetrin. Përmendëm këtë gjini jo vetëm se ishte më e spikatura e autorit, porse ai pa se: "Tek përralla, ... del veçanësisht e letërsisë për fëmijë me mundësitë e saj të shumta, ... "Këto mundësi Teufik Gjyli i shfrytëzoi dhe realizoi në subjektet interesante e magjiplote të përrallave që krijoi. E jetoj përrallën dhe e bëri të jetojë përrallën përmes rrëfimit të tij.

Krijimtaria për fëmijë e shkrimtarit Teufik Gjyli ka edhe një zanafillë tjetër, një tjetër realitet, dhe ky i përket Shkodrës. Në këtë qytet me emër edhe në fushën e letërsisë për fëmijë, autori jetoj, punoi, shkroi e ëndërroi..., deri sa një ditë u nda nga kjo jetë. Këto dy realitete, nga mënyra se si janë krijuar e pasqyruar, nuk janë ishuj në vete, të ndarë me kufij e në largësi. Ata kanë një shkrirje harmonike, marrin e japin me njëri-tjetrin në kohë dhe hapësirë, përmes tekstit, nëntekstit dhe intertekstualitetit të tij. Në këtë marrëdhënie "lëvizin" e fokusohen problematika të caktuara, që lindën në një realitet dhe vazhdojnë "jetën" në realitetin tjetër. Sido që të jetë realiteti, nga vjen dhe ku shkon, magjia buron sa nga Vendlindja



e të parëve aq edhe nga Vendlindja e autorit. Kjo magji që kthehet në "realitet" përrallor merr "jetë", shfaqet e lulëzon: te subjekti, fabula, përshkrimi i natyrës, te cilësitë dhe veçoritë e personazheve, mjediset dhe ngjyrat që ecurinë e misionit, aventurës, peripeive, situatave të jashtëzakonshme, përpjekjeve dhe fatit të tyre, etj., etj. Të gjitha këta elementë lëvizin nëpër hapësira të njohura e të panjohura, të dashura, të shtrenjta, romantike, të përmalluara, përmes mallit dhe kujtimeve të shtrenjta, si gjithnjë, për autorin. Janë pjesë të vetvetes, vetvetja si identitet e mënyrë rrëfimi, të vetëdijes njerëzore e artistike, ku s'pushojnë së lëvizuri subjektet si dëshmitarë të patjetërsueshëm artistikë. Te këto subjekte përrallore gjenden: "Forcimi i elementëve lirikë si dhe poetizimi i ngjarjeve dhe i figurave të personazheve (që) është një nga veçoritë e krijimtarisë letrare të këtij shkrimtari." Ndaj, dhe "Trëndafilin e artë" të përrallave të shkrimtarit Teufik Gjyli, duhet ta kërkojmë dhe doemos e gjejmë, së pari, në marrëdhëniet e tij me Vendlindjen e të parëve, që ishte një trevë e pasur me histori të moçme, mite, gojëdhëna, përralla, rrëfenja e legjenda. Ky thesar e ushqeu shkrimtarin me fabula e subjekte të shumta, me larinë e formave të gatshme e të përpunuara të përrallave popullore të krijuara gjatë

shekujve, etj. Në këtë rrugëtim të gjatë autori njohu edhe përvoja dhe ndikime letrare, të cilat i pasuroi, i zgjeroi si nga pikëpamja tematike ashtu edhe estetike. Dhe ky rrugëtim shtrihet për dyzet e pesë vjet me radhë veprimtari letrare, e shpërndarë ndër tridhjetë organe të ndryshme, në vitet 1923-1968.

"Kacimicri" qe novela e parë, e gjatë për fëmijë, që u botua në vendin tonë. Ajo e popullarizoi emrin e Teufik Gjylit. Libri i dytë është "Trëndafilin e artë". U botua më 1957. Përmban 18 përralla, legjenda dhe tregime për të vegjël. Disa nga pjesët e përfshira në vëllim janë nga krijimet më të para të Teufik Gjylit, botuar më parë edhe në shtypin periodik. Në vitin 1966, Teufik Gjyli botoi vëllimin "Tregime të zgjedhura" për moshën e mesme shkollore. Në këtë libër gjenden disa copa të zgjedhura nga proza e tij tregimtare. Ato nuk janë renditur sipas viteve të botimit, por sipas llojit letrar, duke filluar me përrallën dhe duke mbaruar me tregimet rreth jetës së sotme të vendit. Kështu, nga "Dhelpra e argjantë" (1961) është ribotuar "Përrallë", përpunim sipas tregimit që i bën populli i krahinave të Veriut. Nga "Jani dhe Piku" (1962-1965) janë zgjedhur disa ngjarje fantastike. Nga "Trëndafilin e artë" (1957) është riprodhuar përralla e bukur "Sheboja". Nga "Kacimicri" (1954) është dhënë kapitulli XI, ai i parafundit, me titull: "Fshatari plak çlirohet nga vargojt". Në

vëllim janë përfshirë gjithashtu pjesë nga libri me tregime "Piciruku" dhe pjesa teatrale "Pranë kufirit". Kohët e fundit kemi rënë në gjurmë të melodramës: "I verbti e Jetimja".

Teufik Gjyli u mbështet dhe "përvetësoi" imazhin e përrallës popullore, duke i dhënë asaj një konfiguracion të dallueshëm dhe origjinal. Do të thoshim i një lloj idealizmi të pranuar me vetveten dhe i një romantizmi në kufijtë e të përligjshmes. Kështu, autori duke qenë njohës i hollë i kësaj pasurie lëndore, autoktone, jetese e mbijetese e njohjeje të Vendlindjes së prindërve (prej nga vinin rrënjët), ka ditur ta shfrytëzojë atë dhe ta mbartë në krijimet e veta me shumë finesë, ngrohtësi e drithërimi-meditative poetike.

Teufik Gjyli, si krijues, lëvroi disa gjini e zhanre letrare, si: fabulën në vargje, apologun, tregimin e shkurtër, kallëzimin apo rrëfenjën, novelën e gjatë, skeçin, dramën, melodramën, skicën, vizatimin letrar, reportazhin, artikullin; por talenti i tij u shqua, shkëlqeu dhe shëtiti në universin e përrallës, ku dhe mbeti përrallëtar. Te kjo gjini shfaqen e përftohen dukuri e cilësi të personalitetit të tij krijues, të cilat na ofrojnë mendimin se Teufik Gjyli e nje mirë botën e përrallave dhe në veçanti përrallën popullore, hapësirën, domethënien, ngjyrat, karakteristikat, idetë universale dhe kodet e saj. Është i drejtë pohimi për këtë shkrimtar, kur thuhet se: "Teufik Gjyli është bërë i njohur, përveç të tjerave, si autori i dy prej personazheve më të njohur, më popullore e më të realizuar në krijimtarinë e tij, por edhe në letërsinë tonë për fëmijë, siç janë Kacimicri dhe Piciruku, dy figura tërheqëse dhe mjaft simpatike për lexuesit e vegjël, i pari trajtuar te përrallat dhe i dyti tek tregimet e tij."

Të mos harrojmë se, shkrimtari Teufik Gjyli na dha një model përralle. Ndikimi i përrallës popullore shfaqet në to, në dy drejtime: a) "ndihet në mënyrën e trajtimit të fabulës dhe subjektit, (si dhe) në rrjedhën kompozicionale, ..., veçanërisht në tipin e figuracionit dhe detajet poetike, në qartësinë dhe forcën komunikuese të mjeteve shprehëse." dhe b) në "një brendi realiste, (në) një shpirt të dukshëm popullor...". E gjitha kjo i përgjigjet një momenti të rëndësishëm të letërsisë sonë për fëmijë dhe të rinj, letërsi edhe pse kanë kaluar dy dekada të një realiteti të ri historik demokratik, nga librat që botohen, gjenden ende me shumicë krijime që nuk i kanë shkëputur lidhjet me letërsinë e soc-realizmit, të cilat përkojnë si në: konceptim, në atmosferë, në zgjidhje të konfliktit, etj. Duke parë këtë gjendje që realisht nuk është dhe aq entuziaste, studiuesi dhe kritiku i njohur Ramadan Musliu shpreh me të drejtë: "Fryma e krizës së letërsisë së realizmit socialist, sikundër edhe modelit letrar të mbështetur mbi figurën, është më i fuqishëm se ndikimi i këtij perceptimi ekzistent në këtë kohë, por jo aktiv. Që të krijohet prioriteti i ekspresionit të ri estetik duhet që edhe lexuesi të lirohet nga bagazhi ideologjik i veprës letrare, që të krijojë vetëdijen mbi vlerën e traditës dhe që përmes përvojave të reja të arrijë të komunikojë me ide dhe koncepte të reja që mund të ofrojë letërsia e periudhës së fundit".

SHKOLLAT E PARA SHQIPE ME FRYMËZIM HUMANIST EUROPIAN

Një kapitull më vetë përbën shkolla e parë shqipe në Kosovë, aq më tepër se ajo është e shekullit XVI, afro gjysmë shekulli para shkollës së Kurbinit e Velës.



Gersa RRUDHA

Kisha katolike, në ravën e mundimshme të krijimit të vlerave themelore në rrafshin e kulturës, s'i rreshti përgjatë mesjetës përpjekjet shqiptare në lëmin e gjuhës e dijes, ku rrëzëllin si një diamant "Formula e Pagëzimit" (1462), me të cilën është dëshmuar qëndresa e kulturës shqiptare, identiteti dhe entiteti i saj. Gjurmët e shkrimit dhe arsimit shqip hasen qysh në fillimet e mijëvjeçarit të dytë. Duke ecur ravës gjuhësore e arsimore të mesjetës së hershme, studiuesit sjellin një varg dëshmish, që "në vitin 1349 në Raguzë (Dubrovnik) kishte 24 shkruar noterialë nga Tivari, Ulqini, Pulti, Shkodra dhe fshatrat përreth, dy të tretat e të cilëve ishin shqiptarë, që përveçse në gjuhë të huaj shkruanin dhe në gjuhën amtare me shkronja latine; apo që prelati i Pultit (Shkodër) në vitin 1387 interesohet që të shkollonte të nipin në Raguzë, pasi kishte marrë mësimin e para në vendlindje" (137). Po ashtu, "janë zbuluar dokumente që flasin për shkolla pranë kuvendëve e katedraleve të qyteteve, si ato humaniste dhe provinciale të shkathtësive mendore dhe të filozofisë në Kotorr duke nisur nga viti 1266, të Durrësit (1278), të Shkodrës (1345) dhe Lezhës (1483)". (138) Vijmë pastaj në një etapë dhe më të rëndësishme, kur Ipeshkvi i Arbërisë, Imzot Gjon Kolesi, françeskan shqiptar, në vitin 1625 shpall para Selisë së Shenjtë nevojën e "ngritjes" së një a dy shkollave në malësitë e dioqezës së vet (ku vareshin dhe kishat e Krujës, Kurbinit, Matit, Lurës, Dibërës, përfshiheshin famullitë mirditore të Kthellës, Selitës e Rranzës) "me nga 10-12 çuna secila", ku nxënësit "të mësonin shkrim e këndim dhe themele të mira të besimit". Pastaj, të shkolloheshin më tej jashtë vendit, në Loreto (Itali), "sepse kështu do të nxirrej fryt i mrekullueshëm n'ato vende ku s'ka shkolla e as mësues". Dhe më e rëndësishmja: "mbasi të kenë nxënë për vete, do të bahen mësues për të tjerët" (139). Kërkesa të tilla të prelatëve të lartë shqiptarë të shekullit XVII, por dhe të një shekulli më parë, bënë që për nevoja të predikimit shqip dhe formimin e klerit katolik vendas të hapeshin disa shkolla shqipe. "Një rol të rëndësishëm për këtë qëllim luajtën priftërinjtë katolikë shqiptarë, të cilët gjatë shekullit XVII hapën shumë shkolla fillore e të mesme në gjuhën shqipe; hartuan tekste shkollore,

bënë përkthime të librave fetarë dhe hodhën themelet e letërsisë së shkruar shqipe". (140) Studiuesit kanë vërejtur se "përveç shkrimit e leximit, aty mësohej gramatika shqipe dhe përdorshin librat e Bardhit, Budit e Bogdanit." (141). Të dhënat për këto çerdhe të para të diturisë sigurojnë që nuk janë të mjafta, për shkak të vlimeve politike që kalonte vendi, rrënimin të arkivave e bibliotekave. Por dihet se në Shqipërinë e Veriut në Mesjetë kemi një gjerdan shkollash dioqezane, ku dy më kryesoret ishin e Kurbinit dhe e Velës. Ndoshta ndër ato të dyja asnjëra nuk ishte e para, por sipas një shprehje latine, secila ishte e parë ndër të para. Mundet të ketë qenë rastësi, por më shumë mund të ketë qenë marrëveshje mes ipeshkvnish që ato shkolla të hapeshin njëherësh, në një vit. Ato vijmë përgjatë shekullit të 17-të si dy krenat e një shqiptonje, sa në një kreshtë Kurbinit-Kruje, në një tjetër Mirditë-Lezhe. Duhet mbajtur parasysh se ato shkolla ishin në male të thella, të fshehura, pasi nuk mund të ishin lirish në qytete, që ishin nën sundimin osman. Malet ishin më të lira dhe për vetë rrojtjen e Ipeshkëve. Por më e rëndësishmja ishte se kishim të bënim me një lartësim shpirtëror, moral dhe kulturor në nismën për këto shkolla. Françeskanët u jepnin arsimit fillestar fëmijëve të shtresave të gjëra të popullsisë, aq më tepër që në urdhrin françeskan kishte dhe shumë shqiptarë. Në vitin 1585 ata mbijetonin në kuvendin e Sebastes-Laç, atë të Lezhës, të Rubikut dhe të Kepit të Rodonit, me një numër të përgjithshëm prej 40 rregulltarësh. Edhe shekullarët i kishin shtuar e përmirësuar shkollat, dhe për faktin se Koncili i Trentos (1545-1563) kishte vendosur që çdo dioqezë të kishte seminare për përgatitjen e priftërinjve. "Krijimi i këtyre seminareve u ndërmon për të garantuar një formim më të mirë fetar, kulturor e moral të klerit të ardhshëm, me qëllim që ta bënte atë të aftë në zhvillimin e veprimtarisë pastorale". (142)

"Shkollën e Velës e vlerëson veçanërisht në shkrimet e veta dhe profesor Jup Kastrioti, kurse akademik Jorgo Bullo, duke pasur parasysh kryesisht ndihmesën e saj, shkruan se Mirdita është vendi ku shqipja u mësua të paktën nga shekulli XVII dhe ku u ruajtën trajta arkaike me vlerë për historinë dhe zhvillimin etimologjik të shqipes". (143) Rëndësia e saj dëshmohet dhe nga një Urdhëresë e Kuvendit të

Arbërit (1703) që lëshohet posaçërisht për këtë shkollë dhe atë të Kurbinit, si dy shkollat kryesore të kohës. Kapitulli 5 i Koncilit Shqiptar mbi shkollën e Kurbinit dhe të Lezhës/Velës porositi që "nxënësit pas përvetësimit të shkrim - këndimit, duhet të mësojnë njohuritë e para gramatikore (nënkupto: shqipe) dhe ato të gjuhës latine." (144) At Donat Kurti në një studim të botuar në revistën "Hylli i Dritës" më 1935 përmend disa nga shkollat e para, por me gjurmimet e mëvonshme informacioni dokumentar rreth tyre është bërë më i plotë, sado që ende jo shterues e përfundimtar. Vargu i shkollave do të përfshinte: shkollën e Himarës (1628), Shkollën e Pllanës (me 50 nxënës, hapur me 1638 nga Pater Karli i Mirandolës), shkollën e Shkodrës (1638), shkollën e Blinishtit të Zadrime (hapur me 1639 nga Fra Kerubini, që më vonë do të ngrihej në nivelin e mesëm), shkollën e Oroshit (1657), shkollën e Janjevës në Kosovë (1671), shkollat e Durrësit, Pejës, Gjakovës, Prizrenit etj., shumë prej tyre të çelura nga françeskanët, përfshi dhe Kuvendin e Troshanit (1639), të Rubikut (1582) etj. Nuk kemi të bëjmë me një panoramë lokale, por me një arsim-përhapje strategjike, edhe pse kryesisht në arenën veriore, nga ata misionarë që u kishin mësuar nxënësve për herë të parë shkrimin në gjuhën shqipe, po dhe që kishin përkthyer vetë nga latinishtja në shqipe. Shkollat shtohen pas dekretimit të misionit të Fretërve të Vegjël të Reformuar në Shqipëri me 1634.

"Shkolla e parë shqipe" mund të kërkohet dhe në një tjetër gjeografi rajonale nga ajo e mësipërme, në Jug të vendit. Kronikat thonë se në vitet 1628 - 1661, shkolla shqipe me germa latine u hap në Dhërmi të Himarës dhe me vonë edhe në disa qendra të tjera të krahinës. Ato u ngritën nga misionarët bazilianë, shumica e të cilëve ishin arbëreshë të Italisë së Jugut, të vendosur atje në vitin 1482. Kjo shkollë ka të bëjë me ndihmesën e bazilianëve për shkollim andej dhe këndej Adriatikut. Një kapitull më vetë përbën shkolla e parë shqipe në Kosovë, aq më tepër se ajo është e shekullit XVI, afro gjysmë shekulli para shkollës së Kurbinit e Velës. Shkolla shqipe e Stubllës ka një traditë pesë-shekullore. Edhe atëherë kur persekutimi i arsimit shqip nga autoritetet osmane ishte i ngritur në sistem, në Stubëll, fshat i Malësisë së Karadakut, më 1584 fillon tradita e arsimit shqip, i pari dhe i vetmi rast atëherë në Kosovë, kur edhe kishte funksionuar shkolla e parë. (145) Kjo shkollë, siç shkruan edhe studiuesi i njohur Dhimitër S. Shuteriqi, "ishte në formë kolegji, i rangut të një instituti të lartë, çfarë ishin zakonisht kolegjet fetare të asaj kohe në Evropë, ku, përveç teologjisë, mësohej filozofia dhe studioheshin klasikët". (146) Duke marrë në analizë këtë traditë të vyer të katër shekujve më parë, shkencërisht dhe pa paragjykim, siç i ka hije një historiografie moderne, a nuk është me vend që "datëlindjen" e shkollës shqipe ta shtyjmë më përpara, në gjysmën e parë të shekullit XVII, te një shkollë në Velë, Kurbini a diku tjetër? A nuk përkon kjo jo vetëm me një të vërtetë historike të padiskutueshme, por përafrohet natyrshëm në kohë dhe me fillimet e letërsisë shqipe dhe të shqipes së shkruar? A nuk është një rithemelues e një tradite arsimore shqiptare paraardhëse, e një etape të dytë të arsimit rilindës në Shqipëri, si dhe vetë shkrimtarët e shquar të Rilindjes ishin pasardhës të shkrimtarëve të letërsisë së vjetër, misionarë të fesë dhe të qytetërimin.

e udhës që një famulli malesh shqiptare, të shpallet në mënyrë simbolike si "akademia" e parë shqiptare të dijes? Le të jetë kjo në Tivar, Durrës, Tiranë, Vlorë, Mirditë, Shkodër, Elbasan, Ulqin, Karadak a Prizren. Duke shqyrtuar veprat e Matrëngës, Budit, Bardhit, Bogdanit (35 vepra, krejt a pjesërisht shqipe, të dala prej Propagandës Fide të Romës nga shkrimtarë shqiptarë) studiuesit kanë nënvizuar se kështu "ishte hedhur baza kulturore dhe ideore e një rilindjeje arbënore, e cila vërtet do të vononte të vinte, porse kishte të ardhme të sigurt." (147)

Këto kohë ka pasur zëra të shkruar e të pashkruar, për ta riparë datimin e së parës shkollë shqipe në vendin tonë, që sot për sot zyrtarisht e kemi në fundin e shekullit XIX, me Mësonjëtorën e Korçës të vitit 1887, natyrisht një gjurmë e shndritshme e veprës së Rilindësve tanë. Po, a nuk janë rilindës dhe ata që i hapen ato shkolla dy shekuj e gjysmë para kësaj? A nuk na thotë i vyeri profesor Namik Resuli, studiuesi i njohur i letërsisë shqiptare, se "për klerikët shqiptarë Rilindja Kombëtare kish zënë fill, ndonëse fshehurazi, që nga dita kur Shqipëria u robërua përfundimisht nga turqit." (148) Ishte e kuptueshme që kisha katolike, i vetmi "institucion shqiptar i mbetur në këmbë", në rend të parë të asaj rilindjeje, quaje po deshe dhe arbënore, të kishte punët e diturisë, arsimit dhe edukimit. Ndaj, sipas logjikës më të thjeshtë, do të pyetej: si mundet ta pranosh gjuhën dhe letërsinë shqipe të asaj kohe për të parë, kurse shkollën e bërë po prej tyre të mos e marrësh si të parë? Pa u nisur thjeshtë nga aritmetika e shifrave, cili komb nuk do të ishte i lumtur po ta kishte shkollën e vet të parë të paktën 255 vjet më përpara asaj që e mban për të tillë, dmth jo në vitin 1887, por dy shekuj e gjysmë më parë, në vitin 1632! Kështu, "shkolla e parë shqipe", në thelb s'ka të bëjë dhe aq me emrin Korçë apo Shkodër, Kurbini apo Velë, Stubëll apo Dhërmi, por me një koncept historik, atë të një Rilindjes Shqiptare që fillon në shekullin XV dhe kulmon në shekullin XIX. Botimet dhe shkollat e para shqipe janë prirë e mbajtur gjallë nga ipeshkvinjtë shqiptarë: Një traditë që vinte nga shekulli XV, me humanistët shqiptarë në Rilindjen Europiane, gjer profesorë në Universitetin e Padovas. Por pavarësisht shkrimeve sporadike të karakterit historik të autorëve të ndryshëm, me sa dimë askush ndër studiuesit nuk është ngulur me themel në ndriçimin e kësaj maratone shqiptare për diturinë.

Shkollat e para fuqizohen me Kuvendin e Arbërit që mbahet në Mërq të Lezhës, në kishën e Shën Kollit, me 14-15 janar 1703, me bekimin e Papa Klementit XI, me origjinë shqiptare, përkundër asimilimit otoman. Deri në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, nga Durrësi në Shkodër e Kosovë, kishte 21 shkolla fillore me nga 30 nxënës e në Prishtinë deri në 80. Fakti që dokumentet e Kuvendit të Arbërit u botun si në latinisht si në shqip 300 vjet më parë dëshmon se ishin të shumtë ata njerëz që dinin të shkruanin e lexonin shqipen që e kishin mësuar në shkollat ku ata ishin shkolluar. Në këtë kontekst, Mësonjëtorja e Korçës nuk zbehet aspak, si një shkollë shqipe historike, kombëtare, martire, qytetare, laike, përkundrazi ajo del më fort në pah si rithemelues e një tradite arsimore shqiptare paraardhëse, e një etape të dytë të arsimit rilindës në Shqipëri, si dhe vetë shkrimtarët e shquar të Rilindjes ishin pasardhës të shkrimtarëve të letërsisë së vjetër, misionarë të fesë dhe të qytetërimin.

Poeti revolucionar që himnizoi dhe e shenjtëroi femrën

POEZIA DHE KABBANI, BINOMI I PANDASHËM NË NJË TANGO TË PËRJETSHME...

Sipas Nizar Kabbanit dashuria çlirohet nga pluhuri i tokës, nga ligjet dhe graviteti i saj, ndaj ai di t'i këndojë mjeshtërisht. Ai mbetet njeriu që di të dashurojë gjatë në heshtje si një kalorës fisnik

Alma ZENELLARI

Kur lexova për herë të parë, Nizar Kabbani, poetin sirian, jam ndërë e mrekulluar dhe e befusuar njëkohësisht. Mrekullia për atë rrjedhë të pandalshme vargjesh, shpalosnin para meje tablo të pafundme me ngjyra të forta të ndezura, peizazhe të paeksploruara më parë, portrete grash të pikturuara gati me frymë. Një koleksion i pafund vargjesh të stisura me një bukuri të jashtëzakonshme, që të mbajnë frymën pezull dhe mendjen të tendosur në pritje të një tjetër mrekullie. Për një kohë të shkurtër lexova ditë pas dite 100 krijimet e këtij poeti mbresëlënës. Letra të shkruara me një intensitet dhe stil tejet unik, gati të pazakontë. E megjithatë pasi i lexova krijimet e tij, kuptova se Nizar Kabbani dhe dashurisë së tij, nuk do t'i mjaftonin asnjëherë "100 letra dashurie".

Një dashuri që nuk e di nga ç'fuqi ushqej... Vargje të renditura me kujdesin e një qëndis-tari, që ndërthuren aq natyrshëm, me një shprehje lirike të një niveli të lartë, që tregojnë formimin dhe edukimin e poetit. Natyrshëm më lindën pyetjet e njëpasnjëshme se cili është ky poet? Nga vjen, nga ç'klime poetike është ndikuar formimi i tij? Si mund të gjendet një aftësi kaq e rrallë e të shkruarit? Bukuria e vargjeve, forca e muzikalitetit të tyre ngrihet shkallë shkallë dhe është kaq trullësuese, kaq e dëlirë dhe mahnitëse njëkohësisht kjo shpërfaqje e plotë ndjesish, emocioneve, trazimesh. Ku e gjen pra këtë mprehtësi dhe zhdërvjelltësi pena e Nizar Kabbanit? A thua erërat mansunike të Damaskut kanë përcjellë deri tek ne, këtë madhështi kompozicionesh, metaforash, këto thirrje të njëpasnjëshme eksklamative, të shpirtit të poetit?... Një poezi shpërthyes si aromat e palmave dhe luleve e madrave të Damaskut, si erërat e forta që trazojnë shpirtin e shkretëtirave të Sirisë. Një poezi që nuk të demoralizon përkundrazi të mbush me optimizëm edhe pse vjen nga një tokë, ku vështirë të mendohet dhe shkruhet kaq hapur, me një liri të pazakontë të të menduarit.

Ky është Kabbani, poeti i madh lirik, që lindi në muajin e pranverës më 21 mars të viti 1923, në Damask. A thua se ai thithi gjithë nektarin pranveror për t'u bërë ndoshta poeti më revolucionar, i shek. XX, që nuk do të rreshte asnjëherë së derdhuri dashuri, respekt dhe mirënjohje të thellë ndaj figurës më kuptimplote mbi tokë, gruas, femrës, që çdo gjë e bën të lulëzojë, të qesh, të ndryshojë botën duke i dhënë paqe asaj. Poeti vjen nga një botë, ku vështirë të përcillet kaq emancipim mendimi, vështirë të konceptohet se pikërisht nga ai vend si Siria, të lindin njerëz me "botë" aq të madhe, të lindet një shpirt kaq i lirë, unik, për t'i kënduar përsosmërisht me një lirizëm të thellë, të ndërë shenjtërisë së gruas. Krijimtaria në tërësi e poetit sirian, i cili pati fatin e një mirëshkollimi dhe një karrierë diplomatike shumë vjeçare, jo vetëm brenda atdheut të vet por edhe në Madrid, Stamboll, Londër etj, i ka dëshmuar dhe vazhdon t'i dëshmojë botës së rënduar nga traditat e egra, nga paragjykimet fataliste, se historia e femrës është qendra e Universit, se në duart e çdo gruaje edukohet dhe rritet i pari dhe i fundmi burrë. Se vetëm rreth saj mbledhen epokat, dhe vijnë rrotull mijëra e mijëra planetë. Kabbani është poeti shpirt kryengritës i shekullit XX, i dalë nga ajo botë, ku shtypja barbare ndaj gruas, dhuna deri në perversitet i femrës, mohimi brutal i ekzistencës së saj, ia kanë gjymtuar Atdheun. Ndaj larg Damaskut ai do t'i ngrinte himne figurës femërore, Jasminës, lules së Damaskut, palmës së bukur e hijerëndë nga duart e së cilës do të donte të pikturonte oborret e shtëpive, do të donte të bënte të lumtur fëmijët e pafajshëm, që ëndrrat e tyre të vallëzonin të lumtura si farat e murrizit të kuq.

Duke lexuar këtë poet gati të panjohur për një pjesë të madhe lexuesish, kupton sa e fisshme, sa origjinale është kjo krijimtari. Është si të gjendesh në një planet të paeksploru-

ruar i cili të josh, të fton për ta zbuluar ngadalë dhe me durim kohë pas kohe. E pas çdo zbuluese provon ndjesi të forta. Ndiheh i emocionuar, i surprizuar, i prekur gjer në palcë nga misteri i thellë dhe magjia drithëruese e njohjes së planetit GRUA. Është e pamundur të lexosh poetikën e Kabbanit dhe të mos e ndjesh këtë lloj peshe gati hipnotike. Është njësoj si të ndjesh freskinë e ujërave të Euftratit, si të zbulosh oaze të pafundme në mes të Golanit, si të dëgjosh klithmën e fuqishme të shqiponjës mbi malin e Hermonit. Ai është përfaqësimi më dinjitoz, shembulli model i mashkullit, i burrit që idealizon, hyjnizon portretin e femrës arabe. Ky është një përfaqësim i mentalitetit modern për gruan. Të elektrizon vargu me figuracione të ngjeshura, të ndezura, me shumë ngjyrim. Ai pi tek ky burim virtytesh, thith atë nektar dhe nuk ngopet nga hijeshia, bukuria, fisnikëria dhe mençuria femërore. Ndiheh si një fëmijë nga përkujdesi i saj, dhe si një burrë i mrekulluar nga drita e syve, nga freskia e duarve, nga shtati i gruas që dashuron. "Pesëdhjetë vjet, - thotë ai, - duke të dashuruar ty, pesëdhjetë vjet duke lavdëruar gratë..." (nga libri PESËDHJETË VJET DUKE LAVDËRUAR GRATË)

Lirizmi i thellë deri diku tronditës, etja për kulme të reja i shërbejnë poetit për të shpërfaqur e për të kuptuar fuqinë e unit të tij, pse jo edhe të përmbush profecinë e tij. Sipas Nizar Kabbanit dashuria çlirohet nga pluhuri i tokës, nga ligjet dhe graviteti i saj, ndaj ai di t'i këndojë mjeshtërisht. Ai mbetet njeriu që di të dashurojë gjatë në heshtje si një kalorës fisnik. Mbetet njeriu që respekton në heshtje, madje sakrifikon duke hequr dorë nga dashuria për hir të dashurisë. Por nga buron kjo ndjenjë, me këtë tingull e ngjyrim të pakrahshueshëm me dikë tjetër? A kanë emër të personalizuar dashuritë e mëdha të Nizar Kabbanit? A ka një emër të veçantë që i bën dritë herë si far, e herë i vjen pranë si një mbështjellë verbuese dhe e bën të sillet rreth saj si rreth një planeti? Padyshim, po!... Por, cili poet nuk pati në qendër të krijimtarisë së vet, një Helenë, një Beatris, një Euridicë e nëse

nuk e kanë pasur e kanë nxjerrë nga brinjët për ta pasur boshtin e krijimtarisë së vet. Ndaj edhe për Kabbani poetin sirian, emri i heroinave të tij do ta bënin të pavdekshëm me morinë e poemave, këngëve, variacioneve të pafundme nizariane. Ato e mësuan ndoshta të gdhendi dashurinë në lëvoren e drurëve, mbi stola, mbi tela, mbi frytet, nën çarçafët e borës etj., etj. (NJË POEZI PËR BALQIN)

Megjithatë është diçka më e madhe që e bën erotikën e tij, të jetë kaq përthithëse. Nuk është aspak sipërfaqësore, përkundrazi nëpër rreshta duhet lexuar edhe një dhimbje e madhe. Duhet zbuluar dhe kuptuar si rreh zemra e tij, si busull diellore në qiell, si rreh mendja e tij për Damaskun kur është larg damarëve jetësorë dhe shpirtit të tij. Ai nuk është një kryengritës i heshtur, por një luftëtar i palodhur, i cili ka vendosur të çjerrë me shkronja, lëkurën mbështjellëse të planetit në mbrojtje të të drejtave të grave. Poet i cili nuk e ndal thirrjen e tij, që bota e zymtë nga traditat dhe zakonet poshtëruese, të shembet dhe ta lirojë përfundimisht femrën nga prangat e skllavërisë. Gjithë plagët e zemrës i derdh në vargje. "O palmë Iraku, o zogë e mbrëmjes sime...", është thirrja e Kabbanit larg heroinës së vet "...e di që mbërritja tek ty është vetrasje" (shkëputur nga libri POEZI TË EGRA).

Akti tronditës i vetëvrasjes së motrës së tij do të hapte një shteg dhimbjeje në psikikën e poetit i cili me penën e tij do t'i tregonte botës, se ajo që shohin përreth nuk është e vërteta, por një botë e rreme, e gjymtuar, e plakur. Një planet që mohan gruan, femrën, ai planet mohan lindjen, jetën, lumturinë. Një planet i mbetur shterp nuk arrin kurrë të lulëzojë. Portreti i saj dhe i gjithë grave të vendit të tij, do t'i kujtojnë përjetësisht se sa pa krahë ishin fluturat e ëndrrave të tyre ndaj për to, duhet luftuar. Ndërprerja e jetës së motrës, për të mos e çuar dëm jetën e saj pranë një mashkulli shterp nga çdo mendësi, do t'i shërbente atij si një kambanë therëse për të kuptuar se në cilin kufi ishte vendosur tragjizmi i jetës së këtyre grave të pambrojtura, që nuk arrijnë kurrë të artikulojnë me zë të drejtat e tyre. Të drejtën për të qenë të lira në jetë, për të zgjedhur fatin e vet, për t'iu gëzuar frytit të vet. Të gjitha këto mbetën dhimbja e etur dhe e pashëruar e poetit, mbetën dëshira dhe etja më e zjarrtë e tij, për ta parë çdo grua në misionin kuptimplotë, që Zoti u kish dhënë që nga krijimi i botës. Por më e rëndësishme mbetet, që vet gruaja, gratë në përgjithësi, ta kuptojnë se ato janë thesar virtytesh. Bota


mashkullore duhet të ndërgjegjësohet se vetëm krahë saj, do të ndihet e plotësuar. Pa praninë e saj, jeta e tyre do të jetë një gjymtim i përjetshëm.

Këto mendime e bëjnë gjithë krijimtarinë e pasur të Nizar Kabbanit të qëndrojë shumë lart. Ai është vigan, në gjetjen e figurave, metaforave. Krijon tablo si një piktor, që di të luajë me dritëhijet, me terrin dhe dritën. Epiqendra mbetet gruaja, e dashura, nëna, motra, heroinat e ditëve të mbushura me zhurmën e jetës, me ecjen e saj të pandërprerë. Është portreti i gruas më të bukur arabe, mishërim i dinjitetit dhe heshtjes krenare. Ajo s'ka nevojë për poza dhe paradë për një përfaqësim dinjitoz. Në portretin e saj janë pikturuar bukuritë e pafundme të asaj toke të ashpër, janë vargoara e përskuqura nga perëndimet, është shkretëtira me sekretet e saj të pafundme, janë palmat dhe hurmat joshëse. Çdo varg të shtyn në ngasje, për të rendur drejt atyre vendeve, përgjatë asaj vije bregdetare, ku era lëkund një shami. Të bën të zgjatësh dorën dhe të prekësh sadopak burkën, që mbulon balluken e djersirë nga dielli, për të zbuluar fytyrën hyjnore të vajzës arabe me sy ngjyrë zhade.

A nuk e shikon? /Në çdo degë, guricë e gur? /Në fletoren e diellit kam shkruar, /Lajmin më të bukur: "Të dua shumë" /Ah, sikur ta kishe lexuar... (GDHENDJE ME FJALË).

Përfundimisht mund të them pa frikë, se poetika e Kabbanit është përfaqësimi më dinjitoz, më përparimtar në letërsinë e shek. XX, që troket me një frymë të re vlerësimi, me një mendësi dhe qartësi të re, duke u bërë kështu përfaqësuesi më largpamës, modern i letërsisë romantike dhe jo vetëm. Unik në vargëzimin e tij profetik. Ndoshta i vetmi për nga forca e gjetjeve mjeshtërore për të lartësuar figurën femërore. Për poetin deri në fund të jetës së tij, deri çastin që do të mbyllte sytë më 30 prill 1998, gruaja do të mbetej mbretëresha në fron, fytyra e pafajësisë para së cilës ai përulet me respekt të thellë. Ai dhe çdokush duhet ta bëjë këtë, thotë poeti, sepse ashtu si unë, edhe stinë që të këmbehen, kanë nevojë për femrën. Kallinjë e grurit kanë nevojë për dritën e syrit dhe frymën e saj, që të piqen. Burimet kanë nevojë që të derdhen e gurgullojnë furishëm, fluturat, zogjtë kanë nevojë për duart dhe prekjen e saj, që ajo t'u mësojë fluturimet. Vet qytetërimi ka nevojë për gruan, që të mbërrijë. Pa atë (gruan), qytetërimi do t'mbetet në udhëkryq... Ndaj poezia e poetit sirian Nizar Kabbani duhet të vlerësohet, duhet të bëhet e njohur, e zëshme dhe t'i jepet vendi që meriton në letërsi.





NJË NGA 100 LETRAT E DASHURISË

Avioni ngrihet lart e më lart
 Dhe unë të dua shumë e më shumë.
 Sa paskam vuajtur për një përvojë të re,
 Për provën e dashurisë së një gruaje
 Në lartësinë e tridhjetë mijë këmbëve.
 Tashmë fillova të kuptoj misticizmin,
 Dëshirat dhe mallin e mistikëve....
 Që lart , nga aeroplani
 Njeriu i sheh ndryshe emocionet e tij.
 Dashuria çlirohet nga pluhuri i tokës,
 Nga ligjet, nga graviteti i saj
 Dhe bëhet një top i pambuktë, pa peshë.
 Avioni rrëshqet mbi një qilim reje të bukur
 Dhe sytë vrapojnë, vërtik pas saj
 Si dy zogj kuriozë që ndjekin një flutur.
 Sa i marrë qenkam treguar,
 Kur mendova se po udhëtoja i vetëm.
 Sepse pas çdo pushimi
 Në secilin aeroport të botës,
 Je gjendur e fshehur aty,
 Në çantën time të dorës.

MË I BUKURI LAJM

Shkrova : " të dua " mbi murin e hënës.
 Të dua shumë.
 Siç nuk të deshi njeri asnjëherë
 A nuk e lexon në vijat e mija të dorës?
 A nuk lexon mbi murin e hënës?
 Mbi stolat në park,
 Mbi tringjet e pemëve,
 Mbi degët, mbi tryeze, mbi frytet,
 Dhe mbi planetët , ku fshij pluhurin e udhëtimit.
 Gdhënda : " të dua " mbi gurët magjikë,
 Gdhënda kufinjë e qiellit dhe të fatit
 A nuk arrin ta shohësh?
 Në petalet e luleve,
 Mbi shpat, mbi lum, mbi urë
 Në guackat e detit, në pikëlat e shiut.
 A nuk e shikon,
 Në çdo degë, guriçkë e gur?
 Në fletoren e diellit kam shkruar,
 Lajmin më të bukur:
 " Të dua shumë "./Ah, sikur ta kishe lexuar...

TË DUA SHUMË !

Të dua shumë dhe e di
 Që rruga drejt së pamundurës është e gjatë
 E di që ti je një grua përmbi të gjitha gratë
 Dhe që unë s'kam asnjë zgjidhje tjetër.
 E di që koha e dashurisë ka mbaruar
 Dhe që fjalët e bukura kanë vdekur
 Çfarë të them më shumë për më të mirën grua?
 Të dua shumë!
 Të dua shumë dhe e di që jetoj në mërgim.
 Dhe ti në mërgim ...
 Mes nesh ka erë, vetëtimja, re,
 Bubullima, dëborë dhe zjarr.
 E di që mbërritja tek ty është vetëvrasje
 Por unë kam një ndjenjë lumturie,
 Që për ty të flijohem, e shtrenjta ime.
 Dhe nëse do mundja,do e përsërisja sërish dashurinë për ty
 Moj grua, që këmishën ta enda nga fletët e pemëve
 Që me durim të mbrojtja edhe nga pikëlat e vogla të shiut
 Të dua shumë, duke e ditur që po udhëtoj i pasigurtë
 Në detin tënd të syve .
 Duke lënë nga pas mendjen, duke vrapuar,
 Duke vrapuar pas çmendurisë sime.
 Moj grua, që ma ke marrë zemrën në duar
 Tu luta, për hir të Zotit, të mos më lësh.
 Mos më lër...
 Çfarë do të jem unë nëse s'je pranë meje?
 Të dua shumë, shumë, shumë...
 Aq sa refuzoj me zjarr, të heq dorë prej teje
 A mundet i mbyturi në dashuri të japë dorëheqje?
 Por, nëse ndodh të heq dorë nga dashuria
 Nuk ka më rëndësi nëse mbetem gjallë
 Apo nëse dal i vdekur, i vvarë.
 Të dua shumë
 E di që isha shumë i dhënë pas teje
 Aq sa dogja çdo varkë pas meje.
 E di, që do dal shumë i humbur
 Pavarësisht mijëra grave
 Pavarësisht mijëra provave...
 Të dua shumë dhe e di,
 Që në pyjet e syve të tu po luftoj i vetëm.
 Që dhe unë, si të gjithë të marrët
 U përpoqa të gjuaja planetët.
 Do vazhdoj të të dua ,me gjithë bindjen time
 Që kam mbetur gjallë, falë dashurisë tënde
 E cila është një prej mrekullive.
 Të dua shumë dhe e di
 Që me kokën time po luaj.
 E di që kali im, është humbës në garë
 Që rruga drejt shtëpisë së tët eti
 Është e rrethuar nga mijëra ushtarë
 Ende të dua, me gjithë bindjen time të plotë
 Që pëmendja e emrit tënd është si blasfemia
 Dhe që unë, si ç'do i çmendur në botë
 Luftoj, përmbi fletoret e mija.
 Të dua shumë dhe pse e di si vdekja,
 Që dashuria për ty është vetëvrasje.
 Që pasi të luaj rolin,do t'më mbyllet perdja.
 Mbi mëshirën tënde, do ta vë kokën dhe pse e di
 që ditë nuk do ketë kurrë për mua
 Por e bind veten se vdekja, quhet fitore
 Në bie i vdekur për buzët e tua .
 Të dua shumë
 E dija që në fillim se do dështoj
 Që do vritem gjatë kapitujve që vijnë
 Që koka ime do vijë tek ti
 Dhe do qëndrojë në gjunjë para teje si fëmijë
 Përplot një muaj
 Do lumturohem shumë me një fund të tillë
 Dhe do mbetem në ty, i dashuruar.

DO TË TË THEM TË DUA

Do të them se të dua,
 Kur të ndjej se, toka ka nevojë për ty që të rrotullohet
 Kur kallinjtë e grurit, të kenë nevojë për ty që të zihen
 Kur stinët që të këmbehen, të kenë nevojë për ty,
 Kur burimet të kenë nevojë për ty, që të gurgullojnë,
 Kur qytetërimi të ketë nevojë për ty që të mbërrijë,
 Kur zogjtë të kenë nevojë për ty, që të mësojnë fluturimin
 Kur fluturat të kenë nevojë për ty, të mësojnë se si të pozojnë...
 Kur unë për të përmbushur porofecinë time,
 Të kem nevojë për ty

NJË LETËR NGA NËN UJI

Në qofsh miku im më ndihmo
 Që të largohem nga ti
 Në qofsh i dashuri im , ndihmomë
 Të shërohem nga ti.
 Nëse do ta dija dashurinë kaq të rrezikshme
 Nuk do dashuroja.
 Nëse do ta dija që deti është kaq i thellë
 Në të , s'do lundroja.
 Nëse do ta dija se ky është fundi
 Kurrë nuk do filloja.
 Më përzhati malli, ndaj mësomë
 të mos përvëlohem.
 Më mëso, si t'i pres gjer në fund,
 rrënjët e dashurisë për ty.
 Se si vdes zemra, si vetëvritet dashuria ...
 Mësomë , si vdes loti në sy .
 Në ke fuqi më shpëto,
 nga ky det me stuhi
 se unë nuk di të notoj.
 Dallga blu në sytë e tu, më tërheq thellë e më thellë.
 Dhe unë nuk kam përvojë në dashuri
 Nuk kam as ndonjë varkë, të lundroj.
 Në më ke të shtrenjtë , zgjatma dorën
 Unë jam e dashuruar në ty, kokë e këmbë
 Aq sa po marr frymë dhe nën ujë.
 Unë po mbytem,
 Po mbytem,
 Po mbytem...

(Shqipëroi Artan Almeta)

PRIFTI I VJETËR

Këndon ca vargje t' shënjtëruar,
dhe kryqin bën atje në kishë
E tund temjanin nëpër duar,
dhe vargje zë këndon sérish.

Dhe nuk e di pse herë mendoj,
sikur lexon vargjet e mia
Dhe Zot i madh nga lart besoj,
është bërë ashtu nga dashuria.

Unë kryq nuk kam mbajtur në qafë,
as lutjet sinqerisht nuk di
Me priftin kam shkëmbyer llaf,
për bibël edhe për poezi.

Kur vajzë e bukur shkon në mes,
ulet në gjunjë e lutet gjatë
Priftit i them; ohhh kjo krijesë
si mund të mos ta duash, o at.

Më sheh dhe kryqin bën shpejt,
më qafë më paç zoti poet
Në ferr do shkosh por ke të drejtë,
të gjithë se dimë se çka na pret.

Pastaj zërnë lutemi e bëjmë lëvdata,
se ç'gjuhë përdor nuk ka rëndësi
Ai mban mënd çka shkruan dhjata
unë recitoj një poezi...

KOHË PLAZHI

Të shkoj njëherë në rërë,
të ha një thelë sharqi
Pa le të thonë të tërë,
ky sqënka zotëri
Të digjem si qirinjtë
të bëhem kuq flakë
Të shkojnë zotërinjtë,
të thonë; ky qënka plak.

Të loz me top në breg,
të ngjirrem duke thurrur
Me mbathje blerë në treg,
me trup e krahë të çirur
Të hidhem mbi shkëmbinjtë,
të bie ku të dua
T'më ndjekin çiliminjtë,
të lozin pak me mua.

Të nxihem llërë e krahë,
të dukem si arap
Që vajzat të bëjnë ahh,
të ikin shpejt me vrap
Dhe tej matanë të thonë;
po ky qënka çudi
U dukërka demon,
po është për dashuri.

Të çaj valët në det,
më tutje se të tjerë
Pastaj të kthehem vetë,
të thaj flokët në erë
Përballë diellin e vrarë,
tek pishat nënë hije
Të thonë: qënka i shkarë,
s'ka pikë fisnikërie.

Në dreq shezlong mbi gurë,
në dreq çadër me kashtë
Unë gjersa u bëra burrë,
kam fjetur edhe jashtë
Në dreq ata që s'dinë,
ç'është jetë e qef pa çmim
Do jem i shtrirë mbi shpinë,
mbi rërë të bregut tim.

PENDESE

Të gjithë gabimet në këtë jetë,
unë kurrë si kam shikuar
Se për gjithçka paguaj vetë,
me zëmër të thërmuar.

Gabimet thjesht paguaj me lot,
me shpirtin e shpërthyer
E di asgjë nuk ndreqet dot,
nuk ngjitet çfarë është thyer.

Por jetë vazhdon ashtu siç ish,
gjithmonë kështu është shkruar
Paçka se lutem në një kishë,
dhe kurrë nuk jam penduar.

JASHTË

Në njëherë do më ndodhë,
të më zërë gjumi jashtë
Me ca plagë të mbështjellë,
herë me gjethe herë me kashtë
Do të fle në mes të fushës,
vesë të më bjerë mbi ballë
E të zgjohem lemerisur
në kam vdekur a i gjallë.

Po më zgjuan cicërimat
e ca zogjve të braktisur
Do t'u bëj nga një folezë
me këmishëzën e grisur
E do mbledhim kallëz gruri
e në pus do pimë një pikë
Do këndoj këngën e fundit
pa strument e pa muzikë.

Do të vijë një erëz fushe
zërin tej të ma përcjellë
Nëpër plepat pranë Gjanicës
ndër ugaret sapombjellë
Nëpër ujë tek shkon në det
plotë me dallgë edhe shkurmë
Po këndoj këngën e vjetër
Myzeqe të desha shumë.

DY HARABELA

Dy harabela cicërijnë,
bëjnë rrathe në ajër për çudi
Ndoshta kërkohet ca thërrime,
ndoshta po bëjnë dashuri.

I rrahin krahët plot hare,
e ulen poshtë rëndë rëndë
Kushdi çfarë thonë ëmbëlsisht,
duke u prekur sqep e pëndë.

Kërcejnë me këmbëzat e vogla,
(po hedhin valle sigurisht)
Vrapojnë mbi tokë lagur me shi,
e zënë e fluturojnë sérish.

I ndjek me sy të mallëngjyer,
ah sikur t'isha pak si ju
Të kisha krahë të fluturoja,
me gaz e shënd mbi qiell blu.

Nga lart të shihja njëëzëzë,
të bëja bashkë njëmijë të tjerë
Të shkonim tok mbi Myzeqenë,
të shihnim vëndin ku kam lerë.

Të shihnim arat plotë me grurë,
dhe myzeqarkat me shami
Pastaj të fluturojmë pareshtur,
në dheun tim, në Shqipëri.

LUFTË

Kur bota gjithë ishte në luftë,
unë bëja dashuri
Përreth shpërthenin mijëra krisma,
e qielli ish i zi
Dhe komandantët ulërinin,
në rresht.. në rresht ushtar
Gjersa në mes u përgjysmuan,
plagosur e të vrarë.

Kur bota ish në paqe prapë,
unë bëja dashuri
Përreth shpërthenin fishekzjarrë,
këndonin për liri
Por prapë lirinë se gjetëm dot,
ku shkuam nuk e dimë
Në luftë ish vdekje e pafund,
tani është ngashërimë.

Tani shkojnë trenat në stacione,
e s'gjej stacionin tim
Ndaç flas me vete midis jush,
siç flisja në fillim
Më quajtët friks e tradhëtar,
nga lufta mbeta gjallë
Pse s'mora pushkë edhe granatë,
pse s'vura yll në ballë.

Tani heronj jeni të tërë,
me plagë e shënjë plot gjak
Unë mbes gjithmonë në botën time,
më quani frikacak
Por unë gjithmonë pyes,
kjo botë është më e mirë
Edhe askush nuk më përgjigjet,
se qënka e vështirë.

Në ç'luftë do shkoni sot, të mjerë,
është luftë përsëri!???
Kanë lindur plot heronj të tjerë,
e nëna që mbajnë zi
Do vij dhe unë me ju kësaj radhe,
i mbushur pezmi e vrerë
T'ju pyes aty në mes betejës,
çfarë ndieni këtë herë....

KAM RËNË

Kam rënë me mijëra herë, me mijëra herë jam ngritur
Kështu na qënka jeta, herë qeshur dhe herë lot
S'do isha gjallë akoma, do vdisja i zhuritur
Nëse në këmbë s'do isha, nëse nuk ngrihem dot.

Kam rënë me mijëra herë por s'mbeta i rrëzuar
Nuk rashë fatit me grusht, nuk qava me dënësë
Por eca drejt gjithmonë, me këmbë edhe me duar
Një këngë duke kënduar për jetë edhe për shpresë.

Jam vrarë me mijëra herë sa shpirti vetë e di
Por qesha me të madhe dhe ndoqa hijë pa frikë
Nga plagët shtrydha qelb e nxora gjak të zi
Edhe me krahë të dridhur nga shpina hoqa thikë.

Nga pas shihja të tjerë që mbetën rrokullis
U çuan pak në gjunjë por prapë ranë në rrënim
U lutën ditë e natë për hir të perëndisë
Dhe mbetën të rrëzuar me dert e ngashërimë.

KATËR MINIATURA...

Bajramn SEFAJ

(prelud)

Këto katër rrëfenja miturake a vinjeta, që vargohen, ruspe në pe, si vijon: oborri i mallkuar, lypsar në moshën 82 vjeçare, elegji (inat) për vdekjen e... dhe, të gjitha merri me vete, janë kallëzime trup shkurta që, me rebelim, kryeneçesi e arrogancë, prej të voglit të përqurrur, të pa takat për asnjë punë të vyer, mëtojnë të bëjnë letërsi dhe, si të tilla, ashtu siç janë, të vrugëta, të vrara lije, marrin turr, bëjnë yrysh të hyjnë në prozën tonë moderne, shih ti ironinë e mjerë! Me përjashtim të njëres prej tyre, asaj me titull „Merri të gjitha me vete“, tri miniaturat e tjera, janë kryekëput rrëfenja mbështetë në tema reale, të përjetuara në tërë vrazhdësinë e realitetit të tyre. Të mbijetuara! As rrëfenja „Merri të gjitha...“ nuk është safi (fund e krye) imagjinuese, do të shihet dhe do të binden. Po mos tua vjedh kohën e shtrenjtë: secila veç e veç, ndiqet me këtë shpjegim të vocërr sqarues. Në vazhdim fjalën kanë ato vetë!

(e para: oborri i mallkuar - prokleta avlija!)

Fillimisht ishte reportazh. Reportazhi dhe tregimi flasin, pothuaj se, të njëjtën gjuhë. Hartimi i tregimit, le të nis, me përshkrimin besnik, autentik, pa ia hequr as shtuar asnjë shkronjë, reportazhit me nëntitull: dikur bukuroshe, tash (si) qyq e mallkuar (ngordhur), në rrembl!


Në rrugën e Durrësit që, s'ka rrugë tjetër më të njohur, as në Tiranë, as gjetiu, në gjysmën e saj, ndal hapin. Fërkoj sytë kur me varën e ndalen, si të gozhduar, në godinën e ish Ambasadës, të ish Jugosllavisë, aty. Përnjëherë, para sysh me dalin dy pamje të kësaj ngrehine. Të dy epokave!

E para, është: pamja e ruajtur (e ngjuar!) në kujtesën historike, si e fjetur të ishte, të periudhës së miqësisë së "lavdishme", (од давде до вјехности!), (shqip: këtu e në amshim!), me popujt vëllezër jugosllavë (pa shqiptarët e Kosovës!) e Shqipërisë! (Lexo: midis Enver Hoxhës dhe Josip Broz Tito-s). E dyta, është: pamja mizërie (ashtu çfarë ishte edhe miqësia e rreme vëllazërore midis Titos dinak dhe Enverit naiv dhe primitiv. (i tillë do të mbetet deri në vdekjen e tij të vonuar!).

*

Përcaktohem që, këtu e në këtë vend, të ngul këto dy pamje të këtij objekti. Të parën ashtu si e ruajti arkivi i Googles, të dytën, ashtu si e zuri objektivi i mjeshtrit Keli. (Me atë cohë rubi të zi si futa, shkrimin mbi të: sh i t e t! „Rruga e Durrësit, Tirana, Albania. Kjo godinë është ndërtuar në vitin 1931. Atëbotë, ishte pronë e familjes së doktor Qemal Jusufit. Ndërtesa ishte një nga vilat më të njohura dhe më të bukura të Tiranës së asaj kohe. Pas Luftës së Dytë Botërore, ajo ka shërbyer si rezidencë e Legatës turke. Më vonë, në të u vendos ambasadë jugosllave, ndaj në Tiranë ajo vazhdon të njihet si godina e ish ambasadës jugosllave... Pamja e sotme, e kësaj ngrehine kobzeze, është mjerë! (Reportazhi ia jep shaminë e galme, tregimit letrar të dhunshëm: "... sa herë ecet nëpër këtë Rrugë e, andejpari kalohet, së pakut njëherë në ditë! Rruga e Durrësit është më të frekuentuarat rrugë, jo vetëm në Tiranë, por në mbarë Shqipërinë e dashurisë sonë të pashuar, kësaj radhe, vërtetë - "од давде до вјехности!", pikërisht në pjesën e saj që zënë vend kjo ngrehinë, papritmas, më ndalet fryma. Më vërshojnë djersët e ftohta, si të vdekjes... Sakaq, para sysh me shfaqet një monstrë në trajtë veshi adalet të madh që, përgjon nga çdo anë... papritmas me shfaqen pëshpërimat mijëra buzëve të holla e të trasha! Shqiptojnë fjalë të pista: si me ia qi e shkërdhje Nënë Shqipërisë. Nënësonë Shqipëri! Me e ndarë e shpërnda, me e hupë krejt, me e zhbë, me e futë nën sjetullën e ombrellës, futë të zezë të Jugosllavisë së madhe, midis kombeve e kombësive të "barabarta e të vëllazëruara"!

Këto, ose një pjesë e këtyre projekteve të kobshme, mbi fatin e lig të Nënësonë Shqipëri, i hante xhaxhi me Politbyronë e tij. Planet e tilla ogurzeza, vini në shprehje dhe manifestoheshin zhurmshëm, sidomos



gjatë orgjive të pafund, rreth tryezave të mbuluar me plotë raki të fortë Skrapari, e mish kecash, berrash e derrash, të maleve tona legjendare. Rreth atyre tryezave, jo rrallë, gjendeshin edhe kokëderra shqiptarë nga Kosova, që rrashin mish të skuqur në hell. U fryheshin dejtë (deri pëlçitje nga raki e fortë rrushi!). Futnin kryet nën tryeza, me lutjen e djegur në buzë e në mermer: "ngatë zot kësi moti!" Kjo ishte palca e mlllefiti, kjo ishte ajo lugë e vogël, si e padukshme, zeheri që e helmon krejt një det apo oqean të pa anë... Ky ishte ai gjarpër qafëhollë, Anakonda që fshihej e atë reportazh që mëntonte gjithë inat dhe insistim, me çdo kusht, të bëhej tregim i hidhur letrar!

(e dyta: lypsar në moshën 82 vjeçare!)

Kjo rrëfejnë ose vinjetë a storje (thënë me gjuhën e sotme moderne) është gatshme: me skenografi, me ngjarje, fillim e mbarim, me personazhe, me dialog e krejt, është gdhendur a stampuar, në rrasën e gurit të zi të jetës sime tetëdhjetë e dy vjeçare. Si në Papyrus të lehtë të egjiptian. Nuk me mbetet tjetër pos ta përshkruaj, tamam ashtu si ndodhi. Ndryshe, poqë se ia ndërroj, ia mungoj a, ia shtoj, vetëm një fjalë të vetme, do të me zinte mallkimi i galmë, në të parin rend, mua vetë, e pastaj edhe i jua, lexues të nderuar, gjithë sa jeni! Në çastin kur peshë e trupi me është rëndua aq shumë, me është bërë i pa përballueshëm qoftë edhe një hap i mëtuqshëm, kur këmbët mu këputën në lak, kur fuqia mu shter krejt... në çastin që një marramendje froykë, si shami zezë ma mbështoll kryet... në momentin kur avitje dekiku i fshikullimit të rrezikshëm e me pasoja të renda... në një bërryl të mbrehtë të një rruge dytësore... të një qyteze, si të paemër dhe të panjohur fare, as për vetë francezët as, diku në verilindje të skajshme të këtij shteti të madh e të fuqishëm ..., pa pikën vetë në asnjë "repart" të trupit, si i alivanosur, ulëm, më parë do të thosha, shembëm, mbi një copë betoni të thyer. Instinktivisht republikën e heq nga koka dhe, prapë instinktivisht, lëshoj mbi gjunjë, si të vdekur. Pa vetëdije as pa kurrfarë qëllimi, republika me kishte qëlluar e kthyer mbrapshtë, si gojë e hapur e një shendi të lënduar për vdekje. Ashtu siç

rastësisht kalon atypari, i afrohet plakut dhe e pyet, ç' hall ke ore mixhë! Do pak kos zemrën me ta fladitë!

- Hiç mu kosi, aman, se me doli shpirti. Me duhet një kafshore P., aman, e asgjë tjetër s'më duhet, ia kthen përgjigjen plaku vashës!

Nuk isha bash i sigurt se francezja, vajzë re sa një lis me rrema, do ta kuptojë drejtë e paq, pa të keq, këtë qesëndi tonën, jo shumë të lashtë!

(e treta: elegji për vdekjen dhe ...)

Një humbje e madhe, kurrë e parikuperueshme, e pa razi e kompromis, po ngjet atje poshtë, në humbëtitë, në gropën e thellë, të pa fund, të zezë futë, të natës së errët, e të pagjumë, në vetmi, në të gjorën vetmi... Unë, po se po, unë vetë, jam kreator i kabahatit katil, i gjithë kësaj katrahure, me rrëmuje e hallakatje, pa shtegdalje! Së fundmi, po shkruaj tregime të mira, antologjike, misterioze, të rrëmbyeshme, të furishme, të fuqishme e të pa para, të panjohura në letërsinë tonë jashtëkohore... Me motive origjinale, tema të reja, të pa rrahura kurrë më parë. Të papërsëriturat reja. Taze. Të admiruara nga ana e të gjitha grup moshat dhe profilet e lexueseve. Diçka e paparë po ngjet atje poshtë, në zgafellen minierës se artit të zi, të artit të madh e të panjohur. Nata me gjumin copa-copa pleqërie, të pa ngjithshme kurrë, mësa ngjiten dy copa xhami të thyera keq, më se miri, me besnikëri e çiltërsi, dëshmojnë dhe këtë pohim mëkatar. Mbulojnë dhe arsyetojnë tregimet e mia që, gjithnjë e më shpesh, i shkruaj netëve të gjata e gjumit të keq, gropa-gropa, të këputshim, gjullurdi në terr të zi, të netëve dimërore, pa kurrkund fund... Kjo hata e mrekullueshme e çudane njëkohësisht, po thuat se, ngjet natë për natë, nën plafin e murrme natë. E mbytet dyshekun e shtratit duke i ndrydhur betonet e shkronjave të tastierave të kompjuterit, duke vu pika e presje e pikësime tjera të llojllojshme, me mbarim të çdo fjalie. Kure fjalitë që, së e cila më duket më mirë se tjera, kur faqja e parë kompjuterit të stërm bushur me tekst, të paparë dhe të pangjarë, kur veçe nuk troket në dyert e Akademisë Mbretërore të Suedisë, për të rezervuar vendin e fituesi të çmimit Nobel për letërsi, për këtë vit, fillon betejat tjetër akoma më e pamëshirshme se e para. Tash teksti gjenial, origjinal, (origjinaliteti i të cilit, trason rrugën për në Stokholm, duhet regjistruar e ruajtur, me xhelozit fort të madhe, me sekret misterioz.

Kur edhe ky shteg kapërcehet me sukses, nga trupi i lodhur fare, i plogësht, si mella-mellë e Mellishtës, ç'e vesh rrobën e zezë, ç'e vesh këmbëshin e pikëllimit të thellë turbullues. Marr frymë lehtë. Nëpër mend më fluturon një pëllumb i bardhë e, në vesh ma gugatë këngën e sevdasë se, nesër a pasnesër, hiç më larg, sivëllezërit e mi, do ta kruajnë kryet kur të shohin, me sytë tyre vëngër dhe, do të binden se, kush është Bjarushi "i tyre"! I përbuzur, i keqtrajtuar, i përbuzur dhe i nënçmuari "i tyre" padrejtësisht, i mohuar, përjetësisht!

(e katërta: krejt merri me vete!)

Nga ç'mëndafsh janë bërë gishtat e tu, nga ç'fildish kofshët e tua të lëmuara, nga cilat lartësi në hapin tënd arriti /bukuria e dhisë së egër nga ç'hapa./Nga ç'manaferra të pjekur e kanë shtrëdhur/ shijen paksa të thartë të gjinjve të tu, / nga ç'Indi bambuja e belit tënd./ari i syve tu, nga ç'vend vjen./Nga ç'gurgullimë vale /shkojnë të kërkohet rrugën gjarpëruese ijete e tua./nga ku lind freskia e burimit/që nga goja gurgullon kur ti qesh./Nga ç'pyje - det u shkëput/ dega e koralit të venave, /parfum /lajmëron ardhjen tënde /të më ngjeshësh dëshirat e natës «Inventari» - Jose Saramago Ngjau kjo, që nisa ta rrëfej, në një qoshe të skajshme, nisesos ekstreme, të provincës verilindore të Francës - La Haute Savoie. Pak metra ndanë Liqenit të njohur e të hijshëm Léman që, si gjuhë e lëngshme ujore, ndanë dy shtete fqinje, Francën me Zvicrën. M'u mbush mendja se të gjitha

parakushtet plotësuar, janë pjekur, janë bë optimale dhe, madje janë plotësuar maksimalisht të favorshme janë, Bukuroshes që e kisha njoftuar rishtazi, pak ditë më parë, t'i telefonoj dhe t'i propozoj të shihemi e takohemi nesër mbrëma, në kohë dhe vend të caktuar. Të darkojmë bashkë në restorantin më të njohur në Gjenevë, në kuzhinën e të cilit më se miri përgatitet e gatuhet specialiteti vendor i njohur gjithandej si fondu (fondy). Gatesë e thjeshtë ushqimi të popullarizuar kombëtar, me histori të gjatë, deri në legjendë, zbulimi. I rastësishëm, si çdo zbulim... Në gjuhën shqipe, fondu nuk do të thotë asgjë tjetër pos, djathë i shkrirë, me kusht paraprak se, bëhet fjalë, mbi një lloj djathi të veçantë, një tip kaçkavalli special, apostafat i nxanë për fondu. Synohet që djathi-kaçkavalli, të jetë i llojit të veçantë, i cilësisë sa më të lartë e, jo çfarëdo djathi!

E ftoja për darkë e, mendjen, e kisha tjetërkund! Mendja ime firifiu dhe hileqare, ashiqare!

* Ftesën për darkë, bukuroshja e pranoi hareshëm. Porosia "Merri me vete, të gjithat!", e turbulloi pakëz nga se, s'e kishte dëgjuar kurrë me parë, sigurisht. Isha i lumtur dhe i gëzuar shumë, për këtë porosi origjinale që nuk e kisha dëgjuar, as unë vetë, kurrë më përpara dhe, nuk e dija se, nga me erdhi papritmas, si me mbiu në kokë! I ngazëllyer pas kësaj porosie, sa s'ka ku shkon më me origjinale që, e shqiptova për parën herë në jetë, vetëm disa minuta më parë, ia rrëfej një të njohurës time, fort të çmuarës shqiptare, të bukures dhe inteligjentes shkodrane. Trupshkurtër "si dukati mbështjellë në letër...", sy zjarrtë që, me shpoti këmbëngulëse dhe përkëdheli delikate, e thërrisnin "çiki i Shkodrës" që, e takoj rastësisht!

Marr leje t'ia them vetëm dy, jo më shumë, fjalë admirimi dhe respekti të pa luhatur, për këtë zonjë të shtrenjtë që vjen nga qyteti ynë verior, Shkodra jonë e bukur, Shkodra e Mjedës, e Fishtës, e Migjenit, e Marubëve, e Krajës, e Drinit e të tjerëve. Me duhet të them, shkoderania afro të pesëdhjetave, nënë e dy fëmijëve si drita, është fort inteligjente, e bukur, si rreze dielli pranveror, e gjallë e dinamike. Sy prehtë, si Shqiponjë e alpeve tona... Mezi, prisja t'i rrëfeja porosinë që, përmes telefonit të mençur, veçse e kisha derdhur në vesh të një të njohurës rishtas nga qyteti i Gjenevës.

*

Shkoderania, shejtankë lozonjare, kënaqet me këtë gjetje, sa origjinale aq edhe befasuese, dhe, aty për aty, shmang timen dilemë kryq, cili prej nesh, unë apo zvicerania e re, na takonte të bëjmë verifikimin se, vërtetë, të gjithat janë aty! Një e tillë detyrë "delikate", me përkiste mua, askujt tjetër! Nuk e di, qysh e si e pse, ra fjala, kur një femër lakuriq, cullak = nudo, shtrihet mbi çarçaf të bardhë, imazhe e pamje çfarë shpesh ndeshim në pikturat e mjeshtërve të mëdhenj, ngjajnë në tryezë të shtruar me tëra të mirat e kësaj bote. Shkoderania e bukur, unanimisht pajtohet me këtë krahasim, ngase i ngjanë i qëlluar dhe efikas. Kështu lind tregimi në tregim. Imajjinoheni!

Shtati lakuriq i femrës se re e të bukur në sfondin e çarçafit të bardhë, është një mrekulli në vete. Është një dhuratë e perëndisë, për atë që ka mendë në krye!

*

Mbrëmjen e asaj të premtjeje të bekuar vjeshtore, ndodhi pikërisht ashtu si duhej të ndodhte! (Merret me mendë me çfarë padurimi, o zot, e prisja atë çast hyjnor!). Fjalët ishin të tepërta, kurrsesi nuk hynin në mes dhe, qoftë për një sekondë, të shtynin atë çast të pritit me shku! Tashmë ashtu siç „e ka ba nana“, thuhet në nahijen tonë, e kisha para meje! Detyrë të rendë e delikate: prej nga të nisej loja. Ajo verifikimit së, me të vërtetë të gjithat ishin aty. Dilema ishte e madhe. Vrasëse ishte. Afër krizës. Afër atakut kardiak. Nga cila anë, të nis verifikimit: nga këmbët, nga kryet! Vështroja atë mrekulli, kryevepër artistike të nënës Natyrë, shtrirë mbi shtrojën e bardhë. Shtati i saj i qumësht i bardhë, si të ishte njehsuar me ngjyrën e bardhë të çarçafit të bardhë. Trullosje. Mëndje mpire. Shikim i turbulluar. Vetëm flokët e saj gjatë e të zezë, si hije e një peme frutore, dalloheshin të shprishur mbi bardhësisë së jastëkut. Si lis mali, i shkallmuar, fshikullohem bri trupit të saj. Kokën e bukur, mrekullisht të modeluar, ia zë midis pëllëmbësh të harlisura në ethe të trenta shqetësimi drithërues. Numërimi evidentues nis, disi si në ëndërr. -Heshtjes, i flas në heshtje: flokët e dendura e të lëmuara, i paska me vetë! (Tureçkën ia rrsi në blejë flokësh sa për të marrë nga andej një vrushkull arome të mirë të një parfumi të rrallë, befasues dhe, të panjohur fare!). Aty, midis flokësh të valëzuar, si në vëzhgim të përhershëm, çuçurinin veshët e bukur të saj. (Të denjë për vath dukatit!). Ballin, e bukur, si shteg mali, ia stolisin dy

fije vetullash, poshtë cilave, shkrepnin si semaforë, sytë kaltërosh nën hijen e qepallave, si krah shpendi të bukur mitologjik!, ia ndante hunda e drejtë perfektë, si e modeluar dalte të Mikelanxhelos!. Matanë buzëve all e epsndjellëse, bojatisur me krem diskret e me shije të hollë i vezullonin dhëmbët e bardhë sheqer. (Si inxhi margaritarësh të rrallë!).

Në parantezë. (Një copë herë u mata të bëj hygjym e t'ia kafshoj e gëlltis buzët, gojën kuti e, krejt. Hezitova nga se, si për dreq, nëpër mend me vetojë, si shpendkeq, proverbi vulgar sllav, kur thotë se: "puthja, është trokitje në derën e epërme, për tu çelur e poshtmjn"! Pa as më të vocërrën dilemë heq dorë nga gjithë kjo mugëtirë befasues!. Fyti saj, përrallë në vetë! (I denjë për ruspe qelibari dhe kolon e medaljon të artë, me shqiponjë, simbol yni, në mes). Kalkulimi i derikëtushëm del tejet i mirë dhe shpresëdhënës: flokët, veshët, balli, sytë me qerpikë, goja me buzë all, goja kuti... Livadhis tutje... Sy e duar, me ndalen në bregoret e hareshë! Ato ishin përrallore. Të papërshkrueshme kollaj. Të vala, të forta, të rrumbullakëta. (Me dy thimtha, maje ngrehur përpjetë!). Duart e saj, përrallë në vete!

As të vogla, as të mëdha. Tamam. Ideale. Gishtërinjtë e gjatë e të urtë, përfundonin me thonjtë e bojatisur me një llak diskret, me shije artistike. Si dy degë lumi vërshues i rrjedhin, i lëshoheshin teposhtë, si të mbire nga shpatullat e kraharorit piktore-sk. Njëra dorë, me stoli tatuazhi të zbehur, thjeshtë poetik, i ndalej afër gropëzës së kërthizës, si oazë biblike, sajuar për pushim e këndëllje, të udhëtarit të etur në shkretëtirë! (Ja edhe një tatuazh befasues që, aq mirë flinte në atë hapësirë marramendëse, turbulluese! Ishte ai pëllumbi i bardhë (simbol universal paqeje, qetësie e rehatie!), ashtu si i dalë nga dorë e artë e piktorit të njohur Pablo Picasso). Shuplaka e dorës tjetër, të djathtës, e lidhur në grusht, si kapak, vendosur mbi kodrinën e pubis-it. Me të shmangur të lehtë të pëllëmbës së saj nga ai pozicion, para sysh me shfaqje një diçka që mrekullon tërë botën. Kopshti i Edenit me tërë bukurinë tij mitike e mistike. Kur ia pash të qarën e qejfit, mu hodh që buzët t'i përpuq mbi ato të qq (qarës se qejfit). Nuk ndodhi kjo, jo! (I përkas gjeneratës së një epoke tjetër, provinciale, më primitive ndoshta, kur bëhej seks i thjeshtë, i pastër e higjenik, vetëm me grumbullimin

e gjymtyrëve, siç na mësonte Kanuni i lashtësisë! Në atë gjullurdi e sipër, kur krejtësisht isha i humbur dhe i të asaj që shihja me sy të mjegulluar nga epshi si i harrur, qatë mu kujtua vargu a thënia e poetit të etnisë tonë: "Hapi degët, ta shoh diellin!". Diell e Qiell, bashkë, përpiqen në një pikë!

Këmbët e saj, të drejta e të hijshme shumë, si të dala nga mollaqet simite (që me hidhje t'i haja pa bukë, përfundonin në dy shputa të madhësisë fantastike, as tepër të mëdha, as tepër të vola, përsosmërie elegante me ca gishtërinj të pastër e të bardhë. (Më hidhej t'ia kafshosh përnjëherë!). Në zog këmbë i shndriste një kollan thurur kuq e zi, me dy ngjyrat e flamurit tonë kombëtar... Oh, sa i mbushur, deri në flakërim ngazëllimi, me zbrazej, deri në dhembje e pikëllim, dal nga ai zavall, gjersa i bie në fund shëtisë, asaj gjezdisje të hareshme shtigjeve të plantacionit trupor të vajzës së re e të bukur nga Gjeneva e liqenit Léman! Në fund të kësaj rruge të gjatë, përplot me provokime të sërta, pa pasur mundësi objektive, të thith e shijoj, tërë ëmbëlsirën e asnjë nga frutat e plantacionit të saj, ulëm në cep të shtratit dhe ia krisi vajit me ngashërim të thellë...

*

Pas disa ditësh, në takimin spontan dhe krejt të rastësishëm, shkoderania sygacë, inteligjente dhe prehtë si xanxë, sikur prishte "raport" prej meje. Me se shumti e impresionoi fakti, kur i thash se, në plantacionin e shtatit të zviceranes së re e të bukur, ndesha në bregoret e hareshë, gjinjtë e saj të gufuar dhe në të qarën e qejfit të saj. Plantacion, ma priti me nxitim, shkoderania lozonjare, e ke huazuar nga poeti ynë i madh (D.A.), patriark i poezisë shqipe, kurse bregoret e hareshë dhe e çarës së qejfit, janë gjetje origjinale dhe gjeniale, të shkrimtari tonë të njohur (I. K.) që, edhe ai vetë, rrugën e mundimshme të letërsisë, e nisi me vargje poezie dhe, e mbylli, me rreshta pambarim të prozës kilometrike... Shkoderania jonë, bukur i rrallë, sikur ngutej t'i vente kapak këtij muhabeti të gjatë e mbase të mërzitshëm për të dhe jo vetëm! Mezi prishte të vazhdonte leximin, e porsa nisur, aty ku e kishte lënë, faqe 49, të romanit të mrekullueshëm "Rrethimi" të autorit të talentuar bashkëkohor e modern shqiptar, Tom Kuka. E lumja Ajo!

*

(Gaillarde- Prishtinë, 2023)

Tregime: HORACIO QUIROGA

NATA

Nuk më zë gjumi. Një femër më ka ngecur kryq mes qepallave. Po të mundja do t'i thosha të ikte; por një femër më ka ngecur kryq mu në grykë.

Zonjë, m'i shqyjej rrobat dhe ndërzymjet. Më zhvish, më shndërdy. Mua më zë gjumi në buzë të një femre: mua më zë gjumi në buzë të një gremine. Shkëputem prej përqafimit, dal në rrugë. Në qiellin që po zbardhet vizatohet hëna e pakur. Hëna ka dy net që ka lindur. Unë, një.

JA, SHIKOJE!

Një sulltan i njohur për padije dhe për bëma të këqija e thërret një ditë Nastradinin dhe i thotë:

- Kam dëgjuar që ti e njehe djallin dhe takohesh me të. Më thuaj si është djalli? Nastradini nxjerr një pasqyrë që e mbante në xhep, e vendos atë përpara fytyrës së Sulltanit dhe i thotë: - Ja, Madhëri, shikojë.

SHQIPONJA, KORBI DHE BARIU

Një shqiponjë, duke vrojtuar që nga një lartësi e madhe, shikon një tufë delesh. Pasi vrojton mirë, dallon një qengj që po flinte, pak larg prej tyre dhe prej bariut. Atëherë, shqiponja vendos ta rrëmbejë dhe lëshohet si shigjetë. E mbërthen qengjin me kthetrat e saj të fuqishme, e merr dhe ikën.

Këtë skenë e shikon korb i që po rrinte në majë të një peme. Korbit i mbushet mendja se edhe ai mund të bënte atë që bëri shqiponja, prandaj, vërsulet fluturimthi mbi një dash. Korbit, i cili qe vërsulur me një forcë që nuk e kishte provuar ndonjëherë, i pleksën kthetrat me leshin e dashit. Përpiqet korb i të shkëputet dhe të iki, por është e kotë. E shikon bariu këtë skenë dhe shkon me vrap te dashi. E kap korbin dhe, pasi i shkurton krahët që të mos fluturojë dot, ua çon fëmijëve në shtëpi që të luajnë me të. Fëmijët, që nuk kishin parë më një shpend të tillë, e pyesin të atin:

- Baba, çfarë shpendi është ky? - Për mua është një korb, por vetë ky lumëmadhi beson se është shqiponjë, - u thotë babai, duke qeshur.

PERANDORI I SHËMTUAR

Perandori i mongolëve, Timurlengu, (Timuri i Çalë) kishte dëgjuar për famën e Nastra-

dinit dhe kishte dërguar njerëz që t'ia sillnin. Pasi ia sjellin, Timurlengu, i kënaqur prej tij, e mban Nastradini pranë, shumë ditë.

Një natë, Nastradini Hoxha, si zakonisht, hyn në sallonin e perandorit dhe habitet, kur e shikon Timurlengun, duke qarë.

- Madhëri, më lejoni t'ju pyes, pse po qani? - i thotë Nastradini. - Për herë të parë po shikoj veten në këtë gjë që quhet pasqyrë, të cilën ma ka dërguar si dhuratë Perandori i Kinës. Dhe, kur shikoj se unë, një nga sovranët më të fuqishëm të historisë që sundon gjysmën e botës, qenkam kaq i shëmtuar, nuk e mbaj dot të qarët, - përgjigjet gjithë dëshpërim Timurlengu. - Ju madhëri, një herë po e shikoni veten sa i shëmtuar jeni dhe po qani, - i thotë Nastradini i habitur. - Atëherë, unë, oborrtarët tuaj dhe gjithë ata që ju shohin përditë, duhet t'ia mbathim vrapit, duke ulëritur.

KATËR GJAHTARËT

Katër gjahtarë, të lodhur dhe të etur, po ktheheshin nga gjahu. Kur kalojnë para shtëpisë së Nastradinit, flasin dhe kërkojnë ujë për të shuar etjen. Nastradini që nga natyra ishte shumë mikpritës, jo vetëm që u jep ujë, por i fton brenda dhe i mban për drekë.

Pasi hanë e pinë, mysafirët, të kënaqur nga mikpritja, e falënderojnë me gjithë zemër Nastradinin dhe ngrihen për të ikur.

Nastradini, për ta bërë nderin e mikpritjes deri në fund, i jep secilit prej tyre nga një shishe me ujë, duke u thënë:

- Rrugën e keni të gjatë dhe me këtë vapë të madhe, do t'ju marrë etja. Prandaj, merrni nga një shishe me ujë ta kini me vete.

Tre prej tyre e falënderojnë me gjithë zemër Nastradinin për kujdesin dhe mikpritjen e bukur, kurse i katërti, jo vetëm që nuk e falënderon, por i kërkon edhe një shishe tjetër me ujë.

- O Allah! - thërret Nastradini, me një zë, gati vajtues. - Tani të njoha se cili je. - Me këto roba që kam veshur unë, nuk më njehe dot as ime shoqe, jo ti që nuk më ke parë kurrë, - i thotë ky. - Po, po. Të njoha, - thotë, i sigurt, Nastradini. - Zotrote je ai që qeveris tërë krahinën. - Po, ai jam. Por më thuaj si më njohje?! - habitet tjetri. - Nga etja që ke. Jo vetëm për ujë, po për çdo gjë. Sidomos, për pushtet, - ia kthen Nastradini.

Në shqip: Bajram Karabolli

Përtej dritares së frymëzimit

POETI DHE BOTA

(Ligjërata e mbajtur përpara Akademisë Suedeze kur autorja u nderua me Çmimin Nobel)



Nga Wislawa SZYMBORSKA

Thonë se fjalja e parë e çdo fjalimi është gjithnjë më e vështira. Kështu pra, sidoqoftë unë e thashë atë. Por kam përshtypjen se fjalitë që vijnë më pas - e treta, e gjashta, e dhjeta e kështu me radhë, deri tek rreshti i fundit-do të jenë po aq të vështira, përderisa do t'më duhet të flas rreth poezisë. Unë kam thënë fare pak në titull, ose më saktë, asgjë. Dhe sa herë që kam thënë diçka, gjithnjë kam pasur dyshimin e fshehtë se unë nuk jam e prerë për të tilla gjëra. Ja përse leksioni im do të jetë disi i shkurtër. Gjithë defekti do jetë më lehtë të tolerohet në qofte se serviret në dozë të vogël.

Poetët bashkëkohorë janë skeptikë dhe dyshues madje, ose veçanërisht, edhe për veten e tyre. Ata ngurrojnë të rrëfejnë publikisht qenien e tyre si poetë, krejt sikur të ndjenin një lloj turpi prej këtij fakti. Por në kohët tona është shumë më e lehtë të pranosh gabimet e tua, sidomos kur ato shfaqen tërheqëse, sesa të pranosh meritat personale, ngaqë ato janë të fshehura thellë e më thellë dhe as ti vetë nuk i beson ato. Kur plotësojnë ndonjë pyetësor ose flasin me njerëz të panjohur, pra, atëherë kur ata nuk e shmangin dot të zbuluarit e profesionit të tyre, poetët preferojnë të përdorin termin e përgjithshëm "shkrimtar" ose përpriqen ta zëvendësojnë fjalën "poet" me emrin e çfarëdo lloj pune që ata bëjnë përveç të shkruarit. Zyrtarët dhe pasagjerët e autobusit reagojnë të prekur dhe me një lloj alarmi kur zbulojnë se kanë të bëjnë me një poet. Mendoj se edhe filozofët mund të përballen me të njëjtin reaksion si poetët. Por, ata janë në një pozicion pak më të mirë, përderisa kanë mundësi të zbulojnë emrin e tyre me disa lloj titujsh akademikë. Profesor filozofie - tani tingëllon me shumë më tepër respekt.

Por Profesorë Poezie - nuk ka. Kjo do të nënkuptonte para së gjithash që poezia të

ishte një lloj "profesioni" që kërkon studim të specializuar, provime periodike, artikuj teorikë me shënime dhe bibliografi të bashkëngjitura, dhe së fundi, diploma të dhëna në mënyrë ceremoniale. Kjo do të nënkuptonte, se nuk do të ishte mjaft që të mbushje fletët qoftë dhe me poezi më të jashtëzakonshme në mënyrë që të bëheshe poet. Elementi më vendimtar do të ishin ca copa letre të mbushura me vula zyrtare. Le të kujtojmë për një moment se krenaria e poezisë ruse, Nobelisti i mëvonshëm, Joseph Brodskij ka qenë dikur i dënuar me internim në ekzil pikërisht në një sfond të tillë. Atë e quanin "parazit" sepse atij i mungonte vërtetimi zyrtar që i jepte të drejtën të quhej poet. Disa vite më parë, kam patur nderin dhe kënaqësinë të takohem me Brodskijn personalisht. Dhe vura re se, nga të gjithë poetët që kam njohur, ai ishte i vetmi, që e quante veten poet. Ai e shqiptonte këtë fjalë pa asnjë lloj kompleks. Përkundrazi - ai e thoshte atë fjalë me një lloj lirie sfiduese. Dukej sikur kjo ndodhte sepse atij i vinin në mendje të gjitha poshtërimet dhe fyerjet brutale që i ishin bërë në rini.

Në shumë vende të tjera më fatlume, ku dinjiteti njerëzor nuk sulmohet kaq hapur, poetëve ua ka ënda, natyrisht, të publikohen, lexohen, dhe kuptohen, por ata bëjnë fare pak, ose asgjë, që ta vënë veten mbi turmën e zakonshme dhe çikërrimat e ditës. Dhe akoma jo shumë kohë më parë, në dekadat e para të këtij shekulli, poetët përpriqeshin të na shokonin me veshjet e tyre ekstravagante dhe sjelljet ekscentrike. Por e gjithë kjo është bërë thjesht për hir të shfaqjes në publik. Vjen gjithnjë një moment kur poetët duhet të kenë mbyllur dyert pas vetes, kanë hequr mantelët, dhe janë përballur-qetësisht, duke pritur me durim veten e tyre të vërtetë - gjithnjë si një fletë e bardhë letre. Fundja kjo është ajo që ia vlen të përmendet.

Nuk ndodh rastësisht që në filmat

biografikë për shkencëtarët apo artistët e mëdhenj shumë drejtorë ambiciozë filmash, kërkojnë të riprodhojnë me besnikëri procesin krijues që i ka çuar ata në zbulime shkencore shumë të rëndësishme ose në daljen në dritë të kryeveprave. Dhe ndonjë mund të ketë përzgjedhur disa lloj punësh shkencore të suksesshme. Laboratorë, instrumente, makineri përpunuese kanë sjellë në jetë skena të tilla që kanë arritur të tërheqin vëmendjen e auditorit për një moment. Dhe, ato momente pasigurie që do ta përcillnin eksperimentin për të njëmijtën herë me disa ndryshime të imta duke i dhënë mundësinë për të pasur rezultatin e dëshiruar-do të ishin vërtet dramatike. Filma për piktorët mund të bëhen spektakolare për sa kohë që ato pasqyrojnë çdo shkallë të evolucionit të krijuesit, që nga penelata e parë deri tek goditja e fundit e furçës. Muzika shkëlqen në filmat mbi kompozitorë të ndryshëm, akordet e para që tingëllojnë në veshin e muzikantit shfaqen përfundimisht si një punë e pjekur në formën e një simfonie. Sigurisht që e gjithë kjo duket shumë naive dhe nuk shpjegon gjendjen e çuditshme mentale që njihet nga njerëzit me emrin "frymëzim", por sidoqoftë japin diçka që mund të shihet a dëgjohej.

Por për poetët është më e keqja. Puna e tyre është fatkeqësisht jo e dukshme. Dikush ulet në një tryezë ose dergjet në një kolltuk duke vështruar pa lëvizur murin ose tavanin. Ndodh shumë rrallë që ky person shkruan shtatë rreshta dhe më pas një tjetër ndoshta pesëmbëdhjetë minuta më vonë... Dhe një tjetër pasi kalon një orë më vonë... Kush mund të ketë durimin ta shohë këtë lloj gjëje? Përmen- da frymëzimit. Poetët bashkëkohorë përgjigjen në mënyrë të mjegullit kur pyeten se çfarë është frymëzimi dhe nëse ai ekziston apo jo. Jo sepse ata s'e kanë njohur kurrë bekimin e këtij impulsi të brendshëm. Thjesht, nuk është e lehtë t'i shpjegosh dikujt tjetër, diçka që ti vetë

nuk e kupton.

Kur ka ardhur rasti të jem pyetur rreth kësaj, edhe unë i jam shmangur kësaj pyetjeje. Por përgjigja ime do të ishte kjo: frymëzimi nuk është privilegj ekskluziv i poetëve ose artistëve në përgjithësi. Ka pasur, ka dhe do ketë gjithnjë disa grupe njerëzish të cilët i viziton frymëzimi. Është sajuar në mënyrë të tillë për të gjithë ata që në mënyrë të ndërgjegjshme ndjekin impulset e tyre dhe e bëjnë punën e tyre me dashuri dhe fantazi. Këta mund të jenë mjekë, mësues, kopshtarë- dhe mund të listoja më shumë se njëqind profesione. Puna e tyre shndërrohet në një aventurë të pandërprerë për sa kohë që ata përpiqen të zbulojnë sfida të reja në të. Vështirësitë dhe ndalesat nuk e vdesin kurrë kuriozitetin e tyre. Një grumbull pikëpyetjesh shfaqet sa herë që ata zgjidhin një problem. Çfarëdo që të jetë frymëzimi, ka ardhur nga një "UNË NUK DI" e vazhdueshme.

Ka lloje të ndryshëm njerëzish. Shumica e banorëve të Tokës punojnë për ekzistencë. Punojnë sepse duhet të punojnë. Ata nuk e kanë zgjedhur llojin e punës nisur nga pasioni: rrethanat e jetëve të tyre e kanë bërë këtë zgjedhje në vend të tyre. Punë e pabukur, e mërzitshme, punë që vlerësohet sepse të tjerë akoma nuk kanë marrë aq shumë, -sidoqoftë mbeten të pabukura dhe të mërzitshme- kjo është ana më e ashpër e mjerimit njerëzor. Dhe nuk ka ndonjë sinjal deri tani që shekujt e ardhshëm do të sjellin ndonjë ndryshim për mirë në këtë drejtim. Por, megjithatë unë e mohoj frymëzimin si monopol vetëm të poetëve, për mua ata mbeten një grup i përzgjedhur i të dashurve të Fatit. Megjithëse në këtë pikë, prapë mund të ngrihen shumë dyshime. Të gjithë llojet e torturuesve, diktatorëve, fanatikëve dhe demagogëve luftojnë për pushtet duke ulëritur me zë të lartë slogane, që i bëjnë të shijojnë dhe të ndjejnë kënaqësi nga puna që bëjnë, dhe gjithashtu shfaqin një zjarr të madh krijues në zbatimin e detyrës. Pra, në rregull, por ata dinë. Ata dinë dhe çfarëdo që ata dinë është e mjaftueshme për ata njëherë dhe përgjithmonë. Nuk duan të bëjnë zbulime rreth asgjëje tjetër, që mund të çojë në pakësimin e forcës së argumentit të tyre. Dhe çdo njohuri që nuk çon në çështje të reja është e destinuar të vdesë shpejt, sepse dëshon të mbajtjen e temperaturës që siguron jetën e gjallë. Në shumicën ekstreme të rasteve, të njohura që nga historia e lashtë e deri te kjo moderne, kanë poseduar madje kërcënime vdekjeprurëse për shoqërinë. Kjo është arsyeja që unë vlerësoj kaq lart frazën e vogël "UNË NUK DI". Është e vogël por fluturon në shumë drejtime. I zmadhohet jetët tona dhe i bën ato të përfshijnë hapësirat që janë si brenda ashtu dhe jashtë nesh, në të cilat kjo Toka jonë e vogël varet pezull. Në qoftë se Isak Njuton nuk do të kishte thënë kurrë me vete "unë nuk di", mullët në kopshtin e tij të vogël do të kishin vazhduar të binin në tokë si një breshër gurësh dhe në rastin më të mirë ai do të ish përkulur t'i mblidhte ato dhe t'i shijonte me babëzi.

Në qoftë se bashkëpatriotja ime Marie Sklodowska-Curie nuk do të kishte thënë kurrë "unë nuk di", ajo ndoshta do të ish sflutur duke u mësuar kimi zonjushave të reja nga familje të mira në ndonjë shkollë private dhe do t'i mbyllte ditët e saj duke u munduar t'ia tregonte këtë si një punë absolutisht të respektuar. Por ajo vazhdoi të thotë: unë nuk di dhe këto fjalë e çuan atë jo një por dy herë në Stockholm, ku shpirta të paqetë, gjithnjë në kërkim,

vlerësohen nganjëherë me çmimin NOBEL.

Poetët, në rast se janë mirëfilli të tillë, duhet të përsërisin vazhdimisht "unë nuk di". Çdo poezi tregon një përpjekje për t'iu përgjigjur kësaj deklaratë. Por sapo pika e fundit vihet mbi fletë, poeti fillon të hezitohet, fillon të kuptojë se kjo përgjigje e pjesshme është kaq e përkohshme saqë bëhet absolutisht e papërshtatshme për një fillim të ri. Kështu që poetët vazhdojnë të përipiqen, dhe shpejt ose vonë rezultate të njëpasnjëshme të pakënaqësisë ndaj vetes mblidhen të gjitha së bashku me një kapëse letrash gjigante nga historianët e letërsisë dhe quhen: VEPËR...Ka marrë fund, unë do të të mbërthej për duarsh. "Nuk ka asgjë të re nën diell": kjo është ajo që ti ke shkruar, Ecclesiastes. Por ti vetë je lindur riosh nën diell. Dhe poezia që ti krijove është gjithashtu rioshe nën diell, përderisa askush përpara teje nuk e

shkroi atë. Dhe të gjithë lexuesit e tu janë gjithashtu rioshë nën diell, përderisa ata që kanë jetuar përpara teje nuk e kanë lexuar poezinë tënde. Dhe ai qiparis nën të cilin ti po prehesh nuk është rritur më. Do të rritet një tjetër qiparis pranë teje, i ngjashëm me tëndin, por jo krejtësisht i njëjtë. Dhe, Ecclesiastes, do doja gjithashtu të të pyesja, çfarë gjëje të re ke planifikuar të bësh tani? Ndonjë shtesë të mëtejshme të mendimeve që pothuajse i ke shprehur dikur? Apo ndoshta je i tunduar të hedhësh tani poshtë disa prej tyre? Në poezitë e mëparshme ti ke përmendur gëzimin - e pra çfarë do të ndodhë nëse ai zhduket? Ndoshta poezia jote e re nën diell do të jetë rreth gëzimit? Akoma nuk ke mbajtur ndonjë shënim, a ke ndonjë projekt? Dyshoj se do të thoshe: " Unë kam shkruar çdo gjë, nuk ka mbetur asgjë për të shtuar" Nuk ka poet në botë që mund ta thotë këtë, të paktën poetë të

mëdhenj si ti.

Bota- çfarëdo që ne të mendojmë të tmeruar nga pafundësia e saj dhe nga pafuqia jonë, ose të hidhëruar nga indiferenca e saj për vuajtjet personale të njerëzve, kafshëve apo ndoshta edhe bimëve; (po pse jemi kaq të sigurt se bimët nuk ndajnë dhimbje), çfarëdo gjë që ne mund të mendojmë në lidhje me hapësirën e madhe të shpuar nga rrezet e yjeve, të rrethuar nga planetë që ne sapo kemi filluar ti zbulojmë...-planetë pa jetë? Të vdekur? Ne thjesht nuk e dimë. Çfarëdo që ne të mendojmë për këtë teatër të papërmasë tek i cili ne kemi siguruar bileta të rezervuara, por bileta jeta e të cilave është kaq e shkurtër sa të vjen për të qeshur, e kufizuar nga dy data krejt arbitrare, gjithçka tjetër që ne mund të mendojmë për këtë botë- ajo është e mrekullueshme.


Por "e mrekullueshme" është një epitete që

fsheh një kurth logjik. Ne jemi të mrekullueshëm, para së gjithash, nga gjëra që devijojnë prej disa normave të mirënjohura universale, prej konkretësisë me të cilën ne jemi mësuar gjatë gjithë jetës. Domethënia e kësaj është se nuk ka ndonjë botë të qartë, të tejdukshme. Habia jonë ekziston vetvetiu dhe nuk është e bazuar në ndonjë krahasim me gjë tjetër. Si përfundim, në gjuhën e përditshme, në të cilën jo çdo fjalë përfilllet, ne të gjithë përdorim fraza si psh. "botë ordinere", "jetë ordinere", "rrjedha e zakonshme e ngjarjeve"... Por në gjuhën poetike, ku çdo fjalë merr peshë, asgjë nuk është e zakonshme ose normale. As dhe një gur i vetëm apo një re përmbi të. As dhe një ditë e vetme apo një natë pas saj. Dhe mbi të gjitha, as dhe një ekzistencë e vetme apo e kujtdoqoftë në këtë botë. Duket se vepra e poetëve gjithnjë do të mbetet e ndarë nga jeta e tyre.

Profile

PËR HEMINGWAYN

Si shumë artistë të mëdhenj që mblidheshin në Parisin e ëndrrave... edhe Hemingway zbarkoi në atë qytet që ishte "festë e pambarimtë", siç e quante



Bujar MEHOLLI

Një djalosh karizmatik. Me një humor që e veçon, i hajthëm dhe tërheqës. Inteligjent. Ernest Hemingway. Ky ishte portreti i nobelistit të ardhshëm në letërsi, njeriut që hodhi në letër konglomeratin e eksperiencave të shumta - luftëtar i paepur për liri, sy patrembur, artist i vërtetë që nuk bëhet servil dhe s'para pëlqen lajlelulet e përshkrimet e dobëta, sipërfaqësore, shkruan si mendon, ashtu siç dhe jeton. Njashtu është dhe stili i tij i shkrimit, prozator mjaft konciz, i saktë, i përqendruar, mjeshhtë i dialogut; Hemingway është shkrimtari më i veçantë amerikan i shek. XX. Humanist, vizionar, realist, aspak utopist, aspak i dehur nga ëndrra amerikane. Një stilist i përkryer; intelektual i angazhuar deri edhe me armë në krahë... Të shkruash për jetën dhe krijimtarinë e një njeriu si Hemingway është gjë e vështirë. Për jetën e tij libertine, mbushur me lloj-lloj lidhjesh erotike, bar-restorante, pije, bredhje, gra e letërsi - ka çfarë të shkruhet. Jeta e Hemingwayt që tipike boheme dhe Parisi me magjinë e tij ishte

vendi ku shkrimtari i ri amerikan do të zbarkonte për të jetuar e për të zhvilluar karrierën. Ernest Hemingway u lind më 21 korrik të vitit 1899 në Oak Park, Ilionis. Babai i tij ishte mjek, nëna muzikante; fëmijëria e Ernestit kaloi mes shumë aventurave, ishte i dhënë pas peshkimit dhe gjuetisë - pasione të cilat do t'i përgjeshin më vonë edhe në shkrime. E gjithë jeta e tij që një aventurë në të vërtetë: përpjekjet e para për gazetari i bëri pranë gazetës "Kansas City Star". Si 18-vjeçar, plagoset në frontin e luftës në Itali ku që bashkuar me Kryqin e Kuq. Aty dashurohet në një infermiere të bukur e cila që muza e romanit të famshëm "Lamtumirë armë", 1929. Aventurat e tërhiqin gjithmonë dhe ai rëndë pas tyre me energji të jashtëzakonshme. "Plaku dhe deti" padyshim është ndër veprat e tij më të njohura. Një histori/tregim që vë në pah forcën dhe dinjitetin e brendshëm të njeriut. E përkthyer në të gjitha gjuhët. Fiton çmimin "Pulitzer" dhe bind Akademinë Suedeze t'ia ndajë çmimin "Nobel" autorit të saj në vitin 1954.

Si shumë artistë të mëdhenj që mblidheshin në Parisin e ëndrrave... edhe Hemingway zbarkoi në atë qytet që ishte "festë e pambarimtë", siç e quante. Hemi kishte intervistuar kryeministrin francez të asaj kohe, pastaj fashistin italian Mussolinin, gjithashtu kishte shkruar artikuj për Konferencën e Paqes. Në vitin 1930 shkoi në Spanjë për t'u rreshtuar kundër Frankos. Atje do të frymëzohet për romanin e famshëm "Për kë bie kambana?", - historia e Robertit, amerikanit trim që bie në sevda me Marian, fshataren guerile. Shkrimtari shqiptar Petro Marko, (po ashtu pjesëmarrës në luftën e Spanjës) do ta takojë Hemin. "U njoha me Heminguejin në Valencia, në Kongresin e Shkrimtarëve më të shquar të botës, si: Pablo Neruda, Nikolas Giljen, Andre Marlo, Nekse, Ana Serges, Luvdig Ren, Aleksej Tolstoj, Rafael Alberti, Atonia Maçado e të tjerë. Ky dukej më i gjalli. Unë për herë të parë i shikoja dhe u dëgjoja emrin këtyre kolosëve të letërsisë bashkëkohore, të cilët, me mendimet dhe shkrimet e tyre, i dhanë një hapësirë më humane, më internacionale dhe socialiste letërsisë dhe artit botëror. Isha kureshtar për këtë njeri, trupmadh dhe të ngarkuar me kamera (se xhironte filma për zhurnalët e kinemave të botës dhe i shiste për t'i ardhur në ndihmë Republikës), të ngarkuar me bomba, me dylibi, me pistoletë, aq sa një shkrimtar tjetër i njohur i tha: - Si shumë t'i rëndojnë supet hekurat që mban! - Më shumë m'i rëndojnë mendimet se hekurat - iu përgjigj Ernest Hemingway." Petro Marko i dërgon romanin "Hasta la vista" për të cilin merr letër nga Hemingway. "Pas dy a tre muajsh, mora një kartë postale. E hapa dhe lexova këto fjalë të Heminguejit, shkruar në gjuhën spanjolle: 'I dashur Pedro, mora romanin tuaj dhe ju falënderoj. Mjerisht, unë nuk e lexoj dot, se nuk e di gjuhën tuaj. Vetëm për një gjë jam i sigurt: shkrimtari, që e do njeriun dhe vdes për të, shkruan mirë...". Parisi u bë për të (sikur për çdo artist) aq i dashur! Itinerari i shkrimtarit amerikan në Paris përfshin shumë hotele, apartamente, restorante e kafene ku rrinte tërë ditën, pinte, shkruante e bridhte pas grave. Në Paris jetohej më lirë, artistët kishin liri për t'u dhënë pas aventurave, klubeve e bordellove të shumta rrugëve; kjo jetë e pasur artistike i tërhiqte ata nga e

gjithë bota drejt "atdheut" të tyre. Hemi, veç tjerash, u takua me një grua interesante, Gertrude Stein, nga e cila mësoi shumë edhe në stilin e të shkruarit. Ajo ishte amerikane, koleksionuese e veprave artistike dhe mike e mirë e shumë artistëve. Edhe Hemingwayn ajo do ta këshillonte rreth shkrimit dhe çlirimit nga ngarkesa e fjalive të panevojshme. Në kryeqytetin francez Hemi fillimisht çonte jetë të vështirë. Janë të njohura shkrimet për urinë në kujtimet e tij; atij shpesh i duhej të bariste andej-këndeje me stomakun bosh duke kërkuar një vend të ngrohtë ku të ulej, të pinte (ishte dashamirës i madh i pijes) dhe të shkruante. U njoh me shumë artistë tjerë, piktorë e shkrimtarë, ndër ta me Picasson, Joycen, Fitzgeraldin, etj. Aventurat e tij me gratë janë të shumta. Galeria e grave në jetën e Hemit është e pasur. Është e njohur aventura me aktoren Marlene Dietrich së cilës në një letër, ndër të tjera, do t'i shkruante: "E dashur Marlene, të kam dashur dhe admiruar gjithmonë. Dua ta dish që të harroj ndonjëherë... ashtu siç harroj të rrahurat e zemrës sime; ajo megjithatë rrahë, gjithmonë. Nuk arrij të përshkruaj sesi sa herë që të përqafoj, ndjehem në shtëpi". Hadley Richardson ishte bashkëshortja e parë e tij, e cila u pasua nga tri të tjera. Pauline Pfeiffer ishte gruaja tjetër me të cilën Hemi u martua, por ajo e lodhur nga sjelljet e tij u detyra të divorcohet. Martha Gellhorn, elegante e bukur, pati dy fëmijë me Hemin; ata ishin të lumtur derisa ai u njoh me gazetaren Mary Welsh. Një bionde e bukur që s'do t'i ndahet gjer në çastin final të jetës. Martohen, shijojnë muzikën e Chopinit, shëtisin. Këto janë vitet më të rënda për shkrimtarin e zhytur thellë në depresion. Është 2 korriku i vitit '61. Ai zgjohet, merr armën e gjahut, kyç derën dhe ia hedh vetes trutë në erë. (Të paktën ky është versioni zyrtar!) Ky është një ndër përfundimet më të dhimbshme të njerëzve të mëdhenj. Edhe Hemingway vetëvritet sikur i ati kohë më parë. Kështu shuhet një njeri i madh, pasionant, punëtor, i cili skaliti emrin në panteonin e letërsisë së përbotshme. Hemingway, si Dreiser, Fitzgerald, London, bënë pjesë te emrat më të mëdhenj të letërsisë amerikane; njeriu që me guxim të pasqorë bëri ballë tallazeve të jetës.

Përtej entuziazmit

ETNO MUSEUMI SHQIPTAR QË INJOROHET PREJ SHQIPTARËVE

Etno Museumi në Draginë të Anës së Malit, duhet të konsiderohet si një yçkël që ther ndërgjegjen e çdo faktori shqiptar në Mal të Zi dhe jo vetëm! Prioritet i prioriteteve të liderëve, partive shqiptare, të komunave shqiptare në këtë shtet, duhet të jetë ndihma shtetërore për këtë Muze, madje deri në institucionalizimin e tij



Nga Avni HALIMI

Fill pas vendkalimit kufitar në Muriqan, që lidhë Shkodrën dhe Ulqinin, katundi i parë nëpër të cilin do të kalohet është Sukobina, vendlindja e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti! Katundi tjetër me radhë, në vargun e katundeve të Anës së Malit, është Dragina, vendlindja e poetit shqiptar, ndër më të mirët në Mal të Zi, Hajredin Kovaçit - Dini!

Në këtë anë gjendet edhe një prej lokaliteteve më misterioze prej të gjitha atyre që shkenca i njeh si lokalitete ilire - Shasi, me dhjetëra rrënoja të kishave të hershme shqiptare si dhe me liqenin e vet të krijuar pas tërmeteve katastrofale dhjetëra shekuj më parë.

Mjaft i rëndë ishte edhe tërmeti i vitit 1979, nga i cili më së shumti në rajon e pësoi Mali i Zi! Shumë njerëz vdiqën, mijëra u plagosën e u shkatërruan mijëra shtëpi e objekte të ndryshëm. U rrënuar edhe shtëpia e familjes së Dinit. Ndihma erdhi nga e tërë bota! Vendbanimet shqiptare u ndihmuan sidomos nga shoqatat shumë të fuqishme shqiptaro-amerikane. Nisi rindërtimi i shtëpive të reja. Rrënojat po pastroheshin, bashkë me to po hidheshin edhe gjësendet e vjetra, të thyera, të dëmtuara, të shkatërruara, pjesë e kulturës, etnografisë shqiptare! Kjo dukuri do ta ngacmojë Dinin, i cili do të lëshojë zë anekënd Anës së Malit dhe do t'i lusë të gjithë që gjërat e vjetra mos t'i hedhin për skrap, por t'ia dorëzojnë atij! Brenda një kohë do të grumbullojë qindra eksponate, ndërsa paralelisht me këtë aksion, do të angazhohet që, pjesën e ngelur në këmbë të shtëpisë së rrënuar nga tërmeti, ta meremetojë dhe ta bëjë si tip maraze, ku do t'i strehojë të gjitha ato

eksponate të vjetra që do t'ia dërgojnë bashkë-vendasit.

Së fundmi, Din Kovaçi ka mbledhur edhe gurë nga rrënojat e objekteve të shkatërruara nga tërmeti i 1979-ës dhe ka zgjeruar hapësirën e eksponateve, e cila tashmë mbanë emrin Etno Museumi - Draginë!

Pra, në këtë katund sot gjendet Muzeu Etnologjik i Hajredin Kovaçit, i pasur me qindra eksponate nga ato arkeologjike e deri te etnografike, folklorike, filateliste, bujqësore, artistike, ushtarake etj. Një numër i madh i këtyre eksponateve janë të strehuar edhe nëpër shtëpinë e re të Dinit, sepse jo të gjitha mund të përfshihen në hapësirën e quajtur "Etno Museum-Draginë".

Museumi në fjalë edhe më tej është në fazën e tubimit të relikteve të vjetra, kryesisht të viseve të Anës së Malit dhe ka të tilla që datojnë qysh para dy-tri shekujve, madje edhe shumë më të hershme.

Pastaj duhet të vije faza e emërtimit të saktë të relikteve, e gjetjes së periudhave dhe viteve që kur datojnë si dhe faza e konservimit dhe e ndreqjes së kutive të qelqta, që do të shërbejnë për mbrojtjen nga pluhuri, nga lagështia, por dhe nga prekja e pakujdesshme e vizitorëve që shpesh herë mundohen t'i mbajnë në duar eksponatet e ndryshme (veglat muzikore, plisat, armët, veglat bujqësore etj.)

Për fatin e muzeut shqiptar vendosë komisionari serb?!

"Etno Museumi" në Draginë ka filluar të vizitohet gjithnjë e më shumë. Ka edhe turistë të huaj që në mënyrë të organizuar e vizitojnë dhe mahniten nga ky "institut" dhe nga entuziazmi i Hajredin Kovaçit. E vizitojnë edhe shkrimtarë, edhe politikanë, edhe nxënës, edhe mërgimtarë që gjatë stinës së verës gëlojnë në Ana

Mal, kryesisht nga Amerika. Si kryetar partie, e ka vizituar edhe kryeministri i Malit të Zi, Dritan Abazoviqi, por që nuk i është kujtua ky Muze gjatë periudhës sa ishte kryeministër!

Hajredin Kovaçi nuk ndihmohet nga askush, nga asnjë institucion lokal e shtetëror! Dini ka konkurruar disa herë, së fundmi edhe në Ministrinë për Pakica Kombëtare. Komisioni i këtij dikasteri, në përbërje prej një serbi dhe gjashtë myslimanëve-boshnjakë, e kanë refuzuar projektin e Dinit, me arsyetim se aktivitetet e përfshira në projekt nuk janë të evidentuar në statutin e "institutit"! Do me thënë, botimi i ndonjë katalogu, i ndonjë fletëpalosje, i ndonjë broshure, i fotografive të relikteve e ndonjë ide tjetër lidhur me Muzeun, nuk mund të përkrahët sepse ato nuk janë të përfshira në Statut! Nuk e ndihmon as Ministria e Kulturës. Qendra për Kulturë e Ulqinit e përkrah financiarisht vetëm Muzeun në Kalanë e Ulqinit sa për të tërhequr vizitorë, ndërsa nuk ka paraparë kurrfarë ndihme për Muzeun në Draginë, i cili tashmë me xhelozin ruan një histori të lashtë të shqiptarëve të Anës së Malit!

Në periudhën komuniste, më vitin 1983, Dini për shkak të bindjeve të veta kombëtare dhe idealit shqiptar, u burgos si "nacionalist dhe irredentist", ndërsa sot, edhe më tej i vuan pasojat e atyre kualifikimeve shoviniste. Ndryshe nuk ka se si të shpjegohet injorimi dhe sjelljet nonshalante të dikastereve përkatëse shtetërore, prej të cilave Dini kërkon ndihmë për t'i shpëtuar dhe për t'i ruajtur sa më profesionalisht reliktet e tubuara kryesisht nga Ana e Malit.

Mjerisht, Dini në aktivitetin e vet etno-muzeal nuk ka gjetur përkrahje



financiare as nga diaspora, as nga shoqatat e shumta shqiptare tej-oqeanike. Krejt vonë ka kuptuar se një shoqatë shqiptaro-amerikane ka ndarë fond për Etno Muzeun, por që nuk e ka të qartë se ku kanë përfunduar ato para!

Oborri i Muzeut qendër e aktiviteteve letrare

Ngritja e objektit si dhe zgjerimi i tij kërkon financa dhe ato kanë qenë fund e krye nga buxheti familjar i Dinit! Mirëmbajtja profesionale e relikteve do të kush-tojë edhe shumë fish më tepër se sa ngritja e objektit! Reliktet, secila në vete, kanë nga një histori, kanë nga një rrëfim, nga një dëshmi mbi lashtësinë e shqiptarëve të Ana Mali dhe jo vetëm!

Hajredin Kovaçit i ka vajtur mendja që oborrit e shtëpisë dhe të Muzeut ta bëjë si pushimore për turistët, të cilët, natyrisht që kanë nevojë për ndonjë pije të freskët, për ndonjë kafe, për një karrige ku do të pushojnë pak! Numri gjithnjë e në rritje i vizitorëve e kanë detyruar Dinin që të vë në oborr edhe dy-tre tavolina druri, disa karrige dhe të krijojë një ambient të qetë, relaksues dhe frymëzues. Tur-operatorët që sjellin turistë francez, anglez, holandez etj. paraprakisht kërkojnë që për numrin e vizitorëve të vetë të përgatitet drekë ose darkë. Kështu, ka filluar tani edhe biznesi i vogël familjar!

Veç kësaj, në oborrit e këtij Muzeumi tash e tri vite radhazi mbahet "Manifestimi botëror i poezisë"! Aktivitetet letrare në këtë oborr janë në rritje e sipër, ndërsa kërkohet edhe shtrimi i ndonjë kokteji! Kohë më parë, në oborrit e "Etno Museum"-it të Draginës, Shoqata e Artistëve

dhe Intelektualëve shqiptarë të Malit të Zi, "Art Klub", organizoi "Kalimerën poetike BASTRI ÇAPRIQI", kushtuar poeteshës nga Maqedonia e Veriut, Nurie Emërllahu!

Shtëpia e një pjese të historisë së Anës së Malit

Etno Muzeumi në Draginë duhet të konsiderohet si një yckël që ther ndërgjegjen e çdo faktori shqiptar në Mal të Zi dhe jo vetëm! Prioritet i prioriteteve të liderëve, partive shqiptare, të komunave shqiptare në këtë shtet duhet të jetë ndihma shtetërore për këtë Muze, madje deri në institucionalizimin e tij. Dini tashmë ka hedhur hapat gjigante për ngritjen e një institucioni nacional dhe tash e tutje barra do të bie mbi faktorët shqiptar që veprojnë në këtë shtet! Të mos këmbëngulet në ndihmesat shtetërore që i duhen Muzeut, të mos këmbëngulet në ngritjen e Muzeumi qoftë edhe si Institucion komunal, është bars me angazhimet shovene për të fshirë çdo gjurmë të lashtësisë shqiptare në Anën e Malit! Në këtë Anë ndihma dhe solidariteti vëllazëror që vije nga Amerika dhe, përgjithësisht, nga diaspora, është i paparë në asnjë vend tjetër shqiptar! Mos ndodhtë ndonjë fatkeqësi, sepse, sakaq, përgjigja nga diaspora do të jetë konkrete dhe shumë e madhe.

Deri në ndërgjegjësimin e faktorëve shqiptarë për ta listuar në krye të prioriteteve kombëtare këtë Muzeum, do të ishte hap shumë i qëlluar që diaspora të formonte një fondacion që do ta ndihmonte "Etno Museum"-in e Dinit deri në institucionalizimin e tij. Është jetike për perspektivën e Anës së Malit!



Fjala e poetit

LIRIA NË KOHË KAOSI

Nga Ali PODRIMJA

1. Qenushin e punësora, shpresoj se në ndonjë kancelari do gjejë vend edhe macja ime. Vë në dispozicion tërë kopenë. Kurrë nuk ka pasur kohë kaq me bollëk e kaq të zhugaftë. Para kollës së thellë të një tekeleku shpalohej horizonti. Të bëhej se do pushtojë dhe qiellin. Kishte qitur hapin kah e panjohura...

2. Zotëria ishte ulur në kanape, ku u zgataraq pak. Pasi e çoi me fund gotën në formën e një amfore ilire, u ra shuplakave me një takt të çuditshëm. Në sallonin e ndritshëm hyri një gjel, i cili u ndal para tij. Si u morën vesh, nuk e di. Pas dy-tre minutash ia sollë pijen e porositur. E mbante në mes dy krahëve të hapur, që deri në gjysmë ia mbulonte kaçiruba e kërlëshur. Karafili, ashtu e quanin, e mori me një gaz të thartë të shkaktuar nga dridhmat që nuk mund e lexoja si ironi. Atë gjest e bëri thuajse desh të thotë ja çfarë rregulli ka në perandorinë time. Unë përcillja lëvizjet e tij. Pas fytit të parë, i zhveshi dhëmbët. Nga rrënja ia kishte mbuluar një shtresë e verdhmë. Sapo veneroi se hoqa shikimin rrëmbimthi nga të zgërdhirurit e tij, iu kujtua se me ta nuk bën të krenohej askund. Nisi historinë e oxhaqeve aty ku e kishte lënë. Një fjalë nuk e tha qysh kishte arritur deri aty dhe si në torishtë kishte vënë rend e që nuk ishte pa vizitorë.

3. Në lule të ballit e shikova. Kishte një pikë të zezë të marrë në një farë përplasje. Kur pushoi, i thashë: E di,

zotëri, më pëlqen puna jote e ky luks, por në këtë kaos mjeshtëri është të mos humbasësh një qime floku. Rreth lirisë sime, kam krijuar membranën time tepër të sigurt. E shikoni makinën time atje poshtë nën ballkonin tënd? Edhe pse rri e hapur ditë e natë, nuk e prek askush. As nuk më ka shkuar ndërmend ta mbyll. Unë besoj në polemën. Rrenë është ajo që flitet se populli na është hajdut. Shikoni çdo gjë imja rri hapur. Për mua nuk është i përdorshëm asnjë dry. E urrej gjithëpushtetshmërinë e çelësave. Ju paskët specializuar tërë torishtën e nuk mund të lini hapur asgjë! Megjithatë, ndodh avari në perandorinë tënde. Unë e ndjej veten të lumtur edhe me atë Koralin 45, edhe me një grusht lekësh, edhe me makiaton time të mëngjesit që e pi diku në Alenë e Shpëtimtarëve të Kombit. Lirinë time nuk e vë në pyetje, zotëri.

4. Pëshpëriti më tepër për vete: E pamundur! Ndërsa qeni i tij lehte para derës dhe përzihej në bisedën tonë. Si ndodh kjo? Pyeti si në gjumë. Në qafë nuk i bie askujt, as nuk ha më shumë se një bark, zotëri. Të bindeni, ja zbres shkallëve aty te Korali 45. Asnjë çelës nuk do e vë në veprim, as kur e mbyll as kur e ndez. Unë nuk frikësohem nga liria ime. Në shkallën e fundit isha kur zotëria doli në ballkonin e madh. Kërkonte makinën time. Unë ia bëra me dorë. Pa çelës hapa derën dhe ndeza motorin pa çelës po ashtu. Sa desha të nisem, më thirri atje lart. Fika motorin dhe u nisa duke fishkëlluar. Sapo i afrohesha derës së tij atje në fund të korridorit, ndjeja zhurmën e rëndë të çelësave. Praninë time kur e ndjeu e

hapi derën e hekurt. Te këmbët e tij qeni lëvizte bishtin dhe thellë diku nën një kanape macja lozte me një mi, që kishte filluar të përgjaket.

5. Përballë tij zura vendin, ku isha pak më parë. Më bëhej se zotëria ishte pakëz nevrrik ose kishte ndonjë problem me perandorinë e vet. Mezi i kapja fjalët, që m'i tha në sinkopa: Edhe pa targa, e njeri i botës! Në anën e kundërt të lëvizjes së tij e lëvizja kokën. Prapë u ra shuplakave me atë taktin karakteristik të kateve të larta. Nuk di a e ka dëgjuar ndonjëherë gjelin çfarë kënge ia thotë? Krahëhapur qëndronte me një gotë uiski para tij. Pasi e zbrazi edhe një, i çatalloi sytë tek dëgjoji atë përrallën që ia kallëzoja e që ma kishte treguar një njeri i urtë nga Drinia.

6. Në vendin tonë paska marrë njëherë dimër i madh. Babë e djalë shkojnë për dru. Kishin mbledhur dhe krënden e fundit. I kishin paluar nën çati. Ditë për ditë ato pakësoheshin e dimri nuk zbutej. Kishin mbetur edhe ca. Nga forma nuk dihej ç'ishin. Plaku i kishte shikuar një nga një dhe i kishte thënë djalit njëherë ta kthejë në pyll. Ai kishte qeshur: Edhe këtë do e bëjmë gacë. Krënden e kishin futur afër vatrës. Dikur ajo kishte ndërruar formë, nga pak kishte filluar të lëvizë. Babë e bir derisa ngrënin darkë, një gjarpër kishte kërcyer rreth tyre dhe kishte kafshuar djalin. Mbi trupin e tij ishte dëgjuar britma e plakut: Ç'zezë na ra në shtëpinë tonë...

7. Pyllin e nëmur e kisha lënë pas dhe nuk di në cilin kilometër. gjendesha

kur përmes radios dëgjova lajmin fatkob për zotërinë, që kishte punësuar mace e kuçe dhe ishte përpjekur të imitojë lirinë time. Kisha fikur dritat e makinës dhe orientohesha përmes vijës së bardhë, që likpërmjet ndante udhën e asfaltuar deri në pafund. Kolla e tekeleku nuk dëgjohej më. Nga honi i errët forcat blu e kishin nxjerrë dhe ndanë udhe e kishin mbuluar të rënin me një çarçaf, pastaj dhe një trup tjetër pa jetë.

I gjori Karafil ishte nga huduti, ku fillonte okupimi i rasëve. Kishte bërë pasuri e punësuar mace e kuçe. Nuk ia shihte fundin perandorisë së vet. Tek përralloseshin një natë me të dashurën për të kaluarën, se cili prej tyre kishte qenë hafije; iu kishte kujtuar asaj se nuk e kishin punësuar ende një cullë gjashtëmuajsh. Të gjatë e me plot ankime ia kishte nisur një letër të parit të fisit HyxhymSandalisë. Ishin të brengosur për këtë harresë të hyqymetit. Kërkonin cullën ta vendosin diku, drejtor apo ... Nuk kafshohet më qielli, as nuk bën dera e tyre të fyhet...Pasha musafin shkrep, kishte këllthitur ai. Dy ditë pas e kishte ndezur makinën e tipit më të ri. I kishte premtuar gruas sapo të punësohet culla do shkelin qiellin dhe do çrrethojnë torishtën. E përfytyronin kopenë si derdhej në pyllin e nëmur. Tek e prekte rrumbullakën aty ku fillonin livadhet e buta, në shpejtësinë e pakontrolluar, kishte rrëshqitur makina në hon. Në procesin e forcave blu qëndronte: Rasti hulumtohet...

8. Keqpërdorimi i lirisë mbyllet me fatkeqësi.

/nëntor, 2007/

NUMRI I ARDHSHEM ME 20 SHTATOR

HEJZA

05 SHTATOR, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Drejtor: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000